



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.08.2016, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Vazhdimi i shqyrtimit të projektligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj, Arben Ristani, Fatmir Mediu, Keltis Kruja, dhe Aldo Bumçi.

Mungon:

Gent Strazimiri dhe Spartak Braho.

Të ftuar:

Rainer Deville - Ekspert i Nivelit të Lartë, shef i misionit të EURALIUS-it në Shqipëri

Jon Smibert - Ekspert i Nivelit të Lartë, përfaqësues i misionit të OPDAT-it në Shqipëri

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Meqenëse kuorumi është plotësuar, mund ta fillojmë mbledhjen e Komisionit për shqyrtimin e projektligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe, siç është e njohur për të gjithë, ky projektligj është shqyrtuar në Komisionin e Posaçëm. Me miratimin e projektit kushtetues janë bërë disa amendime të rëndësishme, të cilat reflektojnë drejtpërsëdrejti ndryshimet e projektit kushtetues.

Njëkohësisht, lidhur me përmbajtjen e projektligjit, nga ana e deputetëve të opozitës është paraqitur një opinion me komente. Grupi i ekspertëve dhe posaçërisht ekspertët ndërkombëtarë, të cilët janë marrë me këtë projekt, dhe në mënyrë të veçantë EURALIUS-i, i mbështetur edhe nga OPDAT-i, kanë bërë reflektimet e nevojshme, të cilat lidhen me ndryshimet kushtetuese që ka miratuar Kuvendi me konsensus. Gjithashtu, mbi bazën e opinionit të paraqitur nga deputetët e opozitës, ata kanë bërë një sërë reflektimesh dhe ndryshimesh të konsiderueshme në përmbajtjen e tekstit të projektligjit. Siç kemi rënë dakord, ne do të shqyrtojmë projektligjin, mbështetur në ndryshimet e paraqitura dhe të reflektuara, pra drafti që keni mbi tavolinë, me reflektimet që kanë bërë ekspertët ndërkombëtarë dhe posaçërisht misioni EURALIUS, të cilët për arsye që dihen dhe për të mos i përsëritur më edhe për lidhjen e drejtpërdrejtë që ka ky projekt edhe me asistencën ndërkombëtare të Bashkimit Europian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por posaçërisht me rolin që luan në këtë proces Komisioni Europian përmes strukturave të tij.

Gjithashtu, siç jeni në dijeni, kolegu Bylykbashi, në emër të opozitës, ka paraqitur disa amendamente, të cilat kanë ardhur mbrëmë dhe u janë shpërndarë kolegëve deputetë dhe ata i kanë edhe në tavolinë. Ne do të procedojmë normalisht me projektligjin që kemi, kurse kolegët e opozitës do të bëjnë sugjerime konkrete për amendamentet që kanë. Zoti Bylykbashi më ka kërkuar që për ta bërë këtë gjë, duhet të ftoj këtu zotin Gazmend Bardhi, i cili në emër të kolegëve të opozitës do të bëjë paraqitjen e amendamenteve përkatëse. Gjithsesi në parim, dua të them se duhet të ecim shpejtë me këtë projektligj, sepse sot pasdite është thirrur Konferenca e Kryetarëve për të caktuar datën e seancës plenare. Është shumë e rëndësishme për shqyrtimin e këtij projektligji dhe dy projektligjeve të tjera, për arsye të njohura publikisht, dhe nisur nga këto arsye madhore dhe tejet të rëndësishme për fatet e integritit të vendit, për procesin e reformës,

me shumë të drejtë, Kryetari i Kuvendit, i cili ka kohë që thekson domosdoshmërinë e mbajtjes së një seance të shpejtë për këtë çështje, ka thirrur konferencën e kryetarëve për ta formalizuar. Natyrisht, përpara këtij akti tejet të rëndësishëm moment përcaktues është roli që luan ky komision, kështu që mund të fillojmë.

Fjalën e ka për procedurë zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, ky është një projektligj me rëndësi të jashtëzakonshme, gjë që e kemi thënë edhe herë të tjera, prandaj nuk do e zgjasim këtë histori. Për rrjedhojë, duke filluar nga baza kushtetuese e deri kur të mbyllim nenin e fundit, duhet të jemi maksimalisht të kujdesshëm. Projektligji i dorëzuar në komision dhe i diskutuar nga ky Komision më parë, ndryshe nga shumë ligje të tjera nuk kishte fare bazën kushtetuese ditën kur është diskutuar. Për këtë arsye, meqë jemi të gjithë këtu dhe tashmë jemi në një fazë të rikuperuar, dhe Kushtetuta është në fuqi, unë sugjeroj që të bëjmë një votim në parim dhe jemi plotësisht dakord që ta votojmë në parim. Po e shpjegoj që tani që ne e votojmë në parim këtë ligj, por për të qenë në rregull proceduralisht. Ky është propozimi i parë.

Gjithashtu, siç ju e thatë, ditën e premte, në datën 19, me një shkresë drejtuar komisionit janë paraqitur një sërë amendamentesh. Për shkak se atë ditë, por dhe pas mbledhjes së Komisionit, nuk kishte mbledhje të grupit të ekspertëve, për të mos humbur kohë si dhe për të qenë konstruktiv dhe kontribuues, ne njoftuam Komisionin që do të përgatisnim një set amendamentesh, të ndara në dy grupe për shkak të volumit të punës, të cilat reflektojnë opinionin e paraqitur prej nesh. Grupi i parë është paraqitur mbrëmë, siç parashikohej në letër dhe që e keni përpara, kurse grupi tjetër, për shkak të volumit të punës, do të paraqitet brenda datës 27. Pra, në mënyrë konstruktive ne vazhdojmë kërkojmë që të kontribuojmë në këtë pjesë për ta bërë këtë ligj sa më të mirë.

Sigurisht që ligji është shumë i rëndësishëm dhe na duhet ta miratojmë shpejt, por gjithashtu duhet ta bëjmë mirë dhe së bashku, prandaj besoj se për këtë nuk ka ndonjë kundërshtim. Kështu që, iu sugjeroj anëtarëve të Komisionit që të diskutojnë deri te pika ku kemi mbërritur dhe më pas të vazhdojmë pjesën tjetër. Ne kemi paraqitur amendamente deri tek neni 25. Gjithashtu, këtu kam diçka që dua ta ngre me shqetësim, proceduralisht.

Ju jeni kryetar, zoti Xhafaj, por në cilësinë e nënkryetarit unë e kam për detyrë ta ngre në emër të opozitës që dy herë rresht u është lënë detyrë ekspertëve nga komisioni, pa bërë asnjë lloj dallimi, që të mblidhen, të ulen, të diskutojnë, të harmonizojnë dhe të vijnë me një tekst

legjislativ të konkorduar. Kjo nuk ndodhi pas opinionit të paraqitur në datën 1 gusht dhe për fat të keq nuk ka ndodhur as pas mbledhjes së fundit të komisionit, kur ky i fundit u la detyrën ekspertëve që të ulen dhe të bien dakord për tekstin. Ka një opinion të paraqitur nga EURALIUS, i cili është vetëm 3 faqe e gjysmë, ku më pak se 3 faqe apo edhe më pak se kaq janë komente teknike, të cilat janë të pamjaftueshme për të reflektuar shqetësime të karakterit principial, të substancës apo qoftë edhe të draftimit të opozitës dhe kjo nuk ka ndodhur gjatë gjithë këtyre ditëve.

Në një takim të bërë dje, midis meje si nënkryetar dhe përfaqësuesve të EURALIUS-it dhe OPDAT-it, nuk ka pasur diskutim teknik për këtë, por thjesht që një njohje e situatës ku ishim. Kështu që e ngre me shqetësim, që edhe pse komisioni e lë detyrë, grupi i ekspertëve nuk mbledhet, por harton projektligjin, këtë që kemi sot këtu përpara, dhe e dorëzon për diskutim pa e rakorduar me ekspertët e opozitës, për më tepër duke pretenduar që ka reflektuar shqetësimet tona pa na pyetur ne se si mund të bëhej më mirë. Kjo nuk është praktikë që çon në një produkt më të mirë, në efikasitet të komisionit dhe në fund fare gjithëpërfshirje dhe konsensus. Për këtë arsye, besoj se është shumë e rëndësishme që amendamentet tona duhet të merren hap pas hapi, sepse janë amendamente të një karakteri shumë teknik dhe që synojnë vetëm bërjen më mirë të ligjit. Edhe një herë unë kërkoj që grupi i ekspertëve të Komisionit apo sekretariati teknik, si të doni quajeni, të mos vazhdojë me këtë logjikë pune përndryshe cenohet edhe mënyra e funksionimit të Komisionit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Po, fjalën e ka zoti Majko.

Pandeli Majko - Unë mendoj se nuk është e dobishme që ne të fillojmë mbledhjen e komisionit sikur e fillojmë edhe një herë nga e para, sepse duket sikur në mbledhjen e kaluar nuk diskutuam asgjë, por opozita vjen këtu dhe thotë që të fillojmë diskutimet për 25 nenet e para sepse për këto kanë amendamente. Në favor të kujtesës dhe procesverbalit, në dijeninë time, në mbledhjen e kaluar, përfaqësuesit e EURALIUS-it dhe OPDAT-it i dhanë opinionet e tyre lidhur me draftin e propozimeve që Partia Demokratike kishte depozituar pranë Komisionit. Zoti Rainer, në mënyrë të detajuar dhe teknike, u shpreh më pas se për çfarë EURALIUS-i dhe OPDAT-i binin dhe për çfarë nuk binin dakord me propozimet e Partisë Demokratike.

Sinqerisht, unë shpreh keqardhje që edhe pas takimit që keni pasur me përfaqësuesit e EURALIUS-it dhe OPDAT-it, ju nuk keni rënë dakord për gjithçka dhe për çdo gjë, por mendoj

se kjo është gjëja më e natyrshme në një proces diskutimi të një pakete ligjore, e cila sigurisht ka edhe kontraktme të natyrshme qoftë politike apo edhe të periudhës që diskutohen. Kështu që, mendoj se insistimi që Komisioni të vazhdojë diskutimin bazuar mbi axhendën që ju kërkoni të na ofroni është i padobishëm. Unë mendoj se, ashtu siç ramë dakord edhe në mbledhjen e kaluar, që për të gjitha vërejtjet që është shprehur Partia Demokratike dhe më pas OPDAT-i dhe EURALIUS-i, të mblidhet grupi i ekspertëve dhe të shikojë se çfarë mund të rregullohet ose jo nga e gjithë kjo histori. Nuk ramë dakord që do të miratohen 100% të gjitha kërkesat e opozitës, sepse do të ishte jashtë çdo lloj konteksti të diskutimit, por ne e vlerësojmë atë që është e dobishme dhe kur nuk biem dakord, nuk biem dakord për atë që nuk e konsiderojmë të dobishme. Në draftin që kemi përpara, nuk e kam fjalën për ato që keni sjellë ju deri te neni 25, keni të gjitha vërejtjet për të cilat është rënë dakord nga OPDAT-i dhe EURALIUS-i. Kini parasysh që me ndryshimet e fundit kushtetuese, sidomos me aneksin, ne kemi pranuar në mënyrë kushtetuese observimin dhe mbikëqyrjen e të gjithë procesit në vazhdim nga ana e Bashkimit Europian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kështu që është e tepërt tani që ne të diskutojmë lidhur me faktin se pse duhet të jemi të pakënaqur kur OPDAT-i dhe EURALIUS-i nuk bien dakord me një varg propozimesh që mund të vijnë qoftë nga maxhoranca, qoftë nga opozita.

Që në krye të herës kemi thënë se pavarësisht kënaqësisë apo pakënaqësisë sonë politike për propozime që nuk do të bien dakord OPDAT-i dhe EURALIUS-i, ne do të tërhiqemi nga këto propozime, sepse duam të bëjmë një reformë sipas standardeve ndërkombëtare, jo sipas standardeve shqiptare, të politikës shqiptare apo me ide të çuditshme sovraniste, se jemi ne që vendosim për gjithçka dhe për çdo gjë.

Kështu që, u kërkoi kolegëve mirëkuptim që të vazhdojmë mbi logjikën e vërejtjeve, të cilat janë pasqyruar me bold në çdo nen ku OPDAT-i dhe EURALIUS-i kanë rënë dakord me propozimet e Partisë Demokratike. Pra, ne kemi një draft ku është shënuar me bold çdo propozim i Partisë Demokratike, pranuar nga OPDAT-i dhe EURALIUS-i. Në të kundërt, po kthehem tek teza që duhet të fillojmë votimin edhe një herë në parim dhe nen për nen, meqenëse ky diskutim është bërë në Komision pa u miratuar dispozitat kushtetuese, procesverbalin zotërinj e keni të zbardhur dhe të publikuar. Nuk është hera e parë që në parlamentin shqiptar miratohen ligje në komisione të specializuara dhe me mandat të veçantë nga ana e parlamentit, të cilat diskutohen dhe miratohen paraprakisht siç kemi bërë ne, në një kohë, të më kujtoj zoti Xhafaj

nëse unë bëj ndonjë gabim, që është thënë edhe në mbyllje të diskutimit që kemi bërë këtu, që pikërisht për shkak të ndryshimeve dhe diskutimit apo edhe të negociatave për ndryshimin e dispozitave kushtetuese, ne jemi të gatshëm që të diskutojmë nën pas nëni çdolloj ndryshimi në frymë, në koncept dhe në detaje teknike në qoftë se ato do të reflektojnë të kundërta me këto që kemi diskutuar ne. Kështu që, në favor të funksionimit dhe miratimit sa më të shpejt, sepse konferenca e kryetarëve që është mbledhur apo do të mbledhet sot, do të na kërkojë sa më shpejt produktin e parë që është “Ligji i vettingut” dhe pastaj pjesën tjetër të paketës ligjore, unë mendoj se duhet të ecim me një logjike, e cila shkon në vazhdim të asaj që kemi diskutuar dhe vendosur në mbledhjen e kaluar. Të paktën unë si relator duhet ta ritheksoj këtë dhe të më falin kolegët nëse jam duke ripërsëritur gjërat.

Kemi rënë dakord që për të gjitha vërejtjet e Partisë Demokratike, do të shprehen OPDAT-i dhe EURALIUS-i dhe ato pika, për të cilat ata nuk do të bien dakord, ne nuk do t'i kalojmë, kjo me mirëkuptimin edhe të kolegëve të opozitës. Jo se EURALIUS-i dhe OPDAT-i janë Zoti, por sepse me një sy teknik të ftohtë zyra e specializuar e Bashkimit Europian, e cila shprehet në emër të Komisionit Europian, po ashtu edhe OPDAT-i në emër të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, janë shprehur qartë dhe në mënyrë të specializuar lidhur me të gjitha vërejtjet e Partisë Demokratike. Kështu që, Partia Demokratike duhet të ketë mirëkuptimin dhe të japë hapësirën e nevojshme që ne të procedojmë bazuar mbi vërejtjet e pranuar nga ana e EURALIUS-it dhe OPDAT-it, me qëllim që ne të vazhdojmë miratimin e neneve ku është pranuar që të ketë ndryshime sa më sipër.

Ju faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Ju faleminderit, zoti Majko!

Zoti Mediu ka kërkuar të shprehet.

Fatmir Mediu - I nderuar zoti Xhafaj, të nderuar kolegë!

Unë mendoj se është krejt e papranueshme që ne të përpiqemi të vendosim pozicione se kush është pro OPDAT-it dhe EURALIUS-it dhe kush është kundër tyre. Ne jemi komision parlamentar, dhe si i tillë, si deputetë kemi përgjegjësinë për të lexuar, kuptuar, diskutuar, debatuar dhe gjykuar së bashku se cilat janë nenet dhe ligjet përkatëse, duke vlerësuar maksimalisht ndihmën që jep OPDAT-i dhe EURALIUS-i për asistencën dhe ekspertizën që ata kanë ofruar. Këtu nuk kemi asnjë ndarje dhe asnjë diskutim, por mendoj se procesi i ndryshimeve kushtetuese ka kaluar në debate me njëri-tjetrin, në debatet tuaja me EURALIUS-in

dhe OPDAT-in, në debatet tona me ta, derisa arrijmë në një marrëdhënie konsensuale. Të njëjtën rrugë, të njëjtën frymë, ne duam që të vazhdohet edhe për ligjet.

EURALIUS-i ka prurë një draft që ju thonë se është diskutuar, por është diskutuar në mënyrë të njëanshme nga ana juaj, pa marrë në konsideratë ndryshimet kushtetuese që do të bëheshin. Ajo çka ne po themi fare qartë është një praktikë normale, që ne ta miratojmë në parim, sepse është e domosdoshme dhe pastaj të gjithë së bashku të fillojmë të diskutojmë nen për nen. Nuk mendoj se ka ndonjë gjë të tepërt edhe sikur të ndodhë jashtë vullnetit të atyre që e kanë shkruar, sepse një deputet i cili është anëtar komisioni mund të ngrejë një çështje për një nen të caktuar dhe do ishte normale ta dëgjonim sepse mund të ketë të drejtë. Asnjëri këtu nuk e ka monopolin e së vërtetës, dhe për sa kohë që jemi deputetë, kemi përgjegjësinë për të kuptuar se çfarë po bëjmë. Të paktën 10 vetë që jemi këtu ta dimë se çfarë po bëjmë dhe për çfarë po votojmë në raport me 130 të tjerë që ngelen në parlament. EURALIUS-i kërkoi një kohë të konsiderueshme për t'i vlerësuar me ekspertë europianë amendamentet e opozitës. Dakord?

E pamë edhe atë që paraqiti zoti Rainer, me vlerësimin më të madh për punën që kishin bërë, por nuk kishte të përcaktuar në mënyrë të qartë se cilat ishin nenet, formulimet e tyre dhe arsyet pse, dhe duhet apo s' duhet të jetë një. Kishte gjëra që konsiderohen të dobishme sipas përcaktimit të tyre, por që mbase do të ishte më mirë siç ishte drafti. Ne jemi këtu edhe për të kuptuar njëri-tjetrin, prandaj me propozimin tuaj, zoti Majko, u la që ekspertët duhet të ulen, por ata nuk janë ulur. Në qoftë se flasim se kemi komision që merr vendime, do kemi edhe një komision që kërkon të zbatohen ato vendime. Në dijeninë time ekspertët nuk janë ulur, por nëse e kam gabim këtë konstatim, unë tërhiqem dhe kërkoj ndjesë, por ashtu si ju, edhe ne kemi padyshim gjykimin tonë, gjykimet nga ekspertët të EURALIUS-it dhe OPDAT-it si primare, dhe padyshim dhe opinionet që vijnë nga ekspertët e palëve, sepse punojmë në një marrëdhënie brenda grupeve dhe gjykimeve tona dhe pastaj për konsensusin që duam të arrijmë.

Pra, nuk shikoj asgjë të paqenë që ne të fillojmë të diskutojmë nen për nen. Dua që të jeni mendje hapur se ndoshta qëllimi mund të jetë më mirë kështu siç është përcaktuar te neni 1, siç e ka bërë propozimin opozita apo dhe EURALIUS-i. Mund të jetë më mirë ashtu siç e ka EURALIUS-i dhe do të thosha që jam dakord me të. Pra, nuk ka pse të ecim me paragjykime dhe a ka mundësi që t'i japim fund kësaj historie të turpshme që ju jeni pro EURALIUS-it dhe OPDAT-it, kurse ne kundër tyre, ju jeni pro-amerikanë dhe pro-europianë, kurse ne kundër, ju jeni kundër sovranitetit, ne jemi pro sovranitetit, sepse kjo është e papranueshme. Nuk po flasim

as në konferenca shtypi dhe as në televizion, por po flasim këtu me njëri-tjetrin. Ju lutem shumë të mos e vendosim veten në pozicione të tilla, sepse janë të papranueshme! Si ju si ne kemi një qëllim, dhe e ndërtoam këtë komision në bashkëpunim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me BE- në, me EURALIUS-in dhe OPDAT-in, për të arritur në një reformë konsensuale, në miratimin konsensual shqyr Zotit, të draftit kushtetues, edhe pse kishte mungesë dëshire për t'u miratuar me konsensus dhe mendojmë që në të njëjtën rrugë të futemi edhe në procesin e miratimit të ligjeve përkatëse. Këtë e kemi thënë që edhe ligjet do t'i kemi kështu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj - Nuk mund të rrimë pa fund këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mirë pra, por kur ka për procedurë flet njëri këtej dhe njëri andej.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, unë nuk jam këtu për t'u hequr të drejtën e fjalës, por edhe fjalë pa fund nuk mund të...

Oerd Bylykbashi - Zoti kryetar, jam shumë dakord me ju që fjalë pa fund nuk duhet të ketë, por propozimi ynë është shumë racional. Askush nuk mund të thotë që drafti që ka ardhur dhe është diskutuar këtu kishte bazë kushtetuese, dhe për rrjedhojë kjo ka qenë në një gjë që ky komision nuk mund ta bënte. Puna nuk është hedhur poshtë, sepse mbi atë punë është punuar më tej, por për fat, sot kemi Kushtetutën në fuqi dhe kemi mundësinë që ta bëjmë për së mbari, duke votuar në parim këtë ligj, gjë që është një moment, dhe pastaj vazhdojmë diskutimin nen për nen. Amendamentet që janë paraqitur nuk mund të anashkalohen, sepse ato zoti Majko, do të diskutohen nen për nen. Parlamenti e ka për detyrë këtë pjesë dhe tani ose më vonë do ta bëjë këtë gjë, kështu që t'i heqim këto ngërçe procedurale tonat që të paktën ne të jemi të nderuar. E para kjo.

Së dyti, sigurisht që ju nuk keni nga ta dini, zoti Majko, por unë do t'ju sjell transkriptin që ta lexoni vetë, që dje nuk ka pasur asnjë diskutim dakordësie ose padakordësie me EURALIUS-in. Nëse takimi është thirrur për të thënë që meqë nuk u thirrën ekspertët e opozitës me këtë e mbyllim, përveç që flet e zezë mbi të bardhë ajo që është diskutuar dje, unë si nënkryetar nuk ulem me EURALIUS-in për të diskutuar përmbajtjen teknike të çdo neni, dhe takimi ka qenë me mua. Pra, ai nuk vlen si kryq te kutia për të thënë që u ezaurua. Tani, në këtë histori dhe në mbështetje të asaj që tha zoti Mediu, propozimet tona janë fare normale, prandaj i

marrim dhe i diskutojmë, sepse ndoshta biem dakord edhe për një formulim të tretë, ose biem dakord për formulimin tuaj, por e marrim me një proces të thjeshtë legjislativ dhe nuk asnjë arsye për të qenë kaq të kundërpozicionuar. Duhet patjetër që ky ligj t'i shkojë sa më shpejtë parlamentit për votim, prandaj për këtë arsye duhet të punojmë.

Kemi një grup amendamentesh dhe shumë shpejtë do të vijmë të tjerat. Jemi gati që duke kapur të gjitha parametrat për një progres-raport të favorshëm të diskutojmë më tej për hapjen e negociatave që është shqetësim i përgjithshëm, i kemi të gjitha në kohë për t'i bërë, por këtë ta bëjmë mirë. Edhe kur vetë EURALIUS-i dhe përfaqësuesit e tij nuk do të jenë më në Shqipëri, ky ligj ndoshta do të jetë akoma në zbatim e për rrjedhojë është përgjegjësia e parlamentit shqiptar dhe e ne të dhjetëve këtu, që na kanë dhënë këtë detyrë dhe askujt tjetër, që ta bëjmë mirë këtë gjë dhe ta pranojmë si produktin tonë dhe nesër të mos i vëmë gishtin të huajve që na e bënë ata apo e bënë ata keq, sepse kështu do të ndodhë.

Jo, ky është ligji që do të miratojmë ne me kontributin e çmuar të EURALIUS-it, OPDAT-it dhe ekspertëve shqiptarë. Kështu që nuk e kuptoj se pse duhet të përplasemi për këtë.

Fatmir Xhafaj – Fjalën e ka zoti Vasili.

Petrit Vasili - Unë mendoj, pa iu rikthyer debatit të gjatë dhe polemikës në tavolinë, se kemi tri gjëra të mëdha. Kemi një detyrim që ligjit t'i hapim rrugë që të ecë përpara dhe këtij detyrimi nuk i shmanget dot kurrkush.

Së dyti, kemi një imponim në kohë.

Së treti, kemi një kornizë kushtetuese të këtij ligji, të qartë, që e kemi miratuar konsensualisht dhe së fundi, kemi një mungesë eksperience reciproke, të dyja palët për këtë çështje. Qëndrimi ndaj EURALIUS-it nuk është qëndrim as pro dhe as kundër, por kemi besuar te një eksperiencë shumë më e gjatë, dhe te mbështetja që EURALIUS-i na ka dhënë për këtë proces, dhe një nga promovuesit e fortë të këtij procesi ka qenë vetë opozita, dhe sot është momenti që ta jetësojmë.

Duhet të jemi modestë të gjitha palët që respektin ndaj opinionit të EURALIUS-it nuk e kemi bërë për servilizëm ndaj tij, sepse nuk besoj se ka njeri që vuan nga komplekse të tilla pas 25 vjetësh, por fare qartë kemi mundësinë që të kemi një reflektim të qetë dhe të paanshëm, dhe më të mirën që mund të kemi mund ta kemi nga ata. Ne, të dyja palët, kemi anshmëritë tona, duam apo nuk duam ne, apo kemi shumë merak dhe na duket sikur ajo që propozojmë ne është më e mira. Gjithmonë ai që propozon afektohet me atë që propozon, ndaj unë po them këtë gjë,

se në fund të fundit në mbledhjen e shkuar ne erdhëm me një material të paraqitur nga opozita, i cili kishte të bënte me parimësitë. Pra, disa shqetësime të karakterit parimor, të cilat duheshin reflektuar dhe reflektimi që ne kemi në draft nga EURALIUS-i sipas mendimit tim ka qenë puna konkrete që këto elemente të karakterit parimor të jetësoheshin në draft si ndryshime konkrete që reflektonin edhe ato meraqe që opozita ka, njëkohësisht kishim edhe një qëndrim të qartë se ku nuk e kishim mirëkuptimin e ndërkombëtarëve për këtë proces. Dakordësinë e kemi që një proces të pangjarë gjëkund, dhe që nuk e ka mbështetjen e ndërkombëtarëve, ne nuk do e ndërmerrim dhe këtë e kemi thënë në krye të herës, sepse edhe këtë pozicion të ndërkombëtarëve e kemi pranuar të gjithë bashkë, nuk e ka pranuar vetëm njëra palë.

Rifutja në debatin e teknikaliteteve pa fund nuk na çon gjëkund, prandaj nuk kemi pse të imponojmë njëri-tjetrit as për detaje për të cilat nuk biem dakord dhe as nuk kemi se pse i nënshtrohemi njëri-tjetrit, por ky draft i cili vërtet është ashtu sikurse zoti Bylykbashi thotë, u rindërtua tani në bazë të ndryshimeve kushtetuese që kanë ndodhur, ka reflektime në shumë nene të EURALIUS-it dhe ne kemi një draft pune të mjaftueshëm për të ecur përpara. Ne kemi edhe detyrimin procedural që sot të kemi një draft përfundimtar, në mënyrë që t'i hapim rrugë seancës, dhe nëse në rrugë e sipër, mbas miratimit tonë, do ketë reflektime të reja, siç ndodhi me ndryshimet kushtetuese, këtu jemi, por ama nuk kemi të drejtë që proceduralisht ta pengojmë këtë proces duke u marrë me të gjitha teknikalitetet, ku asnjëri nuk ka autoritetin të thotë që ky është propozimi më i mirë që ne bëjmë, dhe këtij diskutimi i japim fund.

Kështu që, ne sot jemi thirrur për ta bërë këtë detyrë, nuk i shmangemi dot dhe nuk shkojmë dot para opinionit publik dhe të themi se ne nuk e miratojmë dhe pengojmë edhe seancën, sepse na pëlqen ose jo kemi disa afate kohore që janë si shpata e Demokleut që brenda muajit gusht ne duhet t'i kalojmë, në rast se s'duam ta dështojmë procesin. Në rast se do të shkojmë qoftë edhe disa ditë më tej, na rrofshin teknikalitetet dhe një mori ripërcaktimesh dhe riformulimesh, por ne trenin e kemi humbur, pra atë që duam të bëjmë. Pra, do të marrim damkën në Europë, që thanë se ishin dakord dhe donin vettingun, por realisht vettingun e sabotuan po vetë.

Kështu që, propozimi është shumë i qartë dhe shumë konkret. Kemi një draft pune përpara, të ecim me këtë dhe ta miratojmë. Askush nuk e pengon dot as opozitën dhe askënd që të vazhdojë të negociojë me EURALIUS-in në qoftë se gjen mundësinë për të reflektuar ndonjë riformulim të ri për ndonjë çështje të caktuar. Ne këtu jemi dhe po qe se ka të tilla, reflektojmë

përsëri, por ama ne duhet t'i japim konferencës së kryetarëve një draft të miratuar, i cili e hap mundësinë për të ecur përpara me këtë çështje. Kështu që kjo është një rrugë konkrete, një rrugë me produkt dhe që i jep vërtetë zgjidhje këtij procesi.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Vasili! Ka tjetër? Po.

Keltis Kruja - Faleminderit, zoti kryetar!

Duke u nisur nga diskutimi që bëri zoti Vasili, unë nuk mendoj se për shkak të kapje së trenit ne duhet të humbin cilësinë e ligjeve që po bëjmë në mbështetje të Kushtetutës. Sigurisht, afatet janë shumë të rëndësishme dhe këtë e kuptojmë të gjithë, prandaj i bëjmë edhe këto mbledhje dhe prandaj kërkuam që të kishte një rakordim të ekspertëve të të dyja palëve, sigurisht dhe ekspertëve të nderuar të EURALIUS-it dhe OPDAT-it, por askush nga ne si deputetë nuk mund të mbyllë sytë dhe të thotë që këto ligje ne do t'i bëjmë vetëm për hir të kapjes së trenit dhe pastaj këto ligje nuk dimë se si do të zbatohen dhe çfarë kemi shkruar në to, në qoftë se vazhdojmë ta konceptojmë këtë proces, zoti Majko, apriori, si proces i cili duhet të vazhdojë pa lexuar, pa kuptuar dhe pa ditur, të paktën ne që jemi anëtarë të këtij komisioni, se çfarë po bëjmë.

Besoj se nuk po kërkojmë ndonjë gjë e cila e dështon procesin, përkundrazi po kërkojmë diçka e cila e ndihmon atë. Në qoftë se ky komision do të kishte funksionuar normalisht, për çdo nen çdokush nga ne mund të kishte amendamente për të cilat mendonte që ligji bëhej më i mirë. Apo jo? Vullnetin për vettingun, parlamenti shqiptar dhe të gjithë ne këtu, e kemi shprehur dhe kemi bërë Kushtetutën për vettingun. E keni thënë edhe ju, zoti zoti kryetar, në këtë mbledhje, që Kushtetuta mund të zbatohet edhe drejtpërdrejtë, apo jo? Pra, vullneti politik, vullneti ynë këtu dhe vullneti i forcave që përfaqësojmë, është shprehur tashmë dhe është shumë i qartë për të gjithë reformën, specifikisht për procesin e vettingut, prandaj, unë ju ftoj që t'i lëmë retorikat politike.

Zoti Majko, unë prisja nga ju sot se si relator të na flisnit më tepër për teknikalitetet e ligjit sesa për çështjen në përgjithësi. Unë mendoj se këto retorika duhet të marrin fund, jemi këtu për ta shtyrë procesin dhe për ta bërë sa më shpejtë, por insistoj dhe ky është mendimi im personal si deputet, që për shkak të shpejtësisë ne kurrsesi nuk mund të humbim cilësinë e ligjeve që po miratojmë, sepse janë ligje të cilat në mënyrë përfundimtare do t'i japim fytyrë sistemit të ri të drejtësisë që ne duam të krijojmë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Fjalën e ka zoti Ristani dhe pastaj...

Arben Ristani - Mund ta bëjmë shumë të thjeshtë këtë diskutim.

Si gjithmonë procedura ka vendin e vet. Tani jemi përpara këtij fakti që mundet që të biem dakord të gjithë bashkë që projektligjin ta bëjë nga fillimi në fund EURALIUS-i dhe ne nuk e diskutojmë fare, por e çojmë direkt në seancë dhe diskutohet atje. Ky është njëri variant, por jemi këtu që ekspertët tanë në bashkëpunim me ekspertët e EURALIUS-it të na bien materialin bazë mbi të cilin ne do të punojmë, të paktën kështu kemi rënë dakord dhe këtë procedurë kemi zgjedhur. Kështu që është fare normale që ne ta shikojmë produktin që ata kanë nxjerrë dhe ta debatojmë të gjithin, sepse siç pamë edhe në ditën që kaluan kishte nene si ato të medias për shembull të futura pa u diskutuar të cilat shkaktuan një reaksion publik shumë të madh dhe që për hir të së vërtetës nuk mund të fund kaçakshe në materialin tonë të punës.

Pra, ose do të kemi një material të cilin e përpunojnë ekspertët, e debatojnë, e sjellin në tavolinë, e bisedojmë ne me njëri-tjetrin, dhe është tjetër gjë që biem ose jo dakord, por raste si ai i medias ku nenet për ndalimin e lirisë së medias, për dhunimin e gazetarëve të mos na futen pa u parë, debatuar dhe shqyrtuar nga ky komision, ose ndërrojmë procedurën dhe ta bisedojmë që a ia vlen ta çojmë direkt draftin e tyre në parlament pa e kaluar në Komision. Unë nuk besoj se është kjo rruga, por kemi një material bazë, e diskutojmë, themi ne mendimin tonë, ju tuajin, biem në një dakordësi përfundimtare dhe e çojmë në seancë parlamentare.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ristani! Zoti Manja e ka fjalën.

Ulsi Manja - Faleminderit, kryetar!

Edhe unë për procedurë e mora fjalën.

Ka gati një orë që ne po diskutojmë dhe po i biem rrotull se si ta fillojmë diskutimin e këtij projektligji në këtë komision. Tani mua më duket se ky është një projektligj i zakonshëm që ndjek të gjitha procedurat e diskutimit në komision siç e ka përcaktuar rregullorja e Kuvendit, por ky projektligj merr rëndësi për shkak se është pjesë e një pakete ligjore që i referohet ndryshimeve kushtetuese që kemi bërë. Pra, pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, ky projektligj duhet të trajtohet pa shumë retorikë politike nga ky komision, si një projektligj dhe si diskutim teknik që i hap rrugë atij procesi kushtetues që ne kemi miratuar. Tani unë nuk e di se pse duhet të zgjatemi, sepse baza e diskutimit në këtë komision e këtij projektligji është mbi tavolinë dhe ne kemi këtu një projektligj të hartuar nga ekspertët e EURALIUS-it dhe OPDAT-it. Në të gjitha nenet e këtij projekti thuhet se janë reflektuar sugjerimet dhe komentet që janë bërë në

mbledhjen e kaluar nga kolegët e opozitës dhe unë nuk shikoj asgjë të keqe se pse të mos e fillojmë diskutimin nen për nen të projektligjit. Pra, mbi këtë bazë që kemi dhe ato sugjerime dhe komente që ka nen për nen secili prej ne anëtarëve të Komisionit, që jemi në këtë tavolinë, qoftë të kolegëve të opozitës, por edhe ne, ta fusim diskutimin në procedurë duke iu referuar secilit nga nenet që do të diskutojmë në këtë komision. Pra, baza e projektligjit është, por nëse thuhet që ta nisim diskutimin me një projektligj që është hartuar tërësisht nga ekspertët e opozitës, atëherë i bie që mbi tavolinë kemi dy projektligje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Të lutem, zoti Mediu, zoti Bylykbashi, kur folët ju nuk ju ndërhyri njeri!

Ulsi Manja - Më fal, unë e kam marrë nga ju mbrëmë dhe nuk janë thjesht amendamente, sepse janë 25 amendamente, por thuhet se si do të ishte projektligji bashkë me këto amendamente. Pra, unë them që ta vazhdojmë diskutimin për procedurë, nen për nen dhe secili nga ne të bëj vërejtjet dhe sugjerimet që ka për nene të caktuara.

Fatmir Xhafaj – Ka tjetër gjë për procedurë?

Vasilika Hysi - Kam unë një gjë.

Fatmir Xhafaj – Fjalën e ka zonja Hysi dhe pastaj e mbyllim.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, unë dua të sjell në vëmendje nga pikëpamja procedurale dy çështje.

Çështja e parë lidhet me aneksin e Kushtetutës, ku në aneksin e saj, në nenin c, pika 6, thuhet që nëse Presidenti nuk e përfundon procesin brenda 45 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij aneksi, kjo kompetencë i kalon Avokatit të Popullit, çka do të thotë që i gjithë procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të komisionit të pavarur të kualifikimit të gjyqtarëve të Kolegjit të Apelimit dhe komisionerit publik duhet të përfundoj në datën 20 shtator. Duke pasur parasysh që sot jemi në datën 23 dhe akoma nuk kemi filluar, pas reflektimeve që u ka bërë EURALIUS-i sugjerimeve dhe komenteve tona, diskutimin nen për nen, pra që të bëjmë gati ligjin, ta kalojmë në seancë, ta miratojmë dhe t'ia çojmë Presidentit për dekretim, të botohet në Fletoren Zyrtare dhe të hyjë në fuqi, në këtë mënyrë ne nuk i japim shtysë procesit, por e shpartallojmë atë dhe e bëjmë nul. Kolegu parafolës i opozitës tha që nuk mundet që, për hir të afateve, të prekim cilësinë.

Të nderuar kolegë, ky komision në datën 20 qershor ka dëgjuar për herë të parë në parim të shtatë projektligjet, përfshirë dhe projektin e rivlerësimit. Kemi pasur shumë mbledhje të komisionit, diskutim në parim, diskutim nen për nen, dhe projekti që ne kemi sot është goxha i përmirësuar në krahasim me variantin e depozituar dhe të diskutuar në datën 20 qershor, pasi janë reflektuar shumë nga diskutimet në komision dhe ndryshimet kushtetuese. Gjithashtu, patëm edhe një dëgjesë.

Nëse ju thoni që ky komision nuk ka funksionuar në mënyrë normale, këtë duhet ta tërhiqni mbrapsht, sepse ky komision ka funksionuar në mënyrë normale, dhe anormale ka qenë mospjesëmarrja juaj në komision. Keni procesverbale të bëra publike, i keni në faqen e internetit, siç e kanë rregullat e botimit të procesverbaleve, kemi diskutime nen për nen, prandaj hyni dhe lexojini të gjitha diskutimet dhe të gjitha vërejtjet që ne kemi bërë. Ndërkohë nga data 20 qershor deri sot, në datën 23 gusht, janë plotë dy muaj dhe secili prej jush dhe nesh ka pasur mundësi t'i lexojë një për një të gjitha sugjerimet. Mos harroni, të nderuar kolegë, që neni 6 i projektligjit, ku flitet për kriteret e zgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, ka lënë disa afate për depozitim të aplikimeve te Presidentit, për shqyrtimin, për dërgimin dhe ngritjen e tyre. Atëherë, do vazhdojmë ta shkelim Kushtetutën, që sapo e miratuar bashkë dhe ndryshimet kushtetuese? Afati 20-ditor do të thotë që ky proces, pra përzgjedhja nga Presidenti, dërgimi i listave qoftë të anëtarëve të komisionit, të kolegjit dhe të komisionerëve publikë, duhet të përfundojë.

E fundit, dhe e kam përsëri për procedurë, zoti kryetar. Unë nuk arrij të kuptoj se si mund të pranojnë dy palë dy afate për dorëzimin e mendimeve. Në praktikë nuk ka ndodhur ndonjëherë që kur diskutojmë një projektligj nen për nen të themi që po riformulojmë 25 nenet e para dhe nga data 27 po sjell edhe 20 të tjera dhe nga data 20 shtator 20 të tjera, për t'i bërë 65, sa janë në ligj dhe pastaj hajde ta diskutojmë.

Më fal, zoti Mediu, propozimet e opozitës janë depozituar, iu dërguan edhe EURALIUS-it na u sollën edhe neve.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, është procedurë tjetër, por të paktën këtu në Komision nuk mund të mohojmë dhe të fillojmë procesin nga zeroja, sepse është shumë injoruese për të gjitha procedurat parlamentare, të Rregullores së Kuvendit, të gjitha ato mbledhje që janë zhvilluar, të cilat janë të dokumentuara dhe që i keni në procesverbal në internet. Tani thoni që ato nuk janë normale

sepse nuk më ka dashur qejfi mua që të vija. Prandaj, të kishit ardhur ashtu siç vinim ne dhe bënim mbledhje çdo ditë. Prandaj, të fillojmë diskutimin dhe të shikojmë të gjitha ndryshimet siç i ka reflektuar EURALIUS-i, dhe nëse ka gjëra që mund të ndryshojë, t'i diskutojmë dhe t'i ndryshojmë, për të qenë në përputhje me Kushtetutën, por kurrsesi nuk mund të thuhet që të fillojmë nga fillimi se nuk kemi qenë ne.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, zonja Hysi tha diçka që është shumë serioze, në fakt.

Fatmir Xhafaj - Më fal, në parim kam një sugjerim dhe ndoshta një vërejtje dashamirëse për ju kolegë të opozitës.

Kur flisni ju, kolegët e mi të maxhorances nuk ndërhyjnë dhe ju dëgjojnë me vëmendje pavarësisht se mund të mos bien 100% dakord me ato që thoni ju, por është respekt i ndërsjellë. E kundërta ndodh kur flasin kolegët e maxhorancës dhe kjo nuk është korrekte. Dëgjojini me vëmendje, siç ju dëgjojnë, dhe argumentet që keni kundër mund t'i thoni. Kam edhe një gjë tjetër: kur flitet për procedurë, nuk mund të flitet tri herë, zoti Bylykbashi, sepse deri tani keni folur dy herë.

Oerd Bylykbashi – Zoti Kryetar, zonja Hysi sapo ka thënë një gjë shumë serioze, përtej ligjit që po diskutojmë.

Fatmir Xhafaj – Është e drejtë e zonjës Hysi dhe ju nuk jeni këtu për të korrektuar zonjën Hysi dhe fjalimet e deputetëve. Në qoftë se do të mbani këtë rol, mbajeni, por e keni gabim.

Oerd Bylykbashi - Zoti Xhafaj, ju keni qenë pjesëtar i komisioneve të tjera *ad hoc*, por në ato që kam qenë unë, anëtarët e komisionit, sidomos komisionet paritare si ky, dhe kjo ka rëndësi të madhe për të treguar se çfarë vlere ka roli i palëve në këtë proces, anëtarët kanë folur sa herë e kanë çmuar të nevojshme sepse qëllimi është produkti më i mirë. Nëse unë ezauroj dhe dikush tjetër thotë diçka që është më e rëndë sesa aq, dhe të mos flas, kjo do të thotë që ne nuk po bëjmë punën tonë këtu dhe e kemi për detyrë që ta bëjmë ligjin mirë. Sigurisht, që është fyerje e procedurave parlamentare nëse ky komision shqyrton një ligj që nuk ka bazë kushtetuese. Nëse do të ishim të gjithë së bashku siç jemi te Komisioni i Ligjeve, gjëja e parë që relatori do të thoshte është që është apo jo në përputhje me Kushtetutën dhe kjo nuk ishte, sepse ai ligj nuk kishte bazë kushtetuese në atë moment, por sot e kemi dhe është e superuar. Po ju propozojmë

një gjë shumë të thjeshtë, dhe nëse nuk doni ta bëni votim në parim, nuk ka rëndësi, është puna juaj. E para kjo.

Së dyti, nuk mundet që një faqe e gjysmë apo dy faqe të ezaurojnë shqetësimet teknike apo principiale që kemi ne, përderisa thuhet se janë të dobishme, por vendosëm që të mos i marrim në shqyrtim. Askush nuk e di se si, qysh, tek, me kë u diskutua dhe si u vendos dhe për rrjedhojë sigurisht kemi ne të drejtën që t'i bëjmë propozimet tona nga e para tek i fundit sepse kjo është procedurë e thjeshtë dhe nuk e kuptoj se pse duhet të shqetësohemi për këtë punë. Biem dakord ose jo, por po vij te çështja serioze për të cilën e mora fjalën.

Zonja Hysi këtu sapo na tha që Presidentit të Republikës do t'i merret kompetenca, në datën 20 shtator, ndërkohë që Presidenti i Republikës nuk është ende në mundësinë për ta ushtruar këtë ashtu siç duhet dhe për të bërë vlerësimin e kandidaturave si organ i përcaktuara nga Kushtetuta mbi bazën e kritereve që do të përcaktojë ligji. Nëse dispozita për Avokatin e Popullit është në përplasje, siç ka ndodhur neni tjetër i përplases që ka me kompetencat e Presidentit, hajde ta zgjidhim këtu. Në qoftë se qëllimi është në keqbesim, që procesi t'i hiqet Presidentit edhe kur ligji s'ka kaluar akoma, atëherë këtu ka një gjë të rëndë. Kështu që, zonja Hysi, ne me këtë ligj duhet të rregullojmë edhe këtë lloj problemi që i keni shkaktuar në draftim funksionimit të Kushtetutës. E zgjidhim edhe atë, por në qoftë se keni për qëllim që nëpërmjet kësaj t'i hiqni kompetencën Presidentit dhe t'i thoni që...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më falni ta mbaroj. Unë kërkoj ndjesë për ndërhyrjen më parë, por për këtë arsye mos ndërhyjni ju.

Në qoftë se do t'ia marrim dhe t'i themi që kishe vetëm 10 ditë, se aq kohë të lamë dhe do t'ia japim dikujt tjetër se ai na pëlqen më tepër, ky është problem i madh, sepse bie ndesh me nenin kushtetues. Kështu që, shpresoj shumë që të jetë një lajthitje në këtë histori, jo juaja por e përgjithshme, dhe t'i japim zgjidhje bashkë.

Rikthehem te propozimi i thjeshtë.

Ta fillojmë procedurën dhe të ecim me shpejtësi përpara. Kemi amendamente të bëra, diskutojmë dhe po nuk ratë dakord, është histori tjetër

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Aldo Bumçi - Unë dua të them dy fjalë. Besoj se të gjithë e mbajmë mend që opozita i kishte ndryshimet kushtetuese dhe paketën ligjore bashkë dhe kërkonte që të kaloheshin në

datën 21 korrik të dyja. Fatki që ne ndamë ndryshimet kushtetuese nga paketa ligjore është një akt që ju duhet ta mbani shënim, sepse ne nuk kemi mundësi të ndikojmë dhe nuk kemi votat këtu, por i kishim atje. Ky akt i ndarjes së paketës kushtetuese nga ndryshimet ligjore erdhi me disa garanci që kur të kaloj paketa ligjore, vullneti i opozitës do të merrej parasysh. Në qoftë se ju tani që kaluat paketën kushtetuese, ne treguam edhe këtë mirëbesim që i ndan të dyja, veproni në këtë mënyrë, mendoj se nuk ndihmon dhe rruga e shkurtër ka për të dalë më e gjatë. Uroj që të mos jetë ky rasti!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Besoj u ezauruan dhe nuk ka ndonjë tjetër për komente procedurale. Unë dua të bëj me dije dy-tre momente në gjykimin tim, sepse besoj se kam edhe unë të drejtën që të bëj koment për çfarë u diskutua.

Së pari, dua të them që ky është një proces në vazhdim, nuk është një proces që fillon sot, sepse ky proces ka muaj që ka nisur, për hartimin e këtij projektligji dhe ka ecur paralelisht me hartimin e projektit kushtetues dhe është debatuar paralelisht dhe njëkohësisht me projektin kushtetues mbështetur në një draft të përgatitur nga ekspertët dhe nga e ekspertiza më e mirë ndërkombëtare dhe i konsultuara nga Komisioni i Venecias për shkak të konsultimit që i ka bërë aneksit kushtetues i cili është edhe shumë i detajuar sa që siç e kam thënë edhe herë të tjera edhe drejtpërsëdrejti mund të implementohet. Pra, nuk është një proces që nis sot, dhe përpjekja për ta kthyer në pikën zero është një përpjekje e gabuar dhe nuk i shërben nevojës për të ndërtuar një proces të shëndetshëm në të gjithë këtë debat.

Së dyti, ky është një ligj i rëndësishëm dhe biem të gjithë dakord për këtë gjë. Është një ligj i rëndësishëm dhe këtë gjë e kemi thënë dhe stërthënë, jo thjesht për atë çfarë kërkon të zgjidhë, por edhe për shkak të faktit që është një ligj delikat dhe është fat për ne që jemi asistuar në këtë proces, për shkak se me kapacitetet tona të brendshme, me gjithë respektin që kam unë për ekspertizën shqiptare, do ta kishim pothuajse të pamundur për të ndërtuar një ligj të kësaj natyre për arsye edhe të mungesës së eksperiencave edhe për efekt të traditës në këtë fushë por edhe për arsye të tjera objektive dhe subjektive. Pra, në këtë kontekst, prania dhe asistenca, kontributi i ekspertëve ndërkombëtarë, i EURALIUS-it, por edhe i OPDAT-it, për atë masë që është angazhuar, në mënyrë të veçantë edhe i ekspertizës së Brukselit, e ka sjellë këtë ligj, në gjykimin tim, por dëshiroj dhe besoj që të jetë edhe gjykimi i të gjithë kolegëve, në parametra të shëndetshëm dhe që e bëjnë një ligj të standardeve të mira ndërkombëtare.

E kam thënë edhe radhën e parë dhe po e përsëris përsëri: ky ligj nuk është gjë tjetër veçse reflektimi i parashikimeve që ka bërë Kushtetuta. Ne e kemi votuar këtë gjë dhe kemi rënë dakord, e kemi votuar në parim dhe nën për nën të Kushtetutës unanimit, në mënyrë konsensuale, me 140 vota, dhe nuk ka se çfarë diskutimi tjetër të bëjmë për vullnetin për ta hartuar këtë projektligj. Përkundrazi, tani ajo që ka mbetur është për ta detajuar për atë që mund të detajojmë për shkak se korniza kushtetuese është e qartë. Nëse ka këtu një gjë që bie në kundërshtim me Kushtetutën, jam dakord ta diskutojmë. Pjesa tjetër është një stërzgjatje e një debati të panevojshëm që bëhet.

Natyrisht, këtu u fol për çështjen e ekspertizës dhe besoj se jemi të qartë. Ekspertët e Partisë Demokratike janë ekspertë të deputetëve të Partisë Demokratike. Jemi dakordësuar që në nisje të këtij procesi që ekspertë të komisionit do të jenë ekspertët e EURALIUS-it dhe OPDAT-it dhe jemi dakordësuar në një marrëveshje që kemi bërë ndërmjet nesh së bashku me përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Europian në Tiranë, që në nisje të këtij procesi, se ekspertiza e tyre do të jetë ekspertiozë përcaktuese për procesin, për arsye që janë të njohura dhe të pranuar nga ne. Ka qenë marrëveshje politike që ne e kemi bërë, dhe prandaj ata janë aty në atë tavolinë. Nga kjo pikëpamje askush nuk i ka përjashtuar ekspertët e opozitës, ata janë ekspertë të opozitës në ndihmë të saj dhe të ndihmojnë deputetët e opozitës për t'ua lehtësuar atyre punën në këtë proces.

Po e marrim të mirëqenë...

Oerd Bylykbashi - Mos i vendos ndërkombëtarët në siklet se nuk është kjo marrëveshja! Ata janë pjesë e grupeve të punës.

Fatmir Xhafaj - Po e marrim të mirëqenë. Kemi një projektligj të hartuar në mënyrën që thamë, kemi disa komente të opozitës, të cilat janë parë me shumë dashamirësi dhe me shumë konstruktivitet nga ana jonë dhe, në mënyrë të veçantë, nga ekspertiza ndërkombëtare. Ju sollët disa komente, sollët një opinion, ekspertët që kanë punuar me projektin i morën në konsideratë dhe kanë bërë ndryshime gati në mbi gjysmën e neneve të këtij projektligji, duke reflektuar çështje të caktuara mbi opinionin tuaj. Diskutimi këtu tani është në komision, nuk është më në nivel ekspertësh. Ju keni gjithë të drejtën që për çështje të caktuara që nuk bini dakord thoni: ne nuk biem dakord me këtë, kemi këtë propozim dhe do të vazhdojmë t'i diskutojmë përkatësisht. Ne bëjmë një ndryshim rregull nga kjo gjë, që i dhamë mundësinë për t'i prezantuar çështje të caktuara zotit Bardhi, që është eksperti juaj, pikërisht për ta bërë më të qartë dispozitën, për të

ndihmuar edhe komisionin. Dhe kjo përsëri ishte një qasje shumë luajale, konstruktive për ta ndihmuar procesin dhe nuk e kuptoj përse do të duhet që të bëhet një retorikë kaq agresive për një proces fare normal.

(Diskutime pa mikrofon)

Dua të them që cilësia e projektligjit është pasur në vëmendje nga ky komision. Po ju them një gjë: hapni procesverbalet, ku ka diskutime të tëra nga anëtarët e komisionit, nga të gjashtë ne që jemi këtu. Kemi ngritur çështje të ndryshme dhe janë përgjigjur ekspertët. Pra nuk është se nuk është ezauruar procedura parlamentare, shqetësimi i deputetëve, pjesëmarrja e deputetëve në këtë proces. Është e palogjikshme kjo mënyrë arsyetimi nga ana juaj, është e padrejtë kjo që kërkon të na impononi. Përkundrazi është bërë një diskutim goxha aktiv në këtë komision lidhur me përmbajtjen e projektligjit, kur është paraqitur për herë të parë. Janë bërë vërejtje, janë bërë sugjerime dhe janë reflektuar. Erdhët ju, bëtë edhe ju vërejtje dhe sugjerime dhe po reflektohen. Ku është dallimi këtu?! Ky është një proces parlamentar në funksion të cilësisë. Pse kur shtroni ju pyetje dhe propozime qenka në funksion të cilësisë, kur kanë folur deputetet e maxhorancës nuk qenka në funksion të cilësisë! Kjo është e gabuar. Dhe nuk është i drejtë ky lloj gjykimi me sy standarde.

Për sa u përket edhe afateve, edhe këtë duhet ta pranojmë, ka edhe një lloj përgjegjshmërie politike në këtë histori. Dhe zonja Hysi nuk tha që i merret kompetenca presidentit, por afatet e caktuara për kompetencën e presidentit na imponojnë ne të ecim më shpejt. Kjo ishte logjika e zonjës Hysi, që do të thotë të ecim jo me afate të imponuara dhe nga ana tjetër duhet të mbajmë parasysh se ne jemi njerëz politikë, që kemi përgjegjësi politike para qytetarëve, por edhe përpara disa qëllimeve të mëdha që ka ky vend, siç është qëllimi i integritetit. Dhe na është thënë se është e domosdoshme që brenda 30 gushtit kjo të kalojë, që edhe vendet anëtare të BE-së të shikojnë një vullnet pozitiv të shprehur nga klasa politike shqiptare. Çfarë problemi ka këtu, nëse ne këtë gjë jo thjesht e deklamojmë, por e zbatojmë. Pastaj përpjekjet për ta çmontuar gjithë këtë, për ta rinisur nga e para dhe për ta futur në procedura pa fund, nuk më duket se janë të shëndetshme.

Fatmir Mediu – A ka të drejtë ky komision të marrë vendime? Dhe nëse po, a duhet të kërkojë zbatimin e vendimeve? Ka një vendim të mbledhjes së fundit: që duhet të ulen ekspertët me njëri-tjetrin për të arritur në një draft përfundimtar, që do t'i përcillet komisionit.

Fatmir Xhafaj – Jo, jo më vjen keq.

Fatmir Mediu - Më fal, ta mbaroj Oerd, të lutem!

Fatmir Xhafaj – Opozita ka ekspertë, ja ku e ka në tavolinë dhe po e trajtojmë me shumë respekt, si askënd tjetër.

(Diskutim pa mikrofon)

Po mirë pra, atëherë për sa kohë që thua e kam detyrim, do të thotë që po e bëj këtë gjë, po e njoh si të tillë. Po e ul përballë meje dhe kjo tregon respekt edhe për ekspertizën tuaj.

Fatmir Mediu – Zoti Xhafaj, ne jemi në kohë dhe në limite për shkak të moszbatimit të vendimeve tona. Dakord? Prandaj e bëjmë këtë diskutim dhe kemi një orë që diskutojmë. Vendimi ynë, me propozimin e zotit Majko, ka qenë që ekspertët të ulen me njëri – tjetrin për të arritur që të konkludojnë për pikat që bien dakord dhe për pikat që nuk bien dakord të mund të debatohet këtu.

Unë si anëtar i komisionit dua të di, meqenëse është marrë ky vendim, a ka ndodhur që janë ulur ekspertët me njëri- tjetrin, apo jo? Vetëm kaq dua të di unë.

Fatmir Xhafaj – E para që të bësh një pyetje të tillë dhe të marrësh përgjigje, duhet të bësh një pyetje të bazuar, por pyetja juaj është e pabazuar për shkak se nuk ka një vendim për këtë gjë. Ne nuk marrim vendime të kësaj natyre. Ne jemi ulur në këtë sallë, kemi dëgjuar me shumë respekt opinionin zyrtar të paraqitur nga ju, u kemi dhënë mundësi atyre që janë marrë me hartimin e ligjit të reflektojnë, kanë reflektuar, i kanë sjellë reflektimet dhe ne sot do të debatojmë. Është proces normal.

Fatmir Mediu – Edhe një herë, unë si anëtar i këtij komisioni mbaj mend dhe e kam mbështetur si konstruktiv propozimin e zotit Majko, që ne mbas këtij diskutimi, ose mbas prezantimit që bëri zoti Rajner, në gjykimin dhe vlerësimin e opozitës, me vlerësimin e ekspertëve të BE-së, që të ulen ekspertët.

Fatmir Xhafaj – U ulën dhe na kanë sjellë këtë draft me nenet përkatëse. E kanë marrë në konsideratë...

Fatmir Mediu - Për këtë po pyes. Nëse janë ulur, kërkoj ndjesë. Këtë më thuaj, që janë ulur. Një herë më thua që nuk ka vendim për t'u ulur, njëherë më thua...

Fatmir Xhafaj – Më fal, ata janë hartues dhe ne u kemi thënë: ky është mendimi i ekspertëve. Ata e kanë marrë mendimin e ekspertëve tuaj dhe e kanë kthyer në normë. Kanë ardhur këtu dhe e kanë kthyer në normë. Ke gjysmat e neneve...

Fatmir Mediu – Edhe një herë, a ka mundësi zoti Xhafaj, të paktën nga praktika ligjore ishin disa konsiderata, siç e tha zoti Vasili, në parim, të cilat patën një reflektim nga ekspertët e BE-së. Ka disa vlerësime bazuar mbi këto parime që kthehen në amendamente kushtetuese.

Fatmir Xhafaj –Po, do t'i thoni...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Mediu– Po pse e latë ju 4 ditë takimin, për të mos thënë 5 ditë?

Fatmir Xhafaj – U bënë amendamentet. Janë riparë të gjitha amendamentet. Gjysma e amendamenteve janë riparë, i ke këtu gjysmën e amendamenteve të reflektuara.

Fatmir Mediu –Amendamentet e kujt, se ne nuk kemi bërë amendamente?

Fatmir Xhafaj – Mbi bazën e opinionit tuaj.

Fatmir Mediu – Po me kë e diskutojmë këtë opinion?

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë?

Vazhdojmë.

A keni ndonjë gjë për nenin 1?

Oerd Bylykbashi – Për nenin 1 kemi një amendament të paraqitur, e keni përpara. Mund të bëj një prezantim të shkurtër, zoti Bardhi.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Bardhi një prezantim.

Gazmend Bardhi – Faleminderit!

Ka një riformulim që është, në fakt, teknik, mënyra si është shkruar neni 1 në projektligjin e paraqitur komisionit, i referohet përmbajtjes së projektligjit që i korrespondon objektit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Qartë.

A ka ndonjë mendim për nenin 1, për këtë ndërhyrje të zotit Bardhi?

Vasilika Hysi – Unë nuk jam dakord me ndërhyrjen e bërë nga kolegët. Fakti..

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Edhe një herë, të lutem, mos e mbyll mikrofonin! Mbaroje fjalinë!

Gazmend Bardhi - Unë nuk e mbarova, por ngaqë ndërhyri zoti Majko, e ndërpreva fjalën time.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Po ju them se kam shumë respekt për ju personalisht dhe për punën tuaj. Kjo ka të bëjë me bindjen time të brendshme. Për çdo njeri që i kushton këtij projektligji qoftë edhe një gjysmë ore, jo më një ditë apo 10 ditë, sa i keni kushtuar ju, unë kam një respekt të veçantë.

Ju lutem shumë ju bëni detyrën tuaj, deputetët kanë punën e tyre. Ju keni për detyrë të flisni, po morët fjalën.

Gazmend Bardhi – Unë e ndërpreva fjalën për respekt.

Fatmir Xhafaj – Jo, respektin e përcaktoj unë.

Gazmend Bardhi – Ju kërkoj ndjesë!

Mënyra si është formuluar neni 1 i referohet përmbajtjes së projektligjit, që i korrespondon objektit, ndërkohë që dispozita e qëllimit ka si qëllim të përcaktojë pasojën pozitive që do të sjellë ligji. Në këtë rast, pasoja pozitive që sjell ky ligj, është të identifikojë funksionarët e sistemit të drejtësisë që janë të përshtatshëm për të vazhduar ushtrimin detyrës së tyre publike. Ky është formulimi që ne kemi bërë.

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Hysi kishte një koment.

Vasilika Hysi – Unë nuk jam dakord me riformulimin, pasi në riformulimin që i bëhet nenit 1 duhet të kemi parasysh përmbajtjen e germës së Kushtetutës, konkretisht të nenit 179, germa “b”, paragrafi i parë, ku thuhet se cili është qëllimi i sistemit të vlerësimit. “Sistemi i vlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës pavarësia e sistemit si dhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet”. Pra, nuk thotë Kushtetuta të identifikohet se cilët funksionarë të sistemit të drejtësisë janë të përshtatshëm apo janë të papërshtatshëm. E para.

E dyta, shprehja që ju përdorni në mendimin, “identifikimi i funksionarëve të sistemit të drejtësisë që janë të përshtatshëm për të vazhduar në ushtrimin e detyrës”, nuk është e saktë edhe për një arsye të dytë. Vlerësimi që bëhet nuk ka për qëllim vetëm të përcaktojë të papërshtatshmit dhe t'i nxjerrë jashtë sistemit, por ka një kategori funksionarësh të sistemit të drejtësisë që janë të pastër për nga figura dhe pasuria, por kanë mangësi në formimin tyre dhe qëllimi është që ata të vazhdojnë të kualifikohen. Pra, nuk është se është i papërshtatshëm dhe del nga sistemi. Ju këtë kategori me këtë formulim që bëni, e lini të parregulluar. Ndoshta do të ishte mirë që të shtohet pikërisht te neni 1 i ligjit qëllimi që ka neni 179 germa, “b”, por jo pjesa e parë, ku thuhet “identifikimi”. Neni mund të lexohet. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i

rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjitha subjekteve të rivlerësimit sipas parashikimeve të nenit 179 “b” të Kushtetutës, me qëllim.

Në nenin 179 “b” thuhet: “Të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit, si edhe të rikthehet besimi i publikut”. Nuk ju pëlqen “citimi i nenit 179 “b” dhe doni fjalët, mund të vihet. Pra, zëvendësohet neni 179, germa “b” me fjalët e Kushtetutës, por jo pjesa e parë e fjalisë.

Fatmir Xhafaj – Po. A ka komente të tjera?

Zoti Mediu.

Fatmir Mediu – Zonja Hysi sapo tha që mund të ndryshojë neni 1. Për ta shprehur qartësisht, thatë ju, në vend të nenit 179, germa “b”, mund të vendosim fjalët që janë në Kushtetutë. Unë do të doja që në këto raste, kur ne kemi mosdakordësi, sepse zonja Hysi ra dakord me një pjesë të formulimit që kemi bërë ne, nuk ra dakord me pjesën e parë, nuk është mirë të themi “jo” për çdo gjë.

Unë do të doja edhe mendimin e ekspertëve të EURALIUS-it, si e shikojnë ata të arsyeshme. Meqenëse ata kemi gjyqtar, për çdo rast, në mosdakordësinë tonë le të kemi gjykimin e dytë.

Fatmir Xhafaj – Po këtu nuk ka se për çfarë të shprehet Euaralius-i. Ky është qëllimi i ligjit dhe më duket se është i qartë.

Dëshironi të dëgjoni komentin e EURALIUS-it?

Po, zoti Rajner a keni koment?

Zoti Mediu kërkon komentin tuaj.

Rainer Deville – *(përkthen përkthyesja)* Këto ndryshime na janë *(nuk kuptohet fjala)* edhe në gjuhën shqipe. Nuk janë paraqitur në anglisht dhe nuk janë prodhuar me track change ku ne mund të shikojmë ndryshime.

Mbetet shumë e vështirë për ne që të shikojmë, të vlerësojmë nëse këtu është ndryshuar vetëm formulimi apo përmbajtja e nenit. Sipas vlerësimit të parë, të bërë nga zonja Hysi, mua më duket se ndryshimet këtu kanë të bëjnë me përmbajtjen e nenit dhe unë do të isha i opinionit që t’i qëndronim versionit të mëparshëm.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Pra, kemi një paraqitje të amendamentit, kemi një kundërshtim të amendamentit nga zonja Hysi dhe kemi dhe një qëndrim të zotit Rajner që thotë t'i mbahemi amendamentit siç është paraqitur.

Oerd Bylykbashi – Sapo dëgjova përfaqësuesin e Euaralius-it, i cili sugjeroi që të rrëzohet amendamenti, pra të mbetet me tekstin, pavarësisht meritës që ka, për faktin e thjeshtë që nuk është i përkthyer. Në këtë parlament kjo është gjuha zyrtare dhe nëse ka nevojë të përshtatim procedurat që ekspertiza të jetë efikase, le t'i marrim ato masa. Po ky nuk është as arsyesim, as bazë logjike për të rrëzuar amendamentin e gjysmës së këtij komisioni. Megjithatë, le të vazhdojmë më tutje, ne kemi prezantuar këtë amendament, që është qartazi shumë më i saktë. Me ndërhyrjen që bëri zonja Hysi, me referimin e formulimit të nenit 179 germa “b”, paragrafi i parë, i bie që të rrëzohet neni 1. Kjo do të thotë që paskemi vend për të punuar, por të procedojmë më tutje, nuk ka problem.

Fatmir Xhafaj – Ju lutem! Relatori dakord?

Pandeli Majko – Tani, në cilësinë e relatorit, them se mund ta diskutojmë edhe për të kaluar radhën, të diskutojmë çdo nen sipas propozimeve të Partisë Demokratike.

Zotërinj, që në datën 21 kanë ardhur me email të gjitha propozimet që ju keni dërguar. Janë parë nga grupi i ekspertëve dhe nga EURALIUS-i dhe nga OPDAT-i dhe është thënë: Këto janë të pranueshme. Tani unë mendoj se kur diskutojmë këtu dhe biem dakord që në çdo rast keqkuptimi midis palëve do të jenë ekspertët e EURALIUS-it dhe OPDAT-it, që do të thonë fjalën e fundit, është e kotë që ne të vazhdojmë të diskutojmë. Të gjitha nenet ku EURALIUS-i dhe OPDAT-i janë shprehur kundër, ne nuk do t'i votojmë. Është esenciale. Unë kam që në datën 21 që bashkë me kolegët e mi e kemi parë nen për nen.

Tani nëse do ta bëjmë si rutinë që të diskutojmë të gjitha propozimet që janë rrëzuar nga EURALIUS-i dhe OPDAT-i dhe të vazhdojmë ta vëmë ekspertin që, në fakt, në Shqipëri nuk ka asnjë ekspert për vettingun, por është proces për të cilin Brukseli dhe Uashingtoni ka vendosur autoritetin e vet. Tani çfarë diskutimi ekspertësh, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës kërkoni?

Ju lutem, ka nene, ku janë pranuar propozimet tuaja që keni depozituar pranë komisionit, me bold, të gjitha propozimet që janë parë nga ekspertët, edhe të EURALIUS-it dhe OPDAT-it dhe unë mendoj që ne të ecim mbi nenet që janë pranuar. Nëse ne do duhet të

diskutojmë vetëm për rutinë që ju të na e thoni dhe ne të themi bashkë me ekspertët e OPDAT-it dhe të EURALIUS-it, nuk jemi dakord, të ecim.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 1.

A jeni dakord me amendamentin? Kundër? Abstenim?

Atëherë, mbetet siç është amendamenti i paraqitur nga ekspertët.

Neni 2. “Objekti i ligjit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi - Të regjistrohet sa vota janë kundër për nenin për të cilin u refuzua amendamenti pa diskutim.

Fatmir Xhafaj – Neni 2. “Objekti i ligjit.”

Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Për këtë nen kemi një amendament që do ta prezantojë zoti Bardhi.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Bardhi.

Gazmend Bardhi - Në nenin 2 është bërë shtesa: “ Edhe për çështje të tjera që trajton ligji”, konkretisht lidhur me të drejtat e subjekteve të rivlerësuara, si dhe me rolin e organeve shtetërore, si dhe personave juridikë apo fizikë në dhënien e informacionit, sepse ligji parashikon edhe detyrimet e organeve të treta për të dhënë informacion, dokumente apo akte, organeve të rivlerësimit. Dhe kjo është pjesë thelbësore e ligjit që duhet të përfshihet në objekt hetimi. Ky është ndryshimi, formulimin e keni përpara.

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Unë sugjeroj që neni 2 i projektligjit të mbetet kështu siç është për dy arsye: e para, të gjitha problemet ose shtesat që sjell opozita janë të rregulluara qartë në nenin 2 dhe e dyta, shtesa që propozon opozita është një detajim i 1 ose 2 parimeve, ndërkohë që parimet janë të thëna qartë në nenin 4 të projektligjit dhe janë më shumë se sa thuhet në mendimin që ka sjellë opozita. Prandaj, unë jam që të mbetet neni 2 ashtu siç është.

Fatmir Xhafaj – Nuk ka koment tjetër. Kush është dakord?

Nëse nuk ka gjë, ata e kanë thënë, e tha ai.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo.

Problemi...

Dakord.

Po ka 25 vjet që mund të mos biem dakord kur ka një amendim për gjykimin ligjit, apo jo? Pse? Sepse nuk është se këtu, edhe po të shtohen ato që ka thënë zoti Bardhi, unë nuk jam kundër, por është një ngarkesë e panevojshme nga pikëpamja e teknikës legjislative.

Fatmir Mediu - Që të mos jemi dakord të dyja palët, mund të jetë normale, edhe pse nga pikëpamja e ndërtimit mund të mos kemi asnjë vërejtje. Por nëse ka ndonjë që vlen, që mund t'i vlejë asaj që është shtuar...

Fatmir Xhafaj – A mund të them diçka më ndryshe, zoti Mediu? Sa herë që ata e çmojnë vetë zonën që do të ndërhyhet ... A je dakord?

Fatmir Mediu – Edhe ajo është.

Unë thashë për të qenë unë i qartë me veten time.

Fatmir Xhafaj – Sa herë që ata e çmojnë. Zoti Deville, zoti Smibert, do t'ju lutesha që sa herë ju e çmoni të nevojshme që duhet të ndërhyni, ju lutem ngrini dorën, për amendamentet që ju e ndjeni të nevojshme që të shpreheni. Kur nuk e çmoni, është e mjaftueshme heshtja.

Rainer Deville - *(përkthen përkthyesja)* Edhe nëse heshtim, kjo nuk do të thotë që ne biem dakord.

Ka edhe një vërejtje të vogël shumë teknike. Kur shkruajmë një nen, ne i ndajmë paragrafët me numra, me pika dhe shkronjat i përdorim kur duam të kalojmë në detaje më të hollësishme brenda një paragrafi të caktuar. Ndoshta ky është një gabim i vogël teknik.

Për sa i takon përmbajtjes, garancitë janë të përfshira në nenin 4, paragrafi 5, kështu që është e tepërt t'i përmendim.

Unë mendoj se termat e përgjithshme janë të mjaftueshme dhe ato detajet e holla ndoshta nuk janë të nevojshme.

Fatmir Xhafaj – Atëherë, me sa shoh, propozimi është të mbetet kështu siç është.

Kush është dakord me amendamentin e propozuar nga kolegët e opozitës? Po 5.

Kush është të mbetet kështu siç është? Dakord.

Mbetet siç është.

Faleminderit!

Vazhdojmë me nenin 3.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, për nenin 3, që është një nen i rëndësishëm, në përkufizimet, gjithashtu, opozita ka amendament. Vazhdojmë me të njëjtën procedurë.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Bardhi.

Gazmend Bardhi – Te neni 3 do të ndalem vetëm te çështjet ku kemi bërë ndryshime thelbësore.

Te pika 2 kemi riformuluar nocionin e dokumentit ligjor, për arsye se në projektligjin e depozituar në Kuvend, nocioni referohet dhe mund të aplikohet vetëm për çështje që kanë të bëjnë me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësuar, ndërkohë që një dokument ligjor mund të jetë i përdorshëm dhe do të jetë i përdorshëm edhe në procesin e vlerësimit të pasurisë dhe aty do të marrim dokumentet ligjore, dhe në vlerësimin figurës apo kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësuar. Aty do të merren dokumente “ligjore. Prandaj është dhënë një përkufizim i përgjithshëm, i cili i përfshin të tri kategoritë e vlerësimeve, ndërkohë që nocioni i dhënë në projektligj, përfshin vetëm kategorinë e vlerësimit profesional.

Në pikën 3 kemi bërë një shtesë, por edhe një ndryshim në koncept të funksionit që, gjithashtu, është i rëndësishëm. Përveç funksioneve politike të Kryetarit të Kuvendit, deputetit, Kryeministrit, zëvendëskryeministrit, ministrit dhe zëvendësministrit, kemi shtuar edhe funksionarët politikë: kryetarin e bashkisë ose të qarkut, që janë funksionarë politikë, janë të zgjedhur, këshilltarët bashkiakë apo anëtarët e këshillit të qarkut, që gjithashtu janë funksionarë politikë, si edhe funksionarët politikë të emëruar nga Kuvendi apo Këshilli i Ministrave.

Ndërsa për sa i përket nëpunësve të kabineteve ne kemi vlerësuar që duhet të ketë një periudhë kohore të ushtrimit të detyrës nga këta zyrtarë me qëllim që ata të vlerësohen funksionarë politikë. Për shembull, nëse një pedagog i së drejtës i kërkohet nga ministri i Drejtësisë për shkak se ai ka në proces të realizojë reformën në sistemin penitenciar, pra ministri i kërkon të atashohet në kabinetin e tij për një periudhë 6-mujore, kjo nuk duhet ta bëjë automatikisht këtë pedagog të së drejtës funksionar politik apo njeri politik për ta penalizuar atë në 10-vjeçarin e ardhshëm për të mos ushtruar një nga funksionet e parashikuara nga ligji. Ndërkohë, nëse ky funksionar politik, le të themi një këshilltar, e kryen këtë detyrë për më shumë se 4 vjet, do të thotë që ka një lloj lidhjeje politike me një forcë të caktuar politike që qeveris. Kjo ka qenë arsyeja pse ne e kemi ngushtuar në afat kohor ushtrimin e detyrës për efekt të penalizimit, apo le të themi pengimit të kandidimit të këtyre funksionarëve.

Për sa i përket kontaktit të papërshtatshëm, mënyra si është riformuluar në projektligj, u referohet vetëm takimeve apo komunikimeve elektronike, ndërkohë që subjekti i rivlerësuar mund të ketë edhe një kontakt me një person të përfshirë në krim të organizuar, për shembull

nëpërmjet letërkëmbimit. Mund të ketë shkëmbyer letra me të, ndërkohë që koncepti që është dhënë nuk e konsideron këtë si kontakt të papërshtatshëm. Prandaj kemi bërë një formulim më të përgjithshëm, që përfshin çfarëdolloj mënyre kontakti.

Për sa i përket konceptit të pasurisë, kemi shtuar edhe çështjet që lidhen me interesa private të subjektit të rivlerësimit në kuptim të nenit 4 të ligjit për deklarimin e pasurive. Gjithashtu, kemi shtuar konceptin e pasurisë së ligjshme, duke konsideruar jo vetëm që e ardhura të jetë e ligjshme, pra nga një burim i ligjshëm, por gjithashtu të bazohet në një veprimtari që lejohet nga ligji. Çfarë kemi pasur parasysh këtu? Sot gjyqtarët dhe prokurorët e kanë të ndaluar tej një norme të caktuar orësh të japin mësim. Për këtë duhet të marrin leje nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë ose nga prokurori i Përgjithshëm. Ne mund të na ndodhë situata në praktikë gjatë zbatimit të ligjit që një gjyqtar pa marrë leje te Këshilli i Lartë i Drejtësisë, të ketë dhënë mësim, mbase edhe nuk ka dhënë mësim, por thjesht të sigurojë vërtetim për marrje pagesash nga fakultetet dhe kështu mund të justifikojë një pasuri të vënë në mënyrë të paligjshme. Prandaj kemi bërë një formulim se çfarë konsiderohet pasuri e ligjshme, që do të jetë jo vetëm e ardhur e krijuar nga një burim i ligjshëm, por edhe nga një veprimtari e lejuar nga ligji dhe e ushtruar sipas rregullave të përcaktuara nga ligji.

Për sa i përket konceptit të personit të lidhur, kemi bërë një thjeshtim, sepse përdoret dy herë brenda një fjalie “funksionesh”. Te personat e tjerë të lidhur kemi shtuar dhe zgjeruar rrethin me konceptin e personit të besuar në kuptim të ligjit për deklarimin dhe kontrollin e pasurive duke përfshirë edhe vëllezërit, motrat, bashkëshortët e kështu me radhë.

Te koncepti i personit të përfshirë në krimin e organizuar, jemi bazuar te ligji “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” për një arsye shumë të thjeshtë, sepse neni 75 germa “a” i Kodit të Procedurës Penale përfshin edhe krimet brenda familjes. Ato janë krime shumë të rënda, por nuk mund të konsiderohen krim i organizuar, sepse në këtë mënyrë ne do të humbitnim, le të themi, kuptimin klasik të nocionit “krim i organizuar”, sikurse janë edhe veprat penale në fushën e korrupsionit që gjithashtu nuk përfshihen brenda konceptit të njohur të krimit të organizuar, ndërkohë që koncepti i krimit të organizuar. Veprat që lidhen me krimin e organizuar referohen në paragrafin 1 të nenit 3 të ligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”. Ne mendojmë se është një metodë më e mirë për t’u referuar atje, sikundër një person mund të ketë vërtet një vendim pafajësie për përfshirje të tij në krim të organizuar, por procedimi penal ndaj tij mund të

jetë pushuar për shkak se nuk ka pasur mjaftueshëm prova. Në koncept të ligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar” ky person do të konsiderohet si i lidhur me krimin e organizuar. Pra, kemi bërë një formulim më të gjerë se ai që kanë ofruar ekspertët që kanë propozuar ligjin në komision.

Te koncepti i të ardhurave të ligjshme kemi futur edhe nocionin që parashikon ligji. Pra, ajo duhet të jetë jo vetëm një e ardhur e ligjshme nga një burim i ligjshëm, por edhe e ardhur për të cilat subjekti i rivlerësuar ka paguar tatimet. Ky është një koncept që e përdor Kushtetuta. Ne nuk mund të referohemi vetëm te burimi i ligjshëm i të ardhurave, për shembull, një avokat që mund të jetë bërë gjyqtar e ka burimin e ligjshëm, sepse ka bërë punë si avokat, por nuk ka paguar tatimet dhe për efekt të llogaritjes së këtij ligji, ato nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme. Ky është nocion që e jep Kushtetuta nuk e themi ne.

Këto ishin komentet që ne kemi për nenin 3.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Këtu kemi edhe disa komente që ka bërë vetë EURALIUS-i. Unë e dëgjova me vëmendje zotin Bardhi. Ka disa gjëra që mund t’u lëmë hapësirë ekspertëve që t’i shohin, meqenëse janë edhe ndryshimet e bëra nga EURALIUS-i, janë reflektuar një pjesë, ka disa saktësime që neve na u dukën interesante, edhe në ato që tha zoti Bardhi. A mund ta votojmë në parim pro dhe pastaj ata të kenë mundësi të reflektojnë për gjëra që do të çmojnë se duhet të reflektojnë, për gjëra që janë të reflektuara nuk kemi pse të shqetësohemi më pas, apo jo?

Dakord. Miratohet me këtë rezervë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në parim, quhet e mirëqenë, që disa elemente që do të shihen aty të saktësohen.

Te neni 3 është zgjeruar rrethi i subjekteve me propozimin që ka ardhur nga ju, i kontrollit. Unë personalisht bie dakord.

Neni 4. Zoti Bardhi, EURALIUS-i, mbi bazën e komenteve të Partisë Demokratike, ka bërë një ndërhyrje te neni 4.

A keni ndonjë koment shtesë te neni 4?

Gazmend Bardhi – Për nenin 4 ne kemi disa propozime shtesë në projektligj.

Ne mendojmë se do të ishte e vlefshme që të përfshihej një dispozitë që i referohet, domethënë, përpara nenit 4 kemi dy apo tre nene që i shtojmë, që dua t’i prezantoj dhe të them edhe arsyen pse janë shtuar.

Po do të shpjegoj arsyen pse janë futur. Së pari, sepse përcaktimi i subjekteve të rivlerësimit na lidh edhe me fushën e zbatimit të ligjit. Ne mendojmë se Kushtetuta qartësisht ka ndarë dy kategori subjektsh rivlerësimi: subjekte që e kanë të detyrueshme rivlerësimin për shkak të detyrës dhe subjekte që e bëjnë rivlerësimin me kërkesë vullnetare. Ne mendojmë se duhet të ishte e përshtatshme që subjektet që i nënshtrohen procesit të detyrueshëm të rivlerësimit të fillojnë menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ndërkohë që për subjektet e tjera ne duhet të vëmë detyrimin që ata të paraqesin kërkesë vetëm pas një periudhe dyvjeçare, pasi ne kemi parë nëse ka apo jo vende vakante dhe, nëse rivlerësimi i tyre do t'i shërbente plotësimin që duhet bërë për shkak të vakancave që do të krijohen nga shkarkimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga detyra. Pse duhet marrë kjo masë? Sepse ne mund ndodhemi në praktikë që komisioneve të rivlerësimit t'i vijnë 100 kërkesa nga ish- gjyqtarë apo ish- prokurorë, ish- këshilltarë, apo ish- këshilltarë të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë. Kjo do të ngarkonte dhe mbingarkonte ushtrimin e detyrës, është një proces kompleks, ata kanë vetëm 5 vjet në dispozicion, ndërkohë që kanë një gamë prej 1000 zyrtarësh që duhet të vlerësojnë, dhe shtesa me subjektet e tjera, ndërkohë që mund të mos ketë vende vakante dhe ne këto subjekte mund të mos na duhet fare t'i rivlerësojmë. Kjo për mendimin tim do të ngarkonte në mënyrë të panevojshme punën e komisionerëve dhe të kolegjeve të apelimit. Kjo duhet të jetë një çështje që duhet të vlerësohet prej tyre pas dy vjetëve që hyn në fuqi ligji dhe procesit të rivlerësimit nga subjektet vullnetare t'i nënshtrohen rivlerësimit aq sa do të jetë e nevojshme për plotësimin e vendeve vakante. Kështu nuk do të bënin punë kot, as komisioni i pavarur i kualifikimit, as më pas kolegji i apelimit. Kjo është një masë mbrojtëse për të garantuar efincencën e organeve të rivlerësimit. Na intereson që puna e tyre të jetë e përqendruar te procesi i skanimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve që janë aktualisht në detyrë. Pra, për të larguar ata që janë të papërshtatshëm. Nëse do të duhet që për shkak të vakancave, sepse ka edhe një numër nga subjektet e detyrueshme që mund të futen në gjyqësor që janë këshilltarët e Gjykatës Kushtetuese aktualisht në detyrë, ndihmësit ligjorë, inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe këta do të plotësojnë vakancat, ne mund të ndodhemi në situatën që pas 3-4 vjetëve nuk ka më vakanca dhe nuk kemi pse vlerësojmë njerëz që nuk do të bëhen pjesë e sistemit.

Kjo ka qenë arsyeja pse e kemi ndarë në dy kategori këtë subjekt rivlerësimi për të ndihmuar dhe garantuar efincencën e organeve të rivlerësimit

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Në këtë nen që shtojnë kolegët e opozitës, unë shikoj që kanë vendosur rregulla ekstra që nuk i ka Kushtetuta dhe konkretisht te diferencimi ose dallimi që bëjnë lidhur me rivlerësimin e njerëzve që janë në sistem, apo të ish- gjyqtarëve, ish- prokurorëve apo ish – këshilltarëve ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë.

Paragrafët 3 dhe 4 të nenit 179/b të Kushtetutës nuk parashikojnë dallime dhe diferencime në kohën e aplikimit. Pra, u jep mundësinë të dy palëve. Ne me ligj nuk mund të përcaktojmë rregulla ekstra kur Kushtetuta nuk na ka thënë si përjashtim që në ligj mund të përcaktohen kritere të detajuara në këtë pikë.

Lidhur me riformulimet e tjera që bëjnë kolegët, këtu janë detajuar një sërë kategorish të cilat ndalohen të konkurrojnë. Këto ndalesa në ligj janë aktualisht. Ne kemi vënë disa kritere që nuk mund të kandidojnë, t'i nënshtrohen rivlerësimit, ish- gjyqtarë dhe ish- prokurorë që kanë pasur lidhje me Sigurimin e Shtetit, kanë qenë bashkëpunëtorë, sepse ne kemi një ligj të miratuar për pastërtinë e figurave dhe secili është i detyruar ta plotësojë atë deklaratë. Këto dy ligje janë tashmë.

Zoti Oerd, në pikën 5 ju keni vënë një sërë kriteresh, te germa “ç” keni detajuar gjëra që tashmë i kemi në ligj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Te ligji për pastërtinë e figurave dhe për hapjen e dokumenteve të bashkëpunëtorëve të Sigurimit të Shtetit.

E kemi ndalim.

Oerd Bylykbashi – Ky nen është shumë i rëndësishëm. Nëse ne nuk bëjmë kujdes, mund të gjendemi para asaj që në mënyrë edhe të qëllimshme sistemi të na mbushet me individë, të cilët sot janë jashtë sistemit, mund edhe ta sjellin problemin në sistem, pavarësisht vetingut dhe mund edhe ta politizojnë procesin. Nëse sistemi vetë ka brumë, që do të thotë, nëse ka njerëz të mjaftueshëm, sistemi do të ripërtërijë veten. Nëse një këshilltar i Gjykatës Kushtetuese është i detyruar të futet në procesin e vetingut dhe ka një vend bosh, është ky që duhet ta marrë dhe jo dikush jashtë sistemit. Personat e detyruar të hyjnë në procesin e vetingut, duhet të jenë ata të parët që mbushin sistemin dhe, nëse ezaurohet ky korpus, atëherë marrim edhe nga jashtë. Përndryshe personat që punojnë sot dhe dalin të pastër, mbeten aty ku janë dhe marrim nga jashtë persona të tretë. Ky është qëllimi i kësaj dispozite. Propozimi ynë është që të mbrojmë sistemin, ta pastrojmë nga pjesa e keqe, por të mbajmë pjesën që funksionon dhe ta

vetërregullojë sistemi nga rradhët e tij, jo ta mbushim me të huaj të jashtëm, të cilët mund të na sjellin edhe politikën brenda.

Fatmir Xhafaj – A ka komente të tjera?

Zoti Devill.

Rainer Deville – *(përkthen përkthyesja)* Së pari, ndarja e këtyre dy lloj grupeve përfaqësuesish është e përcaktuar edhe në Kushtetutë, kështu që nuk është e nevojshme ta përfshijmë edhe këtu.

Këtu kemi një mendim të delegacionit evropian në lidhje me vendosjen e afateve kohore. Ky është një opinion i shprehur nga delegacioni evropian dhe më duket se ju nuk po e merrni parasysh. Është vërtetë një shqetësim ose një pikë e rëndësishme për delegacionin vendosja e afatit.

Për sa i takon ndarjes së dy grupeve, vendosjes së atyre afateve në vend që ta ndihmojmë, ne më duket se e pengojmë këtë proces duke vendosur afate. Ne mund t'i plotësojmë këto vende edhe para këtyre afateve që janë vendosur, prandaj që të mos pengoni procesin unë do të isha i mendimit që këto amendamente ose ky ndryshim të mos përfshihet në këtë nen.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Unë nuk jam i sigurt nëse eksperti i huaj e kuptoi qëllimin e kësaj dispozite, sepse me siguri e ka nga përkthimi i momentit. Qëllimi i kësaj nuk ka lidhje fare me kalendarin. Ajo është një çështje tjetër shumë e rëndësishme, për të cilën ne kemi qëndrim të qartë, por nuk ka lidhje me këtë. Qëllimi është që të përcaktojmë një afat kohor, kur ata që kanë të drejtë në mënyrë vullnetare të futen në procesin e vetingut, t'i afrohen sistemit, sepse sistemi ka nevojë për numra, por, nëse sistemi ka persona që janë gjyqtarë prokurorë apo pozicione të tjera që parashikon ligji, të cilët e kalojnë filtrin e vetingut me sukses dhe plotësojnë vakancat, sistemi i plotëson vakancat nga brenda vetes së vet, pa sjellë nga jashtë. Në momentin kur kjo është e pamundur këto burime nga jashtë sistemit, vijnë e bëjnë procesin e vetingut, kalojnë filtrin dhe plotësojnë vendet. Qëllimi është vetëm për të ruajtur sistemin nga flukset e jashtme dhe afatet janë maksimale. Nëse ndodhin më shpejt, aq më mirë!

Kështu që kam mendimin se nuk u kuptua dispozita.

Fatmir Xhafaj- Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Shqetësimi që ka opozita është i zgjidhur në projektligjin “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorëve”. Kriteret që ju keni vendosur në pikën 5 të këtij neni, që personat që

duhet të bëjnë rivlerësim vullnetar nuk duhet të kenë qenë kandidatë të Byrosë Politike i keni tek ai ligj. “Nuk duhet të kenë qenë bashkëpunëtorë të Sigurimit”, i keni në atë ligj, por ju nuk keni qenë në diskutimin e atij ligji dhe vini e i shtoni. I keni të thëna qartë. Plus që të mos harrojmë kemi miratuar një ligj për pastërtinë e figurave dhe për të mos qenë bashkëpunëtorë të Sigurimit.

Fatmir Xhafaj – Kush është dakord me amendamentin propozuar? Dakord përfaqësuesit e opozitës. Kush është kundër?

Nuk miratohet.

Vazhdojmë.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, te ky nen regjistrojmë voton kundër, te neni që mbetet, i propozuar nga ju...

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me nenin 4. “Objekti dhe parimet e procesit të rivlerësimit”. Siç e parashtrova, ka një ndërhyrje të ekspertëve që merr në konsideratë një opinion të opozitës. Kush është dakord? Kundër? Opozita është kundër.

Oerd Bylykbashi – Që të mos abuzojmë me këtë, nuk mundet që dikush të reflektojë qëndrimin e opozitës pa u konsultuar me ekspertët e opozitës, e për rrjedhojë, ky nen është shumë i rëndësishëm. Ne e votojmë kundër. Ku do të kemi kundërshti ne do të votojmë kundër, ndërkohë ne nuk marrim pjesë...

Fatmir Mediu – Një sugjerim, meqenëse ne proceduam me një nen paraprak, domethënë, në dakordësinë në parim dhe në vlerësimin reciprok të ekspertëve, pse të mos e shikojmë në të njëjtën frymë?

Fatmir Xhafaj- Në mënyrë shumë të sinqertë që ia thashë edhe zotit Bylykbashi jashtë mikrofonit, po them se mund të ketë gjëra të kësaj natyre, pro mund të rezultojë që nesër ato të thonë: jo nuk ishim dakord me këtë gjë, ndërsa ju mund të thoni: po ne e kemi votuar këtë gjë.

Fatmir Mediu – Po ajo mbetet pastaj në seancë.

Fatmir Xhafaj – Nëse ju e keni këtë vullnet dashamirës, nuk kam...

Fatmir Mediu – Të gjitha janë bërë me vullnet dashamirës.

Fatmir Xhafaj- Nuk kam unë të drejtë t’ju paragjykoj ju, as ju mua.

Vazhdojmë me nenin 5. “Institucionet e rivlerësimit”

Ka një ndërhyrje shpjeguese të misionit.

Kush është dakord?

Oerd Bylykbashi – Përpara nenit 5 ka një amendament tjetër që shton...

Gazmend Bardhi – Unë po kaloj te çështjet që i vlerësoj, meqenëse ju i kaluat këto dispozita, ne kemi bërë edhe një ndarje për objektin e rivlerësimit duke dhënë konceptin për secilin nga vlerësimet, sepse...

Fatmir Xhafaj –Këto definicione jepen gjatë projektligjit. Ju i keni bashkuar bashkë.

Gazmend Bardhi – Ne mendojmë se duhet të jenë pjesë duke qenë se trajton pjesën e përditshme fushën e projektligjit.

Fatmir Xhafaj - Këndvështrim është, rëndësi ka që janë.

Gazmend Bardhi – E njëjta gjë është edhe për periudhën, prandaj thashë po i kaloj.

Kemi shtuar ndërkohë një nen 7, i cili sqaron të gjitha parimet e përgjithshme të procesit të rivlerësimit, ku krahas parimeve që përmenden nga Kushtetuta, një parim shumë i rëndësishëm është ai i realizimit të procesit të rivlerësimit sipas një radhe prioritare dhe rëndësisë së funksionit të çdo subjekti rivlerësimi. Pse mendojmë ne se kjo e ndihmon procesin dhe arrin që të japë pasojat që duhet të sjellë ky ligj më shpejt te qytetarët? Mund të ndodhë që komisioni i pavarur i kualifikimit ta përqendrojë punën e vet te gjyqtarët apo prokurorët e shkallës së parë, ndërkohë që gjyqtarët e Apelit apo Gjykatës së Lartë vazhdojnë të jenë po të njëjtët. Qytetarët do të shkojnë dhe do të marrin drejtësi brenda dy vjetësh për shkak të pastrimit që është bërë Gjykatës së Shkallës së Parë, pra do të marrin drejtësi në Gjykatën e Shkallës së Parë, por ndërkohë kjo drejtësi do të zhbëhet në vitin e tretë apo të katër të funksionimit për shkak se ne akoma nuk kemi pastruar Gjykatën e Apelit apo Gjykatën e Lartë. Pra, një synim i ligjit që të shkojë sa më shpejt në interesin e qytetarit, i cili është marrja e drejtësisë arrihet duke filluar pastrimin sistemit nga Gjykata e Lartë për të kaluar te Gjykata e Apelit, dhe për të shkuar në fund te gjyqtarët e Shkallës së Parë. Sado padrejtësi të bëjnë gjyqtarët e Shkallës së Parë, nëse ne kemi siguruar pastërtinë Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë, qytetari do të marrë drejtësinë në këto shkallë dhe çështja konkrete që ai ka, do të marrë drejtësi në afate më të shpejta dhe ligji do ta sjellë pasojën në afate më të shpejta.

Fatmir Xhafaj – Po ata që shkojnë në Këshillin e Lartë Gjyqësor apo shkojnë inspektorë?

Gazmend Bardhi – Po, edhe ata janë.

Fatmir Xhafaj- Vetvetiu edhe aneksi i Kushtetutës, kështu e ka parashikuar, fillon nga organet më të larta dhe...

Gazmend Bardhi – E ka parashikuar, sepse propozimi që bën EURALIUS-i do të mos ketë radhë prioritare dhe kalendar të shqyrtimit të funksionarëve. Pa diskutim që pjesë prioritare, të cilët në vlerësimin tonë duhet të mbarojnë procesin e vlerësimit brenda vitit të parë të funksionimit të këtij ligji, duhet të jenë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, anëtarët e Gjykatës së Lartë, prokurori i Përgjithshëm, anëtarët e zgjedhur të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Prokurorisë dhe inspektori i Lartë i Drejtësisë. Ky është një parim që për ne është shumë i rëndësishëm, sepse kështu do të arrijmë të sjellim pasojat më shpejt te qytetarët.

Kemi shtuar edhe një nen 8, që është shumë i rëndësishëm “Urdhërimi i Kushtetutës”, që ka të bëjë me kufizimin të drejtave. Në nenin “A” të aneksit të Kushtetutës parashikohet se disa të drejta duhet të kufizohen sipas nenit 17 të Kushtetutës. Neni 17 i Kushtetutës flet për kufizime të bëra me ligj, që do të thotë të gjitha të drejtat e përmendura në paragrafin parë të nenit “A” do të duhet të jepen parime dhe masa e kufizimit të tyre në këtë ligj, në të kundërt ne bëjmë të pazbatueshme dispozitën kushtetuese.

Këto ishin komentet përpara se të shkojmë te neni 5.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Kush është dakord me propozimet e bëra? Kundër?

Devill.

Rainer Deville - *(përkthen përkthyesja)* Përsëri kjo shkel vijën e kuqe të komisionit.

Ne kemi përcaktuar edhe në Kushtetutë ndryshimet kushtetuese që vërtetë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese do të jenë të parët ata që do të kalojnë në procesin e rivlerësimit, por kjo nuk na pengon ne që në të njëjtën kohë të fillojmë edhe vlerësimin e gjyqtarëve të instancave të tjera më të ulta dhe ndofta i gjithë ky proces vlerësimi mund të mbarojë në një kohë më të shpejtë.

Kurse ky është një lloj tjetër vlerësimi, i cili nuk gjen reflektim në amendamentet kushtetuese.

Me siguri një opinion i përgjithshëm që sigurisht që Kushtetuta është e aplikueshme. Ne nuk mund të themi se nëse nuk e bëjmë rivlerësimin kështu, atëherë disa dispozita të Kushtetutës do të jenë të pa aplikueshme.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, unë nuk jam në gjendje të them sa eksperti i huaj ishte pa një numër nenes, që janë 6 nene të pa përkthyer vetëm nga prezantimi, po themi, i qëllimit të amendamentit nga eksperti, zoti Bardhi, kështu që edhe ndërhyrja m’u duk se nuk kishte

korrespondencë me atë që thamë. Unë nuk e kuptova se cila është vija e kuqe dhe mirë është të thuhet qartë se çfarë janë vijat e kuqe në këtë histori, por kjo nuk ka rëndësi. Besoj se të gjithë këtu dinë ta lexojmë Kushtetutën dhe ta zbatojmë, për më tepër kur Kushtetuta ka nevojë për ligje për ta implementuar më tej. Besoj se e kuptoj shumë mirë si lexohet Kushtetuta.

Zoti Majko, nuk e di a dini ju, apo jo? Ju thoni që e bëni, unë me të lexuar e kam. Tani, një gjë shumë e thjeshtë, ndërhyrjet për po ose jo, sugjeroj të bëhen pasi të jetë kuptuar në detaj propozimi ynë, përndryshe le të merret kohë më pas, por jo të thuhet këtu gjëra që nuk janë thënë. E para.

E dyta, nuk mundet t'u kërkohet katër komisioneve me 12 anëtarë që të marrin në shqyrtim të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në të njëjtën kohë, sepse krijohet një grykë shisheje, që e dështon procesin, do ta mbajë pezull procesin e vetingut, do t'i mbajë nën presion gjyqtarët, ndërkohë që ushtrojnë detyrën e tyre dhe do të bjerë ndesh edhe me rregullat bazë të një procedimi administrativ, përfshirë hetimin administrativ, për të cilin Kodi i Procedurës Administrative përcakton afate se kur kryhet. Edhe për procedimin administrativ më të ashpër ka afate. Kjo nuk mund të fillojë në vitin 2016 dhe të mbarojë pas 5 vjetësh. Gjyqtari duhet të ketë parashikueshmëri kur hyn dhe kur do të dalë nga ky proces. Nëse ka nevojë t'i zgjaten afatet, bëhet në mënyrë procedurale, por nuk mbahet në varësi të dëshirës së organeve të vetingut. Parashikueshmëria është element thelbësor i shtetit të së drejtës.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Askush nuk e imponoi ekspertin ndërkombëtar që të shprehet. Ai kërkoi të drejtën e fjalës.

Oerd Bylykbashi – Ndërhyrja duhet bërë nëse kuptohet qartë ajo që po diskutojmë, po nuk u kuptua qartë, le të bëhet ndonjë koment prapa.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Fatmir Mediu - Unë mendoj se amendamentet kanë një qëllim të qartë për të përmirësuar dhe për të vendosur rregullat procedurale siç duhet. Ne në parim jemi të dy palët dakord. Shqetësimi që kemi ngritur, meqenëse është shprehur në amendamente besoj se ka edhe humbje në përkthim, sepse e ka të pamundur zotëria, edhe eksperti më i mirë i anglishtes në botë të jetë, edhe ta përkthesh edhe ta kuptosh edhe të reflektosh, e ka te veshtirë, kështu që do të doja të paktën t'i jepet mundësia për t'i rikonsideruar shqetësimet, duke marrë shkas nga ajo që tha zoti Bardhi.

Fatmir Xhafaj – Edhe unë mendoj që mendimet t'i japin në fund.

Vasilika Hysi – Unë do të doja që kolegët e opozitës në këto amendime të mos sjellin terminologji që nuk është në Kushtetutë.

Që në nenin 4 që bëhet neni 5 e në vazhdim në të gjitha amendimet kemi terma që nuk janë në Kushtetutë, cedojnë nga riformulimi. Po ju jap një shembull, në nenin “Ç” të aneksit të Kushtetutës, kur flitet për rivlerësim, në paragrafin e parë thuhet: “Rivlerësimi përfshin kontrollin e pastërtisë të figurës dhe aftësive profesionale sipas neneve “D”, “DH”, “E”, për shembull, kolegët e riformulimeve, thonë: “Procesi i rivlerësimit përfshin kontrollin e të tri kritereve”. Pra shtojnë fjalën administrativ dhe thonë: “ligjshmërinë e pasurisë”. Nuk thotë Kushtetuta “ligjshmërinë e pasurisë”, thotë : “vlerësimin e pasurisë”. Pastërtinë etike dhe morale të figurës. Nuk thotë Kushtetuta, “pastërti të etikës morale të figurës”, por thotë “kontrollin e figurës”. Të vetmen gjë që ka respektuar është neni 10 ku thuhet: “Vlerësimi i aftësive profesionale”. Kushtetuta ka përmendur një terminologji, e cila duhet respektuar. Ne duhet të shtojmë në ligj kritere shtesë, nëse Kushtetuta thotë që kriteret e detajuara parashikohen në ligj. por në rast se Kushtetuta nuk na ka dhënë tagrin që ne të shtojmë në ligj kritere të tjera nuk mund t’i shtojmë.

E dyta në këto nene që ju ndryshoni apo shtoni, sepse keni shtuar 6 nene të tjera pas nenit 5, ju merrni parime rregulla që janë të shpërndara në ligj te krerët përkatës, dhe i fusni përsëri këtu.

Zoti Bardhi, kam shumë respekt për ju, por me këtë lloj mish- mashi, që u keni bërë neneve të ligjit, që merrni paragrafë të projektligjit dhe i sillni në nenin 5, ky nuk është amendim. Më vjen keq nuk doja ta thosha, ju respektoj shumë për profesionalizimin, por nuk mund të bëhet kjo përzjerje nenesh.

Oerd Bylykbashi - Zonja Hysi, këtu këto amendamente janë prezantuar prej meje. Mirë? Dhe unë ju ftoj që të përmbaheni në terminologjinë që përdorni, sepse t’ju them unë se ç’hall i zi është cilësia e këtij drafti dhe çfarë do të pasojë nga ky draft, që do të miratoni ju sot, ju do ta mbani këtë të gjithën, nuk ka problem për ne, por bëni kujdes, sepse hartimi i dispozitave, që ne synojmë të fusim, dhe ju po i rrëzoni, ka vetëm një qëllim: të saktësojë gjërat që ju keni lënë bosh, të saktësojë gjërat që i keni bërë keq dhe të shtojë të gjithë ato elemente që i mungojnë këtij procesi. Pastaj nëse ju nuk ndiqni dot rrjedhën e amendamenteve, kjo nuk do të thotë mish- mash. Kështu që bëni kujdes, të respektojme njeri- tjetrin Ose jeni dakord, ose nuk jeni dakord. Ligjshmëria e pasurisë vlerësohet, zonja Hysi, nuk merret eksperti topograf për të

thënë sa metra katrorë është shtëpia. Kaq nuk i intereson askujt. E ke të ligjshme, apo nuk e ke të ligjshme pasurinë që ke. Kështu që le të mos ngatërrohem. O jeni dakord, ose nuk jeni dakord. Kaq e thjeshtë është.

Fatmir Xhafaj – Dakord, besoj se edhe zonja Hysi e kishte në kuptimin që jo se nuk janë këto gjëra në projektligj, një pjesë e tyre që janë propozuar, por sepse janë thjesht riformulime ose përshtatje e strukturës në një këndvështrim, që mund të jetë edhe ky arsyeshem, nuk ka ndonjë gjë të keqe, por ne thjesht krerët mund t'i vendosim. Mund të bësh vetë një renditje. Është mënyra sesi e shikon gjënë. Ka dy opsione: njëri që është paraqitur në ligj dhe një opsion që e paraqiti zoti Bardhi këtu.

Kush është dakord me amendamentet e propozuara, që i lexoi zoti Bardhi. Gjashtën, shtatën deri tetën ë?

Kush është dakord me tri amendamentet? Kundër?

Nuk miratohen.

Kush është dakord me nenin 5 të projektligjit në shqyrtim, “Misionet e rivlerësimit”, me ndërhyrjen që kanë bërë ekspertët ndërkombëtarë te pika 2?

Kundër? Kolegët e opozitës.

Miratohet neni 5.

Keni para nenit 6 të projektligjit, apo të vazhdojmë?

Vetëm në mënyrë të përmbledhur, të lutem!

Gazmend Bardhi - Edhe për nenin 5, zoti kryetar, ne mendojmë që ligji duhet të qartësojë cilat janë organet e rivlerësimit dhe cilat janë organet ndihmëse të procesit. Për këtë ne kemi bërë dy formulime.

Fatmir Xhafaj – Ju i quani “organe”, këta e quajnë “Insionet e rivlerësimit”.

Gazmend Bardhi – Organ është emri që përdor Kushtetuta, është çështja juaj nëse do ta lini organ apo institucion. Po t'i referohesh që në nenin 6 thuhet: “Funksionimi dhe organizimi i organeve të parashikuara në Kushtetutë përcaktohet me ligj”, prandaj kemi përdorur termin organ.

Fatmir Xhafaj – Mirë, mund të diskutoni dhe njehsoni.

Gazmend Bardhi - Nuk ka asnjë lloj problemi për ne. Ideja është që neni 9 dhe neni 10 i amendamenteve, që ne kemi paraqitur, bën një ndarje të qartë të detyrave midis organeve të rivlerësimit dhe organeve ndihmëse duke marrë edhe konceptet e neneve 71 dhe 73 të Kodit të

Procedurës Administrative. Ne mendojmë që një qartësim i tillë e sjell ligjin në përputhje me Kushtetutën, sepse detyrën për realizimin e procesit të rivlerësimit e kanë vetëm organet e rivlerësimit. Edhe në vlerësimin, që është bërë nga misioni EURALIUS thuhet në një paragraf, pavarësisht se kjo është paraqitur si një gjë që bie ndesh me qëndrimin e opozitës në opinion, por në fakt është pikërisht ajo që ne kemi kërkuar, që zbatimi i rivlerësimit, hetimi administrativ dhe vendimi përfundimtar të bëhen nga organet e vetingut pa vënë asnjë herë në diskutim që organet e tjera ILDKPI-ja, Policia e Shtetit, SHISSH-i dhe çdo lloj organi tjetër, që është tani ekzistues, të vendosë në dispozicion të organeve të rivlerësimit çdo të dhënë që disponon për secilin prej subjekteve. Po flas për ndarjen midis neneve 9 dhe 10, organet e rivlerësimit dhe organet ndihmëse.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Bardhi!

Zonja Hysi.

Vasilika Hysi- Zoti kryetar,

Kjo lloj ndarjeje nuk është kaq e lehtë. Në fakt, këtu dhunohet Kushtetuta. Konkretisht në aneks, neni D, kur flet për vlerësimin e pasurisë, flet për një institucion, i cili nuk është institucion ndihmës. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, sipas paragrafit të dytë të nenit D të aneksit të Kushtetutës është organ i rëndësishëm, të cilit i është dhënë fuqi kushtetuese, që jo vetëm ndihmon, por bën kontrollin e deklaratës së pasurisë dhe i dorëzon komisionit një raport për ligjshmërinë. Nuk është korrekt fakti që këtë organ e vendosni së bashku me organet e tjera, me policinë, si një organ ndihmës, ndaj duhet t'i qëndrojmë strikt formulimit që është bërë në Kushtetutë, sidomos për ILDKPI-në.

Fatmir Xhafaj – E dëgjuam komentin.

Kush është dakord me dy amendamentet shtesë të kolegëve të opozitës? Janë dakord kolegët e opozitës me propozimin e tyre. Kundër? Nuk miratohen.

Vazhdojmë me nenin 6 të projektligjit, që ka ndryshime me shtesat që i kanë bërë ekspertët, bazuar në opinionin e opozitës.

Kush është dakord me ndryshimet e paraqitura?

Vasilika Hysi – Zoti kryetar,

Në fakt do të doja të diskutoja për një ndryshim që është bërë në projektligj në nenin 6, lidhur me germën “g”, ku është shtuar një paragraf, ku thuhet kriteri i zgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, pra nuk lejohet një person që ka qenë anëtar i grupit të ekspertëve

të nivelit të lartë, parashikuar në vendimin nr.12, datë 2 prill të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë ose ekspertë të caktuar nga partitë politike dhe ministri i Drejtësisë.

Çështja këtu është parimore, kushtetuese, pasi titulli i këtij neni flet për kriteret e zgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë. Në pjesën e parë të këtij neni flitet për kriteret e lejueshmërisë, pra kush mund të jetë anëtar i komisionit dhe gjyqtar i kolegjit, ndërsa në pjesën e dytë flitet se kush nuk mund të jetë.

Unë e kuptoj shumë mirë kriterin që personat nuk mund të jenë bashkëpunëtorë, favorizues të ish-Sigurimit të Shtetit, gjyqtarë, prokurorë, këshilltarë gjatë dy vjetëve të fundit përpara kandidimit, do të doja nga ekspertët e huaj, sidomos nga ekspertët e EURALIUS-it, cila ka qenë arsyeja që është shtuar germa “g”.

Këtu ka dy çështje, është çështje ligjore, por është edhe një çështje tjetër legjitimiteti.

Pyetja e parë: të jesh anëtar i grupit të ekspertëve të nivelit të lartë bie ndesh me ndonjë parim kushtetues, ndonjë ndalim? Unë këtë nuk e gjej në Kushtetutë. Pra nuk gjej në Kushtetutë që të kesh qenë ekspertë, të kesh dhënë një opinion, të kesh kontribuar për të na ndriçuar neve mendjen, në këtë kategori ekspertësh e djegim.

Nga ana tjetër, grupi i ekspertëve të nivelit të lartë është përbërë nga trupa e profesorit ose institucionet kanë sjellë përfaqësuesit e tyre. KLD-ja ka sjellë dy përfaqësues, Gjykata e Lartë ka sjellë dy gjyqtarë, Prokurori i Përgjithshëm ka sjellë përfaqësuesin e vet, universiteti ka sjellë përfaqësuesit e tij. Kur janë thirrur, të paktën në kujtesën time, ne nuk u kemi thënë të gjithë ekspertëve që ju që do të vini dhe do të kontribuoni si ekspertë ose do të përfaqësoni institucionet tuaja, ju nuk duhet të promovoheni. Unë nuk nëse në deklaratën ose kontratën që parlamenti ka bërë me ta u është thënë që e qartë që po të vini në këtë funksion, ju nuk keni të drejtë të promovoheni ose të kandidoni.

Pra, ka dy çështje, një lidhet me kushtetutshmërinë, nëse këtë kriter e kemi të ndaluar në Kushtetutë dhe e dyta në një gjendje fakti.

Nga ana tjetër, unë mendoj që ekspertët e nivelit të lartë nuk janë vendimmarrës. Ata janë ekspertë që kanë ndihmuar, kanë punuar dhe kanë paraqitur një projekt, një ide, por, në fund të fundit, idetë e tyre po i diskutojmë ne, i kemi diskutuar ne në mbledhje dhe jemi ne që jemi vendimmarrësit, ne politikanët që do t'i votojmë. Meraku im është sa teorik, parimor, por edhe praktik. Ajo që ne po bëjmë me këtë kufizim, duke e futur këtu, për aq kohë sa do të ekzistojë ky

ligj do të jetë i përjetshëm, ne nga ana tjetër vrasim atë praktikë të mirë që ka në parlament, por në çdo vend që thërriten ekspertë për të kontribuar, për të përmirësuar praktikën, legjislacionin. Me këtë rregullim, kur ky ligj të miratohet, i bie që nuk do të kemi më ekspertë që të pranojnë të bashkëpunojnë për draftime të projektligjeve, të vijnë në Komisionin e Ligjeve apo në komisione të tjera për të shprehur opinionet e tyre dhe gjithçka do të mbetet në dorë të klasës politike që është ulur në parlament.

Nëse ju keni merak konfliktin e interesit, që, me sa kuptoj, kjo ka qenë, mund të ketë një dispozitë kalimtare, një marrëveshje xhentëlmenësh që këta persona të mos kandidojnë, por nuk mund të vihet si një kriter ndalues apo papajtueshmëri, sepse nuk shoh të ketë shkelur as Kushtetutën, as kontratën në vendimin që mori Kuvendi dhe që i krijon këto probleme.

E fundit, duke përjashtuar një armatë të tërë këshilltarësh ligjorë, që nuk janë politike, por janë ekspertë në fushat e tyre, që kontribuuan dhe dhanë mendimet e tyre, ne përjashtojmë dhe ulim kualitetet e atyre njerëzve të cilët në të ardhmen, nuk them për tani, në momentin e parë, mund të kontribuojnë në organet e drejtësisë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka gjë tjetër?

Oerd Bylykbashi – Unë kam përshtypjen që edhe ekspertët e huaj janë të qartë për këtë gjë. Kjo ka qenë një çështje, një pozicionim politik, e cila ka arritur në një pikë të caktuar një dakordësi politike jo vetëm midis forcash politike, por edhe me përfaqësuesit më të lartë diplomatikë këtu, qoftë me ambasadorin e SHBA-ve, qoftë me ambasadoren e Bashkimit Europian. Kështu që kjo është një çështje që nuk e diskutojmë dot. Gjëja më e thjeshtë për t'u thënë është që nuk mundet që një ekspert t'i shkruajë vetes vendin e punës dhe e tillë që. Sigurisht që gjërat kanë ecur, por për këtë është rënë dakord që të mos ndodhë. Kush e propozoi këtë sistem, nuk merr vend pune në atë sistem. Nuk po përjashtohet një armatë, sepse bëhet fjalë për funksione, ekspertë të nivelit të lartë, pra ata të propozuar nga opozita dhe ministri i Drejtësisë. Sigurisht, që në Kushtetutë janë vendosur disa kritere të tjera edhe më të tmerrshme, të cilat do të na lënë pa burime njerëzore. Kur ua thoshim ne, nuk i morët parasysh, por këta për sa kohë që kanë një marrëveshje politike dhe të transfuzuar tashmë jo vetëm në Kushtetutë, por edhe në këtë ligj, kot e diskutojmë. Ne duhet të ecim më tej, për të thënë edhe për ata të cilët, siç është thënë në mbledhjen e fundit të komisionit për miratimin e draftit kushtetues, që ish-gjyqtarë, prokurorë apo hetues, përveç atyre që kanë qenë në Sigurimin e Shtetit, të cilët kanë

marrë pjesë në gjyqe politike, të jenë pjesë e ndalimit. Ata që nuk kanë pasur lidhje me këtë proces, nuk kanë problem.

Prandaj mendoj që ua marrim kohën kot edhe ekspertëve për këtë çështje, sepse ajo është e mbyllur.

Po qe se do të kishin qenë më të qartë kur hartuan Kushtetutën, draftin e shtatorit, të mos e shkruanin në mënyrë të tillë që t'i krijonin vendin e punës vetes, ndoshta do të ishte bërë një diskutim tjetër. Ky është kapitull i mbyllur.

Fatmir Xhafaj – Kështu si reflektoni ju, kam përshtypjen që e trajtoni si një hakmarrje tuajën politike...

Oerd Bylykbashi – Është marrëveshje politike.

Fatmir Xhafaj – Germa “g” është germa e hakmarrjes suaj politike.

Oerd Bylykbashi – Quajeni si të doni. Konflikt interesi që të shkruash vendin tënd të punës me iks miliona lekë, unë e bëj ligjin, e miraton qeveria ime që më ka vënë aty, do të më çojë të marrë edhe 5-6 milionë lekë...

Fatmir Xhafaj – Nuk i ka vënë qeveria...

Oerd Bylykbashi – Fshihuni pas gishtit ju, sepse të gjithë e dinë këtë histori.

Fatmir Xhafaj – Në qoftë se ju kryetarin e Gjykatës Kushtetuese e konsideroni gishtin e qeverisë, është çështja juaj. Nëse kryetarin e Gjykatës së Lartë e konsideroni gishtin e qeverisë, është çështja juaj.

Oerd Bylykbashi – Nuk ia vlen të harxhojmë asnjë sekondë për këtë çështje. Besoj që edhe ekspertët ndërkombëtarë mund të vërtetojnë të njëjtën gjë.

Vasilika Hysi – Zoti Bylykbashi, ju keni pasur privilegjin të jeni pjesë e negociatave deri në momentin e fundit kur ne prisim të mblidhnim komisionin në këtë sallë. Unë nuk kam qenë pjesë e negociatave politike, por kam përpara dy dokumente: Kushtetutën, të botuar në Fletoren Zyrtare nr.138, dhe një projektligj. Në Kushtetutë, në dispozitat kalimtare, tranzitore, nuk është vënë ndonjë ndalim për mandatin e institucioneve që do të vazhdojnë apo për mandate që do të ndërpriten. Do të ishte e ndershme që ju që negociuat politikisht, edhe në qoftë se ka ardhur nga misionet ndërkombëtare, ta kishit vënë në Kushtetutë dhe të thoshit se ky grup që u thirr, po u kërkoj ndjesë publike që nuk ua thamë që në fillim që po erdhët të kontribuoni këtu nuk keni të drejtë as të promovoheni, as të kandidoni për këto institucione. Kjo do të ishte e ndershme. Por të paktën nuk mund t'i bëni pis. Më falni që po jua them, por, në qoftë se zoti

Bardhi, ka punuar me shpirt për të bërë këto lloj ndryshimesh, që secili nga ju i lexon në gojën e vet, nuk besoj se duhet ta vrasësh që në fillim të karrierës së vet. Po, mund ta lëmë shumë mirë që në këto organet e para ju, zotëri, më falni një mijë herë, zoti Bardhi, apo iksin që e solli kryetari i Gjykatës së Lartë apo atë që e solli Presidenti i Republikës, apo atë që e solli rektori i universitetit apo atë që e solli prokurori i Përgjithshëm të themi: nuk do të kandidoni. Nuk ua kemi thënë në Kushtetutë, do të vendosim një dispozitë kalimtare ne ligj, por jo në bazën e këtij ligji. Nuk ka konflikt interesi zoti Bardhi, përveçse nuk ka bërë pushime dhe është lodhur për të bërë formulime. Ne e vendosim tani dhe ne po diskutojmë. Edhe unë personalisht nuk kam ndonjë konflikt interesi, por e shoh çështjen parimore, kur i kemi ftuar institucionet, ua kemi bërë të qartë që kur të sillni kandidatët, bëjuani të qartë atyre se kush do të japë mendjen e tij për të ndriçuar mendjen e 140 deputetëve nuk duhet të kandidojë? Ndoshta zoti Nuni nuk do të pranonte. Ndoshta Marsida Xhafellari nuk do të pranonte, ndoshta Aurela Anastasi nuk do të pranonte e të tjerë e të tjerë e do të thoshin nuk dua ta përfaqësoj institucionin, sepse unë jam i ri dhe do të bëj karrierë. Po përmend këta emra se këta nuk kanë ndër mend. Por mendoni brezat e rinj.

Oerd Bylykbashi – Zonja Hysi, unë besoj se ky është një diskutim i cili edhe me personalizim emrash është çështje principi, pra konflikti i interesit në këtë histori është i tillë, nuk mund të vihet dispozitë tranzitore për një organ tranzitor, një herë ndodh kjo histori. Ky organ një herë do të bëhet, nuk do të bëhet dy herë. Për këtë po vëmë këtë lloj kufizimi. Nuk i krijon vendin e punës vetes, sepse po të ishte ndjekur ajo që propozuam ne që vetingun ta bënin Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk do të ishte fare ky diskutim sot, por kanë krijuar një organ që ta shohim çfarë do të bëjë në 5 dhe në 10 vjet. Ne këtu nuk mund t'i japim të drejtën që ata që krijojnë vendin e punës të shkojnë vetë atje.

Nuk e kuptoj pse duhet të diskutojmë për një gjë që është rënë dakord më përpara?

(Zonja Hysi flet pa mikrofon)

Është tranzitore. Jam dakord ta vëmë tranzitore. Dispozitë tranzitore për një organ që krijohet një herë të vetme që është tranzitor. Këtë po diskutojmë.

Vasilika Hysi – Më thuaj, cili nga nenet e Kushtetutës lidhur me papajtueshmërinë prek? Po ma the këtë unë tërhiqem.

Oerd Bylykbashi – Po bën një gjë gabim në këtë moment. Amendamenti ynë nuk po diskutohet në këto momente. Kemi hyrë direkt tek teksti, ndërkohë që ke amendament.

Fatmir Xhafaj – Neni 6. Keni amendament për nenin 6?

Gazmend Bardhi – Zoti kryetar, ne mendojmë që duhet të ketë së pari një ndarje midis kushteve të zgjedhshmërisë, që janë parashikuara në Kushtetutë dhe janë vetëm pesë, dhe kritereve ligjore që vendos ky ligj. Mënyra sesi është prezantuar amendamenti, ne bëjmë një barazim midis kushteve të zgjedhshmërisë që i parashikon Kushtetuta, që janë vetëm pesë, dhe kritereve ligjore që ne i detajojmë për të siguruar përbërjen ligjore dhe integritetin e kandidatëve që do të emërohen në organet e rivlerësimit.

Te kriteret që shton ky ligj ne mendojmë që kandidatët e organeve të rivlerësimit duhet të kenë edhe detyrimin që në momentin e kandidimit të bëjnë transparencë të plotë dhe të dokumentuar të të gjitha të ardhurave dhe ligjshmërisë së pasurisë së tyre, si dhe pagimit të të gjitha detyrimeve tatimore, bazuar në dokumentacion zyrtar, sikundër duhet të kenë detyrimin që të plotësojnë deklaratën e kontrollit të figurës, sepse mund të ndodhemi në situatën ku një person i zgjedhur nuk ka detyrimin të deklarojë me kë takohet apo me kë është takuar, siç e kanë gjyqtarët dhe prokurorët në zbatim të këtij ligji, të marrë një vendim për shkarkimin e një gjyqtari për një person me të cilin ai rri gjithë ditën vetë, thjesht dhe vetëm sepse kur është emëruar në funksion nuk ka pasur detyrimin komisioneri i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të deklarojë se me kë shoqërohet, ndërkohë mund të shoqërohet me të njëjtin person...

Fatmir Xhafaj – Amendamenti 9 apo jo?

Gazmend Bardhi – Jam te neni 13, te amendamenti 9.

Pra, ne mendojmë që të paktën edhe për imazh të atyre që do të kryejnë këtë proces, duhet të kalojnë paraprakisht të njëjtin filtër, të paktën në nivel deklarimi, njëlloj me gjyqtarët dhe prokurorët. Unë nuk mendoj që afati 14 ditor që Kushtetuta ka lënë për verifikim të tyre do të ishte mjaftueshëm për t'ua verifikuar në tërësi pasurinë, figurën e me radhë, por, duke qenë se një nga kushtet e mbarimit të mandatit është edhe kur nuk plotëson një nga kriteret e ligjit, këta individë duhet të kenë detyrimin që të bëjnë transparencë të pasurisë së tyre, të bëjnë transparencë të kontakteve të tyre, për të vlerësuar nëse kanë ose jo kontakte të papërshtatshme, si dhe të plotësojnë dhe të dorëzojnë, ky është një detyrim që rrjedh nga ligji i dekriminalizimit, edhe formularin e vetëdeklarimit në zbatim të atij ligji.

Kemi bërë edhe një riformulim për sa u përket funksioneve gjatë periudhës së komunizmit që nuk duhet të kenë pasur, ndërkohë që në germën “f”, për shkak të konceptit të ndryshuar që kemi dhënë për funksionin politik, duke pasur parasysh rolin e këshilltarëve të

funksionarëve politikë, këshilltarin e një ministri e me radhë, kemi vendosur ndalim për atë që thotë edhe Komisioni i Venecias që për një kategori zyrtarësh, që mund të kenë mbajtur një funksion politik, të ndalohet kalimi i menjëhershëm nga funksioni politik, le të themi këshilltari i ministrit, në një nga këto organe, por në qoftë se ai ka qenë këshilltar i ministrit përpara 5, 10 apo 15 vjetësh, kjo nuk mund të shërbejë si ndalim për këta funksionarë që të emërohen në funksione të tilla.

Për të vlerësuar aftësitë profesionale të kandidatëve, ne vlerësojmë se ata duhet të kenë detyrimin të dorëzojnë edhe 5 dokumente ligjore, të përgatitur prej tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë profesionale. Pra, kemi ndjekur të njëjtin standard, siç u kërkohet gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilët ata nesër do të vlerësojnë. Qoftë Presidenti, qoftë Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, qoftë edhe organet e Kuvendit, që do të bëjnë zgjedhjen e këtyre anëtarëve duhet të kenë mundësinë të vlerësojnë një punë konkrete profesionale të secilit prej këtyre anëtarëve.

Këto janë pak a shumë shtesat që ne kemi bërë në raport me kriteret në këtë dispozitë.

Mendojmë që pika 2, siç është në versionin e nenit 6, do të ishte e aplikueshme nëse do të kishim një sistem merite apo vlerësimi me renditje të kandidatëve. Në kushtet kur një sistem i tillë nuk është, nuk mund të themi që përmbushja e kriterëve të mësipërme, pra kriterëve ligjore, vlerësohet nëpërmjet titujve shkencorë, sepse nuk ka një vlerësim me pikë, ose pikëzim të këtyre kandidatëve. Për pasojë pika 2 është e paaplikueshme.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Kush është dakord me nenin 6 me këtë ndërhyrje? Nisemi nga amendamenti, dakord.

Ju parashtruat amendamentin 9, apo jo?

Ka diçka që mund të shihet nga ana juaj tek amendamenti 9?

Zoti Devill.

Rainer Deville – *(përkthen përkthyesja)* Nuk duhet ndryshuar sistemi i parashikuar aktualisht në Kushtetutë, pasi kjo do të përbënte një tejkalim të vijës së kuqe. Në fakt, kjo që është propozuar tani është një sistem i diferencuar nga ai që është parashikuar në Kushtetutë. Duhet të kemi parasysh edhe afatet që janë shumë të rëndësishme, të cilat janë parashikuar në Kushtetutë. Krijimi i institucioneve duhet të bëhet sa më shpejtë dhe duhet që njerëzit e duhur të zgjidhen për pozicionet e duhura, por kjo është pjesë e një vlerësimi politik. Kjo do të mbikëqyret edhe nga IMO, i cili është edhe instrumenti që garanton edhe cilësinë e zgjedhjes.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Mediu.

Fatmir Mediu – Cila është vija e kuqe që nuk duhet ta kalojmë në këtë rast? Duke dëgjuar me vëmendje zotin Bardhi, ai tha që ne nuk do t'i kufizojmë në kohë, por të gjithë aplikantët duhet të kenë një set dokumentacionesh që duhet t'i paraqesin, në mënyrë që IMO dhe ne, klasa politike, të kemi një set materialesh, të dhënash, të firmosura prej tyre, që japin garanci që janë njerëzit e duhur, sepse këta janë ata gjyqtarët e mëdhenj që do të gjykojnë gjyqtarët e vegjël. Ne kur duam të gjykojmë gjyqtarët e vegjël, një garanci minimale edhe si trupë politike, por edhe trupa ndërkombëtare duhet ta ketë. Po shkojmë te kualiteti që e ngre me shqetësim zoti Rainer. Nuk e kuptoj se cila është vija e kuqe që po tejkalohet, për sa kohë po themi: unë dua të jem anëtar i këtij grupi dhe duhet të plotësoj deklaratën e pasurisë, deklaratën e dekriminalizimit apo edhe ndonjë deklaratë tjetër, që është detyrim për çdo zyrtar. Ky mund të jetë një zyrtar që mund të jetë jashtë këtij grupi që kërkohet nga ligji për ta plotësuar. Pra, nuk shikoj ndonjë vijë të kuqe, përveçse ndihmon te vija blu që ka zoti Rainer, është vetëm pozitive, nuk ka asgjë negative, rrit kualitetin dhe përgjegjshmërinë e personave që do të jenë pjesë e këtij grupi.

Fatmir Xhafaj – Zoti Devill, ju lutem, për të sqaruar zotin Mediu.

Rainer Deville – (*Diskutim anglisht.*)

Fatmir Xhafaj – Zoti Mediu, ju lutem, ta mbarojë.

Fatmir Mediu – Ose unë nuk e kuptoj anglishten, ose nuk po shkojmë në përkthimin e duhur.

Fatmir Xhafaj – Ju jeni një anglishtfolës i mirë, kjo dihet.

Fatmir Mediu – Unë po përpiqem të sqarohem.

Unë mendoj se këtu ka një keqkuptim.

Fatmir Xhafaj – Dakord, por më leni të mbaroj.

Fatmir Mediu – E mbaroi. Kërkoj ndjesë nëse e kam ndërprerë.

(*Zoti Mediu flet anglisht.*)

Fatmir Xhafaj – Po, mund ta përktheni fjalën e zotit Devill.

Rainer Deville – Po, është e saktë që në nenin 6 janë parashikuar si kritere edhe paraqitja e deklaratës së pasurisë, siç është edhe prova..... Pra janë gjithë këto dokumente që paraqiten së bashku me CV-në. Por ne duhet të evitojmë që të kemi një rivlerësim të rivlerësimit të rivlerësimit. Kjo duke pasur parasysh edhe afatet kohore të parashikuara.

Por gjithsesi, nuk duhet të jetë e nevojshme që ata të paraqesin pesë dokumente ligjore shtesë që kanë lidhje me formimin profesional.

Për sa i përket kriterit të dekriminalizimit, ajo është në rregull, nuk kemi ndonjë kundërshtim.

Fatmir Xhafaj – Është bërë shtesa për garantimin e integritetit, është shtesa e re që ka bërë EURALIUS-i. Është te germa “d”, “... ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal, të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, të një vepre penale me dashje ose...” shtesa “të mos ketë qenë subjekt i ndalimeve të parashikuar në ligjin “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike””.

Vasilika Hysi – Unë do të doja të theksoja që neni 6, i cili amendohet nga opozita nëpërmjet amendamentit 9, i përmban të gjitha kriteret. Kriteret kryesore që ka Kushtetuta, konkretisht, në germën “c”, paragrafi i pestë janë të përfshira.

Kolegët e opozitës këtu kërkojnë të shtojnë disa kriterë ndaluese që Kushtetuta nuk i ka, ose të ndryshojnë disa kriterë që Kushtetuta i ka.

Unë e quaj të drejtë shtesën që ka bërë misioni EURALIUS, që ka përfshirë parashikimet për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen dhe në draftin që ne kemi, e kemi me bold.

E dyta, këtu është përfshirë që askush nuk mund të jetë anëtarë, bashkëpunëtorë, i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit e të tjerë, në bazë të ligjit që ne kemi miratuar, që nuk ka qenë gjyqtarë, prokurorë në dy vjetët e fundit. Këto janë kërkesa kushtetuese. E vetmja gjë që është shtuar është germa “g”, që nuk gjeta përgjigje, por nga ana tjetër ne nuk mund të vëmë kriterë të tjera, të ndryshojmë, kur thuhet që kandidatët nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike gjatë 10 vjetëve të fundit. Ju thoni “gjatë 4 vjetëve të fundit”. Kushtetuta e ka “10 vjetët e fundit”.

Paragrafi i pestë i nenit C, ku thuhet që anëtarët e komisionit dhe gjyqtarët e Kolegjit të Apelit kanë arsim të lartë juridik dhe jo më pak se 15 vjet përvojë si gjyqtarë, prokurorë, lektorë etj., kandidatët nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike dhe funksione drejtuese në parti gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. Ndërsa ju te germa “f” shtoni “të paktën gjatë 4 vjetëve të fundit përpara momentit të kërkesës për kandidim.”

Afati këtu është 10 vjet. Kam qenë unë në këtë komision, në këtë parlament që kam kundërshtuar afatin 10-vjeçar dhe kam thënë po shkoni shumë më larg dhe ju kam përmendur

Komisionin e Venecias, që thekson që ky është diskriminim shumë i madh, që kemi shkuar drejt përjashtimit me 10 vjet.

E dyta, se kush janë nëpunësit, funksionarët politikë në administratë publike, ka një përcaktim. Te ligji i nëpunësit civil nuk e ke. Te ligji i administratës ka qenë dhe është hequr. Te ligji i nëpunësit civil dihet se kush janë funksionarët politikë dhe ju pa të drejtë i quani këshilltarët e Presidentit njerëz apolitikë dhe digjni këshilltarët e Kuvendit, të Komisionit të Ligjeve, të Integritimit. Prandaj duhet të jemi më të kujdesshëm.

Oerd Bylykbashi – Ky është moment shumë i rëndësishëm i këtij ligji dhe besoj që diskutimi duhet të jetë shumë i kujdesshëm. Është e drejta e çdo shtetasi të Republikës së Shqipërisë për të kandiduar për një pozicion publik.

Së pari, kriteret e ligjit duhet të jenë shumë të qarta, të detajuara, në mënyrë që të kualifikohesh ose jo, në mënyrë që edhe ndokush tjetër, me çfarëdolloj ombrelle të madhe të ketë, të të masë sipas ligjit dhe jo si t'i dojë qejfi. Nuk mundesh të skualifikohesh kur i plotëson kriteret. Nëse nuk vëmë kriteret, ne mund të shohim shtetas shqiptarë që u mohohet e drejta kushtetuese për të garuar, sepse dikush mendon me opinion që nuk bën për atë pozicion. Prandaj detajimi i të gjitha kriterëve këtu është i rëndësishëm. E para. Përndryshe jemi përballë shkeljesh të një seri standardesh ndërkombëtare, që kjo çështje mund të na çojë deri në Strasburg. Merreni me seriozitet këtë pjesë, se më mirë është. Edhe një herë, duhet të jenë të gjitha kriteret e përcaktuara.

E dyta, ai që kontrollon, nuk mund të ketë standard më të ulët sesa ai që kontrollohet, prandaj ne themi për të barazuar kriteret, që të vlerësohen njësoj.

Mos u merrni me historinë e 10 vjetëve, se jua kemi thënë disa herë këtu, po e barazoni me hajdutin e dënuar, jo, thoshit, e mbani. E keni diskutuar vetëm kur nuk ishim ne, po u bindët pastaj që 10 vjet ishin shumë, po e latë në Kushtetutë, por këtu ne themi 4 vjet, në mënyrë që personi të paktën nuk del nga një kabinet politik. Ky është një nen shumë i rëndësishëm. Sado teknik që mund të duket, unë ju ftoj të votohet amendamenti, sepse bëhet shumë më i saktë sesa ajo që është. Nuk është historia që dikush tjetër e zgjat llastikun kaq apo e shkurton kur do të bëhet vlerësimi i kandidaturave.

Fatmir Xhafaj – dëgjuam gjerësisht komente nga të dy krahët, dëgjuam edhe shefin e misionit EURALIUS-it, ndaj ta hedhim në votim.

Kush është dakord me amendamentin 9? Kundër? Vetëm ju lutem, nëse ka diçka që duhet reflektuar te ky amendament, ne biem dakord në parim.

Neni 6. Kush është dakord?

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, për këtë nen opozita është kundër.

Fatmir Mediu- ...dokumentet plotësuese që duhet të plotësojnë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit...

Fatmir Xhafaj – U vu këtu te neni 6, është paraqitur me shtesë te germa “d”, i ka dhënë EURALIUS-i të gjitha këto.

(Diskutime pa mikrofon)

Janë këtu të listuara.

Oerd Bylykbashi – Unë jam kundër.

Fatmir Xhafaj – Neni 7.

Po, zoti Bardhi.

Gazmend Bardhi – Për sa i përket nenit 7, ne kemi amendamente që i referohen amendamentit 10.

Ne mendojmë që ky nen nuk përmbush standardet e urdhëruara nga kushtetutbërësi për shkak se rregullat e parashikuara në ligj janë më të pakta sesa vetë rregullat që ka Kushtetuta, ndërkohë që duhet të jetë e kundërta, duhet të jetë ligji që detajon procedurën parimore që ka parashikuar dispozita kushtetuese. Fjala vjen, Kushtetuta urdhëron që një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit të vlerësojnë kandidatët sipas ligjit, që do të thotë referon te mënyra, procedura, rregullat, standardet sipas...

Fatmir Xhafaj – Sipas ligjit, ky është koncepti.

Gazmend Bardhi – Sipas ligjit do të thotë që rregullat për vlerësimin do t'i përcaktojnë ligji. ndërkohë pika 12 e po të njëjtit nen, neni C thotë që procedura e detajuar, me procedurë të detajuar i referohet procedurës së parashikuar nga Kushtetuta për zgjedhjen e organeve të vetingut, rregullohet me ligj. Pra kemi një dispozitë kushtetuese që të referon në ligj dhe kemi një dispozitë ligjore që të referon në Kushtetutë, pra bëjnë referim te njëra-tjetra. Ndërkohë që ne mendojmë që procesi i zgjedhjes së anëtarëve të organeve të vetingut, jo vetëm është moment kyç që duhet të pasqyrohet në mënyrë të detajuar në projektligj, sepse është garanci për procesin e përzgjedhjes së individëve që do të kryejnë vlerësimin e organeve të vetingut, prandaj propozojmë shtimin e një pakete nenesh, konkretisht neneve 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21 të këtij

ligj, që kanë të bëjnë me shpalljen e vakancës nga Presidenti i Republikës, më pas me verifikimin formal të kritereve që bën Presidenti i Republikës, dërgimin e akteve Kuvendit dhe detyrimin e tij që përpara se t'i dërgojë aktet Kuvendit, të marrë rekomandimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe t'ia përcjellë atë Kuvendit, për të kaluar te verifikimi i kandidatëve që bën komisioni *ad hoc* i verifikimit me 6 anëtarë, për të kaluar më pas te komisioni parlamentar *ad hoc* i përzgjedhjes, ku duhet të ketë edhe rregulla sesi do të funksionojë sistemi elektronik i përzgjedhjes së këtyre kandidatëve, sepse është një procedurë që misioni EURALIUS propozon që të shtohet fjalia sipas Rregullores së Kuvendit, por, në fakt, unë rregulloren e Kuvendit e kam me vete dhe nuk ka asnjë rregull që rregullon këtë proces. Nëse qëllimi është që pas këtij ligjit të presim edhe dy muaj të tjerë për të bërë ca ndryshime në Rregulloren e Kuvendit që të rregullojmë këtë procedurë, kjo është gjë tjetër, por për sa kohë ne po miratojmë ligj, ligjin duhet ta kemi me rregulla të përcaktuara këtu. Sikundër amendamentet kushtetuese i shtrojnë për zgjidhje ligjvënësit disa çështje praktike që mund të rezultojnë gjatë zbatimit të dispozitës kushtetuese, pra nenit C të aneksit. Për shembull, si veprohet në rastet kur krijohet një vakancë në mes të funksionimit të këtyre organeve, sepse Kushtetuta flet për zgjedhje në bllok, por mund të ndodhë që tre a katër anëtarë pas një viti nga funksionimi të japin dorëheqjen. Duhet t'i jepet zgjidhje nga ligji se si do të veprohet në këtë situatë. Sikundër mund të ndodhë situata që numri i kandidatëve të kualifikuar, duhen gjithsej 21 edhe katër zëvendësues, pra duhet të zgjidhen 25 funksionarë, ndërkohë që lista e atyre që plotësojnë kritere formale mund të ketë vetëm pesë. Dhe Kuvendi, pra ligjvënësi duhet t'i japë zgjidhje se si duhet vepruar në këtë situatë, sepse janë situata praktike, që mund të ndodhin dhe nuk mund të lihen në çmim diskrecional të organeve, pra presidentit, OMN-së pastaj Komisionit të Verifikimit, pastaj komisionit *ad-hoc* dhe në fund Kuvendit.

Prandaj mendojmë që procedura e përzgjedhjes së organeve, siç veprohet në fakt me çdo organ ose ligj të organeve që rregullon organizimin dhe funksionim e tyre, pra nuk mund të ketë ligj që përcakton organizimin dhe funksionimin të organeve kushtetuese që referon në Kushtetutë. Duhet të jetë e kundërta: është Kushtetuta që vendos parimin dhe ligji është ai që detajon rregullat. E përsëris dispozita, neni 7 ka më pak rregulla seç ka vetë teksti i Kushtetutës. Ndërkohë që duhet të zbërthejmë në detaje çdo propozim ose çështje që lidhet me procedurën e emërimit. Unë nuk po i lexoj propozimet tona për efekt kohë, por në parim ky është qëllimi i propozimit të këtyre amendamenteve.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Bardhi!

Ka dikush tjetër diçka.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, unë gjykoj, madje ua sugjeroj të gjithë anëtareve që këto formulime kaq të detajuara, që rregullojnë pjesë të cilat Kushtetuta nuk i ka, madje vetë Kushtetuta, siç tha zoti Bardhi, ka më shumë sesa neni i propozuar, pra rregullimi i kaq detajuar do të na shpëtojë nesër nga të gjithë pikëpyetjet që do të kemi gjatë zbatimit. Unë sugjeroj që ta marrim me kthjelltësi me ftohtësi, se është një nen që rregullon hap pas hapi atë që do të bëhet, do të bëhet vetëm një herë. Nuk mund të mendojmë Rregulloren për këtë. Rregullorja nuk ka rregulla. Edhe momenti i mekanizimit elektronik ka qenë një nga elementet kyçe zgjidhëse të mënyrës së përzgjedhjes së anëtarëve dhe ai do disa detajime si do të funksionojë në sistem. Merremi me thjeshtësi si nen teknik procedural.

Fatmir Xhafaj – Edhe unë e besoj që ka elemente teknike për ta detajuar. Meqenëse këtu janë shumë nene dhe janë shumë të detajuara, do t’ju lutesha që të përkthehen edhe për ekspertët me qetësi dhe në kohë. Ne e kalojmë në parim nenin 7 dhe elementet pozitive, që mund të ketë mund të merren. Nëse nuk ka elemente, le të ngelet neni 7 siç është.

Vasilika Hysi – Për korrektesë dhe për procedurë. Zoti Bardhi prezantoi këtu jo vetëm nenin 7, por prezantoi këtu edhe një sërë nenesh të tjera. Neni 7 është problematik dhe bie ndesh me Kushtetutën. Kjo që thoni ju ia vlen për nenet e tjera. Pse? Neni 7 përpiket të rregullojë punën e presidentit të Republikës. Pra neni 7 i mendimeve, që numërohet 14 nga opozita, i jep presidentit kompetenca..

Fatmir Xhafaj – Jo neni 7, neni 14 shtesë.

Vasilika Hysi – Po 14-ta shtesë i jep presidentit kompetencat e komisionit të vlerësimit. Pra këtu thuhet se çfarë duhet të bëjë presidenti, çfarë duhet të bëjë sekretari i përgjithshëm i presidentit, si duhet të kërkojë dokumente presidenti etj. Dua t’i marr nenet më vetë, sepse me këtë nen nuk jam dakord, për pjesën tjetër pajtohem me ju dhe me një pjesë të çështjeve që kanë vend që ekspertët e EURALIUSI-t të punojnë.

Fatmir Xhafaj – Neni 14, në gjykimin tuaj është jo në përputhje më Kushtetutën. Dakord.

Vasilika Hysi – Neni 14 i variantit të opozitës që amendon nenin 7 të draftit, që ne kemi parë, bie ndesh me Kushtetutën. Pse? Sepse në këtë rregullim ne duhet të kemi parasysht paragrafin 6 të nenit të Kushtetutës. Presidenti bën një vlerësim formal të kriterëve. Presidenti

mbledh kandidaturat. Është Misioni i Monitorimit Ndërkombëtar që bën vlerësimin, të cilit e bën në bazë të ligjit.

Kolegë, më falni!

Zoti Mediu, ju dëgjova, nuk ndërhyra, sepse dua që t'i qartësojmë pak gjërat. E ngrita problemin proceduralisht. Nuk mund të diskutojmë 18 nene njëherësh, sepse në çdo nen ka problematika të ndryshme. Ndaj do të kërkoja t'i marrim amendimet e opozitës një e nga një.

Fatmir Xhafaj – I morëm.

Vasilika Hysi – Më falni, zoti kryetar, është esenciale. Më dëgjoni, sepse nuk po më lini.

Neni 14 i opozitës që bën shpalljen e vendeve vakante, nuk është presidenti i republikës që bën vlerësimin e dokumenteve, nuk është presidenti i Republikës që i drejtohet Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive, SHISH-it, DSKI-së etj, ose kandidatit t'i thotë: shiko po aplikon ti, po nuk i ke të rregullta dokumentet, plotësoi. Jo, jo është Misioni i Monitorimit Ndërkombëtar.

Ju lutem, a ta mbaroj fjalën, sepse po ju dëgjoja me shumë vëmendje?

I kam lexuar tërë natën opinionet tuaja, prandaj të lutem.

Për nenin 7, zoti kryetar, duhet të jemi të kujdesshëm që të jetë në përputhje me paragrafin 6, të nenit C të aneksit kushtetues.

E dyta, marrim nenet e tjera, që shtoi zoti Bardhi, që thotë pas nenit 14 shtohet nenet 15, 16 etj.

Neni që shtohet këtu, pra neni 15, 16-ta ka të bëjë me verifikimin formal të kandidatëve. Edhe këto nene nuk na thotë Kushtetuta ne që në ligj të rregullojmë kompetencat e presidentit. Presidenti nuk mund të bëjë atë punë që do ta bëjë Komisioni i Monitorimit Ndërkombëtar. Ai sheh thjesht kriteret formale. Pra, ne në këtë ligj kapërcejmë atë gjë që ka dhënë Kushtetuta. Nenet e tjera duke filluar me radhë nga neni 16, neni 16 jep kompetencat ose sqaron se çfarë duhet të bëjë operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit. Me të drejtë zoti Bardhi, këtu sugjeron dhe thotë që një komision i përbërë nga tre përfaqësues të operacionit ndërkombëtar vlerëson kandidatët sipas ligjit. Dhe unë këtu pyetjen e kam për ekspertët dhe ekspertëve t'u japin kohë.

Janë dakord ekspertët se mënyra sesi do të operojë operacioni në detaj, duhet të jetë në këtë ligj? Meqenëse ka një paragraf në Kushtetutë. Pra, paragrafi 7 te neni C i aneksit që thotë:

“Një komision i përbërë nga 3 përfaqësues të operacionit bën vlerësimin e kandidatit, sipas ligjit”

Unë mendoj që Kushtetuta për shkak të kompromisit që kemi bërë, ju që keni qenë në negociata në minutën e fundit, ka detajuar çdo gjë në Kushtetutë, nuk na i ka lënë fare t’i bëjmë në ligj. Dhe i ka filluar paragrafë më paragrafë në nenin C të aneksit nga 8-a, 9-a,10-a dhe thotë sesi duhet të veprojë operacioni, çfarë duhet të bëjë komisioni *ad-hoc*, çfarë duhet të bëjë parlamenti. Dhe mesa mbaj mend është thënë që do ta bëjë me detaje në Kushtetutë, që të ketë qëndrueshmëri dhe të mos kemi lojëra të partive politike në ligjet e tjera.

Prandaj, të nderuar kolegë, të bëjmë dallimin e neneve që rregullojnë dhe i japim më shumë kompetenca presidentit se sa i jep Kushtetuta dhe këtu pajtohemi me pjesën e dytë të propozimit që bëri kryetari i komisionit, që në ato nene, nëse ka dhe ka elemente pozitive, t’ia lëmë ekspertëve t’i reflektojnë.

Fatmir Xhafaj – Dakord kështu atëherë?

Oerd Bylykbashi – E dëgjova me vëmendje zonjën Hysi. Po i them këtë gjë: kjo që kërkon të mbrojë zonja Hysi është në kundërshtim me Kushtetutën, është haptazi në kundërshtim me Kushtetutën. Është një tentativë për të alteruar atë që është marrëveshja politike dhe e shkruar madje edhe me letër nga komisionieri Hahn dhe teksti kushtetues që u ra dakord. Secili të marrë dhe të bëjë pjesën që bën. Ata që kanë detyrë formale zbatimin e ligjit, nuk do të thotë që vetëm ta lexosh dhe të mbyllësh kapakun, do të thotë të ushtrosh detyrën institucionale kushtetuese. Ata që kanë detyra të tjera, përfshirë rekomandimin do ta bëjnë detyrën e tyre deri më një, por askujt nuk mund t’i hiqet kompetenca e parashikuar nga Kushtetuta. Presidenti i Republikës do të bëjë vlerësimin si për të gjitha kriteret ligjore dhe në mënyrë të vërtetë. Kjo do të thotë formale, nuk do të thotë informale, me llafe pazari. Ndërsa operacioni ndërkombëtar i monitorimit do të bëjë pjesën që i takon, atë që thotë Kushtetuta: rekomandimin. Pra, ky nen, që është më pak nga ç’parashikohet në Kushtetutë, alteron germën e Kushtetutës, bie ndesh, do të krijojë probleme. Më mirë shihni këtë që ju propozojmë ne.

Fatmir Xhafaj – Zoti Vasili.

Petrit Vasili – Kam diçka në princip. Bashkohem me sugjerimin shumë konstruktiv që udha, që t’i konsiderojmë amendamentet jo thjesht një detyrim, por edhe një mundësi për të reflektuar. Kushdo që propozon një amendament do të dëshironte që ai amendament të futej 100% ashtu siç mendon. Që kur e shkruan, njeriu këtë synon.

Por unë them, që duhet ta evitojmë për një arsye shumë të thjeshtë. Edhe drafti që kemi në dorë ka mjaft reflektime të dobishme e të rëndësishme që kanë ardhur si sugjerime të opozitës. Kjo është shumë pozitive. Në rast se nuk do të ishin reflektuar këto, do të kishim disa kontribute më pak. Edhe në nene të tjera, kudo kemi mundësi të operojmë në këtë mënyrë, të veprojmë kështu. Pra, kemi një draft me reflektime të opozitës, por edhe me reflektime të komisionet, kemi një ekspertizë ndërkombëtare që mund ta bëjë shumë mirë këtë punë, ndaj t ecim me këtë frymë. Pastaj a e bindim apo jo njëri-tjetrin, kjo është një betejë pa fitues. Prandaj them që të ecim me këtë lloj metodike pune, atje ku kemi mospërputhje të shprehemi prerë, siç jemi shprehur me votë dhe të tjerat që kanë mundësi mirëkuptimi na ndihmojnë të ecim më shpejt.

Fatmir Xhafaj – Okej. Besoj se në këtë frymë votojmë nenin 7 të projektligjit... Po.

Vasilika Hysi – Ka nevojë të vihet një afat nga ekspertët, te neni 7, sepse Presidenti,thuhet, shpall vendet vakante. Ai i shpall menjëherë. Sa ditë u lihen kandidatëve të aplikojnë? Nuk është lënë një afat për këtë.

Fatmir Xhafaj – Mirë, ta shikojmë, nëse ky afat është i dobishëm, ta marrim dhe ta përshtatim. Dakord? Amendamentet tuaja i votuam kundër me rezervën që elementet pozitive t'i përfshijmë. Kemi rënë dakord për këtë gjë.

Oerd Bylykbashi – Është gjë tjetër kur e lëmë në parim një nen që do të diskutohet për t'u riformuluar dhe gjë tjetër kur rrëzohet amendamenti dhe marrim një presje këtu, një presje atje. Kjo nuk është e njëjta gjë.

Fatmir Xhafaj – Si amendament komplet nuk ke si e fut.

Oerd Bylykbashi – Ky ashtë defekti i punës së ekspertëve, të cilët nuk u ulën të binin dakord. Meqë ne kemi një amendament që e rregullon mirë këtë gjë, dhe ju thoni do marrim vetëm tre paragrafë, kjo nuk vlen. Kështu që e votojmë nenin kështu.

Fatmir Xhafaj – E votojmë nenin me amendamentet e opozitës. Kush është dakord? Kundër? Bie. Neni 7 i projektligjit të paraqitur nga ekspertët? Dakord me shtesat e propozuara, miratohet. Kundër jeni ju.

Neni 8. Kryetari i komisionit dhe kolegjit të apelimit. Dakord? Dakord me rezervën që elementet pozitive t'i përfshijmë.

Pandeli Majko – Zoti kryetar, ka shumë rëndësi një gjë: Pse nuk votojnë përfaqësuesit e opozitës? Nuk kanë vërejtje për këtë nen dhe nuk e votojnë. Merre mikrofonin dhe thuaj pse nuk voton!

Oerd Bylykbashi – Zoti Majko, bëni detyrën tuaj dhe mos i tregoni opozitës se çfarë duhet të bëjë.

Fatmir Xhafaj – Neni 8 miratohet, opozita nuk votoi. Neni 9, kompetencat e kryetarit të komisionit dhe të kolegjit të apelimit. Dakord? Dakord. Po... zoti Bardhi.

Gazmend Bardhi – Unë dua të flas në tërësi për këtë grup dispozitash. Te 9-ta kemi një shqetësim lidhur me shkronjën “ç” “nënshkruan aktet e tjera të komisionit me përjashtim të vendimeve” Duke qenë se kryetari i KPK-së do të jetë edhe një nga anëtarët e trupave gjyquese ne mendojmë se... volumi që do t’i jepet dhe puna që do të bëjë KPK-ja dhe çdo akt dhe marrëdhënie me të tretët, do të jetë një ngarkesë e shtuar për kryetarin dhe mund të jetë një marrëdhënie administrative. Pra, jo çdo akt, përveç vendimeve, nënshkruhet nga kryetari, le të themi sot, i Gjykatës Kushtetuese. Njoftimet që na vijnë ne për seancë nënshkruhen nga drejtori i ...

Fatmir Xhafaj – Kryetari e delegon firmën.

Gazmend Bardhi – Nuk mund të delegohen përveç kompetencave që ngarkohen shprehimisht me Kushtetutë.

Fatmir Xhafaj – Është parimi i përgjithshëm i delegimit.

Neni 9 u miratua siç është. Neni 10, me vërejtjet e bëra nga...

Vexhi Muçmata – Kryetar, diçka teknike për nenin 9. Nisur nga titulli i nenit, te germa “b”, pjesa “përfaqëson komisionin ose kolegjin”, mendoj se duhet shtuar edhe te pika ku thuhet “nënshkruan aktet e tjera të komisionit ose të kolegjit”.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Besoj u mbajt shënim. Në rregull, keni të drejtë.

Neni 10, organizimi i komisionit.

Gazmend Bardhi – Ne mendojmë se organizimi i komisionit duhet të jetë në trupë 3, siç thotë edhe Kushtetuta dhe relatori i çështjes të jetë njëkohësisht edhe kryetar i trupës për atë çështje që gjykohet, sepse ngatërrimi apo dhënia e dy funksioneve një trupe me tre vetë, njëri relator, tjetri kryetar, tjetri anëtar duket një ndarje e papërshtatshme. Ky është një organizim që bëhet edhe sot në sistemin tonë gjyqësor, pra relatori dhe që i hyn në thellësi çështjes, dhe ka ngarkesë më të madhe se anëtarët e tjerë, do të jetë edhe drejtuesi i atij paneli gjyqësor për atë

çështje konkrete. Nuk kemi pse ndajmë kompetencat mes relatorit dhe... sepse duhet të kemi parasysh që KPK është edhe organ administrativ.

Fatmir Xhafaj – Okej. Zoti Deville.

Rainer Deville – *(përthën përthyesja)* Në botë këto lloj procedurash trajtohen ndryshe në gjykata apo ... Unë edhe mund ta shpjegoj pse ndodh ndryshe dhe përdoret një lloj eksperience tjetër.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, për ta saktësuar, meqë e kërkoi edhe relatori, këto janë nene të aspektit teknik, nuk merret fare në konsideratë propozimi që bëjmë ne, ne nuk votojmë për këtë pjesë. Në çështjet e rëndësishme do ta shprehim votën kundër në mënyrë specifike.

Pandeli Majko – Dua të shpjegoj qëndrimin. Kërkova pse opozita nuk voton nene për të cilat nuk ka asnjë vërejtje. Tani erdhët te logjika që nuk votoni edhe atje ku nuk keni vërejtje.

Oerd Bylykbashi – Zoti Majko, ju lutem mos ndryshoni fjalët e mia! Ne kemi vërejtje për mënyrën si është shkruar neni teknikisht. Nuk është principiale. Ju thoni dëgjoni dhe ne...

Fatmir Xhafaj – Neni 10 miratohet me ndryshimet e propozuara nga ekspertët ndërkombëtarë.

Fatmir Mediu - Ne po bëjmë një gjë që është tërësisht e drejtë për një arsye: për sa kohë kemi bërë amendamente dhe këto nuk konsiderohen, nuk mund të themi se jemi dakord me amendamentin tonë, por edhe me këtë tjetrin. Ne duam të ketë një reflektim.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Neni 11. Keni amendament?

Gazmend Bardhi – Përpara kësaj dispozite kemi një amendament që më duhet ta sqaroj. Është neni 32 i versionit tonë, amendamenti 12. Ka lidhje me këtë. Dua të bëj një sqarim zoti kryetar. Unë jam në pozitë inferiore në këtë komision, por keqkuptime për kodin e procedurave apo komente mbi njohuritë time mbi procedurat, besoj se nuk kam pse marr, aq më tepër nga zoti Devil. Unë fola për organ administrativ. KPK-ja është organ administrativ. Nuk ka të bëjë me kodin e procedurës penale apo civile apo me gjykatat. Relatori është edhe kryetar dhe kjo është praktikë normale. Nuk mund të lejoj askënd të më fyejë aq më tepër dikush që nuk më njeh fare. Sa i përket amendamentit që kisha, Kushtetuta flet për anëtarë dhe gjyqtarë zëvendësues. Madje, ashtu siç unë e lexoj amendamentin kushtetues, për çdo anëtar të KPK-së apo kolegjit të apelimit ne duhet të zgjedhim edhe nga dy zëvendësues. Jam përpjekur t'i jap një interpretim ndryshe duke thënë që me fjalën pozicion, pavarësisht se referohet në dy paragrafë dhe nuk bëhet fjalë për organ, por i referohet anëtarit dhe gjyqtarit, ne kemi menduar që nuk mund të ketë dy anëtarë

zëvendësues për çdo pozicion, sepse kjo do të sillte trefishim të numrit të anëtarëve që ne do të zgjedhim.

Mendoj se ligji duhet të sqarojë se bëhet fjalë për dy anëtarë zëvendësues në KPK dhe dy gjyqtarë zëvendësues në KPK. Duhet të jetë ligji që të përcaktojë se çfarë roli kanë anëtarët dhe gjyqtarët zëvendësues, sepse duke qenë zyrtarë që do të paguhen, mendoj se duhet të jenë të përfshirë edhe në punë konkrete në përditshmërinë e tyre. Prandaj e kemi konceptuar në amendamentin tonë që anëtari apo gjyqtari zëvendësues, krahas zëvendësimit në rast mungese apo pamundësie pjesëmarrjeje të njërit prej anëtarëve, kryen edhe detyra që i delegohen për të ndihmuar relatorin e çështjes. Pra, të shërbejë si një ndihmës i relatorit të çështjes, e ndarë kjo pa diskutim edhe në trupa përkatëse. Por ligji duhet ta sqarojë nocionin e anëtarit dhe gjyqtarit zëvendësues. Projektligji i paraqitur nuk ka asnjë parashikim për këtë, është funksion që e parashikon Kushtetuta dhe ligji duhet ta parashikojë.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, ne kemi në tavolinë nenin 11 që flet për organizimin e kolegjit të apelit. Për këtë nen, ju, zoti Bardhi, keni një amendament, që është neni 32 i paketës së mendimeve tuaja. I vetmi që shikoj në këtë nen është se si bëhet shpërndarja e çështjeve në trupat gjyqësore. Keni shtuar shortin dhe i jeni referuar paragrafit të tretë të nenit 31. Ta mbyllim këtë nen, pastaj kalojmë tek anëtari apo gjyqtari zëvendësues, që është neni 33 juaji, që te projektligji nuk ekziston. T'i marrim me radhë se po bëhemi lëmsh.

Gazmend Bardhi – Mendova se e kaluam atë dispozitë se është e lidhur me nenin 31. Pra, e njëjta formë organizmi që ne e kemi propozuar te 31-i, që komisioni e rrëzoi, e kemi propozuar edhe te 32-i.

Fatmir Xhafaj – E kuptuam. Neni 11, dakord? Dakord. Ju jeni kundër. Neni 12? Përgjegjësia disiplinore e anëtarit të institucionit të rivlerësimit, me ndryshimet që kanë propozuar ekspertët te pika 1 dhe pika 13 si refleksion i propozimeve të deputetëve të PD-së. Zoti Bardhi.

Gazmend Bardhi – Zoti kryetar, ne mendojmë se neni 12 duhet të jetë i ndarë në disa dispozita. E para, ligji duhet të specifikojë rastet e mbarimit të mandatit të anëtarë të KPK-së të kolegjit të apelit dhe më pa të kalojë në përgjegjësinë e tyre disiplinore. Shkarkimi nga detyra është vetëm njëra rrethanë e mbarimit të mandatit të KPK-së apo kolegjit të apelit. Ndërkohë që ka edhe shkaqe të tjera të cilat ne i kemi përfshirë në nenin 27. Sa i përket përgjegjësisë disiplinore, ne kemi menduar që të përfshihet edhe koncepti i pezullimit nga detyra, pra të ndiqet

i njëjti standard që ndiqet në organet e tjera kushtetuese, konkretisht Gjykatën e Lartë apo gjyqtarët dhe prokurorët dhe përcaktohet edhe paga që merr funksionari, që është 50 për qind e pagës për të qenë në të njëjtin standard me pjesën tjetër.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Votojmë nenin 12. Kush është pro amendamenteve? Kundër? Nuk miratohen. Neni 12 i projektligjit, përgjegjësia disiplinore e anëtarit. Kush është pro? Kundër? Miratohet neni 12 me ndryshimet e propozuara. Vazhdojmë me nenin 13, procedurat për shkarkimin e anëtarit të institucioneve të rivlerësimit. Nuk ka ndonjë ndryshim. Dakord. Neni 14... Keni amendament? Cili është amendamenti te neni 13?

Gazmend Bardhi – Është neni 29. Ne mendojmë se kërkesa që kërkesa për fillim të hetimit disiplinor nuk mund të paraqitet nga komisioneri për komisionerin, gjyqtari për gjyqtarin apo anëtari i KPK-së për anëtarin e KPK-së. Ne mendojmë se subjektet që paraqesin kërkesë për fillim hetimi disiplinor për anëtarët e KPK-së dhe gjyqtarët e kolegjit të apelimit duhet të jetë një nga komisionarët publik. Ndërkohë për komisionarin publik duhet të jetë sekretari i përgjithshëm i KPK-së. Por kërkesa për fillimin e procedurës disiplinore që shqyrtohet nga këto dy struktura, mund të paraqitet nga çdo gjyqtar i kolegjit të apelimit për të ruajtur edhe subjektet që janë në dispozitën e versionit të komisionit nga çdo komisioner publik, nga çdo anëtar i KPK-së, nga çdo vëzhgues ndërkombëtar, madje edhe nga një e dhjeta e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, të cilët janë trupa që përfaqëson interesin publik dhe mund të zbulojë një rrethanë që ka sjellë përgjegjësi disiplinore për anëtarët e KPK-së apo kolegjit të apelimit dhe mund të vërë në lëvizje komisionerin apo sekretarin e përgjithshëm sipas rastit.

Fatmir Xhafaj - ... ju bëtë një propozim. Ne mendojmë se është informalizuar te neni 14. Besoj se nuk jemi dakord.

Gazmend Bardhi - Neni 14 është për organet administrative, para 14-s.

Fatmir Xhafaj - Po pra, e votuam. Neni 14, organizimi dhe administrimi i institucioneve të rivlerësimit. Ka gjë? Nuk ka. Neni 15. Po.

Gazmend Bardhi – Ne mendojmë se duhet të ketë një dispozitë që njeh mbledhjen e përgjithshme të anëtarëve dhe gjyqtarëve, që duhet të jetë trupa më e lartë që merret me çështjet makro të të dyja institucioneve. Le të themi strukturën organizative të kolegjit të apelimit duhet ta miratojë mbledhja e përgjithshme e kolegjit të gjyqtarëve. Në të njëjtin standard sepse është trupë që i atashohet Gjykatës Kushtetuese, në të njëjtin standard që vepron edhe Gjykata Kushtetuese. Pra, duhet të ndiqet i njëjti model organizimi, sepse bëhet fjalë për një institucion

që i atashohet Gjykatës Kushtetuese dhe nuk mund të jetë i organizuar nga pikëpamja institucionale ndryshe nga GJK. Prandaj ne mendojmë se duhet të ketë shtim të një strukture të re, që është mbledhja e përgjithshme e anëtarëve të GJK, e cila duhet të luajë të njëjtin rol siç luan sot mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të GJK.

Fatmir Xhafaj – Zoti Devil.

Rainer Deville – (*përkthen përkthyesja*) Kjo është pak e ekzagjeruar. Nëse ekziston nevoja ata mund të takohen, të mblidhen dhe të marrin ato vendime që duhet të marrin nga, por nga pikëpamja e draftimit profesional është pak e ekzagjeruar.

Fatmir Xhafaj – Siç thamë, nuk biem dakord me këtë shtesë. Vazhdojmë me nenin 15, buxheti i institucioneve të rivlerësimit. S’ka ndonjë gjë. Vazhdojmë me nenin 16, sekretari i Përgjithshëm. Zoti Bardhi.

Gazmend Bardhi - Komenti që kemi është se sekretari i Përgjithshëm duhet të përmbushë të njëjtat kushte si anëtarët me përjashtim të kriterit të eksperiencës, sepse nuk është ashtu në projektligj. Pra, duhet të ketë te dispozita që përcakton kriteret për anëtarët e KPK-së apo të kolegjit me diferencën për sa i përket eksperiencës në punë.

Fatmir Xhafaj – E ka jo më pak se 10 vjet eksperiencë. Ai nuk është komisioner, nuk është gjyqtar. Të gjitha ata i vlerësohen vlerësimit, e ke te dispozita më poshtë.

Gazmend Bardhi – Dispozita thotë është e ndaluar, zoti kryetar. Pra, nuk i nënshtrohen.

Rainer Deville – (*përkthen përkthyesja*) Nëse shikoni nenin 17 aty janë të përshkruara detyrat që kryen sekretari i përgjithshëm. Mendoj se të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 16 janë të mjaftueshme dhe justifikojnë si ngarkesën e punës, ashtu edhe natyrën e punës që ai kryen.

Oerd Bylykbashi – Diçka nuk shkon, por nuk shkon shumë, me funksionimin e këtij komisioni, i cili nuk i ngjan asnjërit në këtë Parlament. Pa arsytim bie e gjithë puna që bën gjysma e këtij komisioni. Një person nuk mund të zëvendësojë 140 deputetë thjesht me arsyetimin “nuk bie dakord”. Kjo është e paprecedentë në një komision *ad hoc* si ky.

Fatmir Xhafaj – E kërkuat ju që të japin komente. E tha që këto që po kërkon janë te neni 16.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, unë kam qenë në atë rol më parë, ku maksimumi i detyrës së një eksperti është të thotë arsyet pse, ndërkohë që për po ose jo vendos ky komision. Ky është një rast i paprecedent. Gjysma e punës së këtij komisioni po hidhet në plehra vetëm me një fjalë.

Fatmir Xhafaj – E keni gabim, jeni i nxituar. Neni 16? Dakord. Neni 17, dakord me sugjerimin e shtuar nga EURALIUS-i? Dakord. Neni 18, njësia e shërbimit ligjor. Po, zoti Bardhi.

Gazmend Bardhi – Edhe në këtë rast besoj se do të ketë unifikim të kriterëve të tjera, përjashtuar kriterit të eksperiencës. Pastërtia e këshilltarëve ligjorë dhe ekonomikë për sa kohë përgatitin raporte dhe relacione, duhet të jetë e njëjtë me anëtarët, janë këta që do të bëjnë punën dhe do të ndihmojnë komisionarët në marrjen e vendimit. Sigurisht, kriteri i eksperiencës nuk mund të jetë 15 vjet, por pranojmë dhe jemi dakord që të jetë 7 vjet, sa është vendosur në projektligj. Për kriteret e tjera duhet të përmbushin të njëjtat kriterë.

Fatmir Xhafaj – Dakord, siç është? Dakord. Neni 19, detyrat e këshilltarit. Dakord. Opozita nuk merr pjesë në votim. Neni 20, marrëdhëniet me median. Dakord. Opozita nuk merr pjesë në votim. Neni 21, mbrojtja e anëtarëve e institucioneve të rivlerësimit dhe personelit vendas dhe ndërkombëtar. Është riformular. Dakord. Opozita nuk votoi. Neni 22...

Keltis Kruja – Diçka për procedurë. Këtu nuk po voton askush, ndaj ju mos merrni përsipër të thoni se opozita nuk po voton. Nuk ju pashë duart e ngritura, zoti Majko, për dy nenet që sapo kaluan.

Oerd Bylykbashi – Në të gjitha nenet ku ne do të kemi kundërshtim, do ta shprehim atë. E saktësoj: në të gjitha nenet ku ne do të kemi kundërshtim, në mënyrë të veçantë në votim, do të themi “kundërshtojmë këtë nen”. Nenet e tjera opozita nuk i voton.

Fatmir Xhafaj – Kalova nenet 21, 22, 23...

Gazmend Bardhi – Më fal, ndoshta do të ishte e përshtatshme të bëhej referim kushtetues se këtu po referon një ligj që nuk është miratuar dhe me sa di unë, ky ligj do t'i paraprijë atij ligjit tjetër, ligjit për organet antikorupsion, dhe nuk mund të ketë referim të një ligj që nuk është miratuar dhe nuk i dimë përmbajtjen. Nëse miratohet ky, nuk do të jetë aq i sigurt. Te neni 24, kryetar. Ndërkohë që mund të referohet neni 135, paragrafi 2 i Kushtetutës.

Fatmir Xhafaj – Ne mund të gjejmë një formulim më elegant, duke mos e dhënë kështu me titull ligji, por duke thënë “ligji që do të trajtojë çështjet...” Mbajeni parasysh! Por që ai ligj do të ndërtohet, e ka përcaktuar Kushtetuta. Neni 25, pagat dhe përfitimet e anëtarëve dhe këshilltarëve. Mbetet siç është.

Vexhi Muçmata – Kam diçka te neni 25, pika 5. “Ata mund të përfitojnë”, thuhet. Fjala “mund” nga pikëpamja teknikës legislative nuk duhet të përdoret.

Fatmir Xhafaj – E kemi thënë në fund, ka akte nënligjore ku rregullohet. Te pika 5 e kishte, zoti Vexhi. Pika 5, këshilltari ligjor dhe ekonomik mund... e ka fjalën për fjalën “mund”. Hiqet. Jemi në rregull. E ke në fund fare.

Oerd Bylykbashi – Për procedurë. Siç e keni të qartë, edhe në shkresën dërguar në komisionet në datën 19, PD-ja ka propozuar amendamente deri te neni 25. Në atë shkresë ne jemi zotuar që deri në datën 27 të depozitohen amendamentet e tjera për të gjitha nenet. Besoj se i vlen punës për të bëtë një diskutim të plotë dhe gjithëpërfshirës të qëndrimeve të këtij komisioni. Edhe një herë shtoj se... Dakord, Konferenca e Kryetarëve mund të marrë në konsideratë edhe kalendarin tonë të punës. Angazhimi ynë është i tillë që ky ligj të miratohet, të hyjë në parlament kur ne e përfundojmë punën dhe konferenca e vendos këtë punë. Pra, do të vendosni që të ecet pa amendamentet tona, zoti kryetar? Në rregull.

Fatmir Xhafaj – Neni 26, objekti i vlerësimit të pasurisë, siç është. Neni 27, fillimi i procedurës së vlerësimit të pasurisë mbetet siç është.

Oerd Bylykbashi – Nenin 27 hidhe në votim!

Fatmir Xhafaj – Po. E votojmë.

Oerd Bylykbashi – Jemi kundër.

Fatmir Xhafaj - Opozita është kundër. Neni 28, deklarimi i pasurisë, pika 2 është riformuluar tërësisht sipas komenteve të opozitës nga ekspertët. Kush është dakord me gjithë riformulimin? Kundër? Opozita nuk merr pjesë në votim.

Neni 29, procedura e vlerësimit të pasurisë. Mbetet siç është.

Oerd Bylykbashi – Ne jemi kundër.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Neni 30 mbetet siç është, opozita kundër. Neni 31...

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, unë do ta them sa herë kam diçka kundër, për çdo nen.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Neni 30 mbetet siç është. Neni 31, fillimi i procedurës për kontrollin e figurës.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, e kam për ekspertët, për afatin. Le të themi që brenda 45 ditëve Presidenti bën procedurën e zgjedhjes së këtyre organeve. Nga ana tjetër në ligj thuhet se brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e kontrollit të figurës...

Fatmir Xhafaj – Ideja është që ata çojnë të dhënat dhe ata fillojnë procesin. Vlerësimi është tjetër gjë.

Vasilika Hysi – Mund të ndodhë që të përplasen afatet? Këtë kam merak?

Fatmir Xhafaj – Ka ndonjë problem me afatet këtu?

Rainer Deville – *(përkthen përkthyesja)* Nuk mendoj ashtu. Nuk ka problem se janë dy procedura që nuk varen nga njëra-tjetra. Gjatë kësaj kohe janë mbledhur të gjitha dokumentet e nevojshme bazuar mbi të cilat komisioni do të fillojë punën.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Neni 31?

Oerd Bylykbashi – Ne jemi kundër.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Neni 32, struktura përgjegjëse për kontrollin e figurës. Ka një ndryshim të bërë mbi bazën e asaj që është propozuar në opinionin e grupit të deputetëve të PD-së. Ka një riformulim nga EURALIUS-i. Dakord me ndryshimin e bërë? Dakord. Opozita është kundër. Neni 33, te pika “b” ka një ndryshim mbi bazën e opinionit të paraqitur nga PD.

Oerd Bylykbashi - Opozita është kundër.

Fatmir Xhafaj - Dakord. Neni 33 miratohet me ndryshimet e sipërpërmendura. Neni 34, standardet e kontrollit të figurës, mbetet siç është. Opozita kundër. Po.

Oerd Bylykbashi – Ne jemi kundër.

Keltis Kruja– Kisha një pyetje për pikën 3, germa “d” të nenit 34, subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në takime e aktivitete ose raste të tjera me elementë të përfshirë në krimin e organizuar. Çfarë nënkuptohet me këtë? Nuk e kuptoj. Cili është kriteri i përcaktimit të pjesëmarrjes në takime masive , stadium, kinema, dasmë, varrim? Sepse, siç duhet ta dini, kemi disa zakone apo tradita të cilat shqiptarët i kanë pasur për shekuj me radhë dhe nuk mund t’i përcaktojmë çdo individ që të mos respektojë një pjesë të rëndësishme të jetës apo familjes së vet vetëm për shkak se do të bëhet pjesë e organeve të rivlerësimit. Këtë nuk e kuptoj. A mund të kem një specifikim të karakterit më diapozitiv se çfarë do të thotë kjo pikë?

Rainer Deville – *(përkthen përkthyesja)* Neni 34, germa ”d” përcakton kushtet në të cilat do të konsiderohet pjesëmarrja në një organizatë kriminale. Këta janë thjesht shembuj.

Në rast se, le të themi, një kryemafioz zhvillon një takim me disa mafiozë të tjerë, dhe aty merr pjesë edhe një gjyqtar, atëherë natyrisht që kjo nuk është një ide e mirë, dhe e gjithë kjo mund të përdoret kundër subjektit të vlerësimit ose gjyqtarit në këtë rast.

Në rast se ju besoni se kjo rrethanë mund të jetë, për shembull, edhe në një martesë që zhvillohet në Lazarat, atëherë kjo është një rrethanë që natyrisht mund të merret parasysh.

Natyrisht, thelbi i asaj që ne kemi dashur të themi, është se një gjyqtar nuk duhet të ketë kontakte të këtij lloji. Fakte të tjera që do të dalin gjatë hetimit do të merren në konsideratë.

Fatmir Xhafaj – Zoti Vasili, ju lutem, pastaj.

Po.

Keltis Kruja – Unë nuk kisha asnjë prapavijë politike te pyetja që bëra.

Fatmir Xhafaj – Nuk e vëmë në diskutim.

Keltis Kruja – Për sqarim, meqë mora një përgjigje që nuk sqaroi asgjë, por megjithatë po e them, për sqarim. Unë them se ky nen duhet specifikuar në mënyrë korrekte, ekzakte, në mënyrë që të kemi një ndalim, i cili të jetë në bazë të ligjit, e jo ndalime që janë në bazë të subjektivitetit, që mund të përdorin çdo organ, aq më tepër organe të cilat janë parashikuar në këtë ligj.

Unë nuk besoj se organet e shtetit kanë protokolle për takimet e bosëve mafiozë, sepse po të kishin do të ishte shumë mirë. Pra, takimet e mafies nuk bëhen me protokoll, kështu që nuk kemi nga t’i dimë. Unë po flas për formulimin që është bërë këtu, i cili është shumë evaziv, e nga i cili mund të na dalin më vonë probleme të caktuara në lidhje me aplikimin e ligjit.

Pra, pjesëmarrja e çdo individ në një mjedis në të cilin mund të ketë eventualisht elementë të krimit të organizuar, nuk e ngarkon atë fare me faj për prezencën e tij atje.

Kjo është ajo çfarë doja të thosha. Pastaj, për sa u përket takimeve, e ritheksoj: kur bëhen takimet e bosëve mafiozë, nuk bëhen me protokoll, dhe organet e rivlerësimit nuk kanë mundësi t’i marrin vesh, e besoj as misioni i monitorimit. Në qoftë se ka mundësi, sigurisht që ai gjyqtar apo ai prokuror, që ka qenë atje është i përjashtuar dhe nuk ka nevojë fare as të thuhet në ligj.

Fatmir Xhafaj – Zoti Vasili. Pastaj zoti Smibert.

Petrit Vasili – Unë kam diçka, të cilën e bashkëndamë edhe me kolegun Muçmataj. Besoj se kërkon një precizim, një saktësim dhe germa “b” e nenit 3, ku thuhet: “Subjekti i rivlerësimit ose personi i lidhur me të ka pasur një komunikim me një person të përfshirë në krimin e organizuar”. Fjala “komunikim” kërkon një saktësim, pasi mundësitë për keqinterpretim e për abuzim edhe janë të mundshme.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Smibert, ju lutem!

Më fal, mbaruat, zoti Vasili? Në rregull!

Zoti Smibert.

Jon Smibert – (*përkthen përkthyesja*) Faleminderit që më dhatë shansin të flas! Unë do të tregoj se nga vjen ky nen apo draftim i këtij neni dhe si funksionon. Në shumicën e vendeve të NATO-s e në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Mbretërinë e Bashkuar, këto janë bazat mbi të cilat mbështetet ky lloj vlerësimi. Si bëhet vlerësimi i figurës? Bëhet në mënyrë të tillë: dikush ofron një informacion, e pastaj ky informacion i marrë vlerësohet. Ky informacion i kalon një trupi tjetër, i cili ka detyrën që të vendosë mbi këtë informacion. Më pas ka udhëzime se si mund të bëhet vlerësimi i situatave të ndryshme. Ato që janë të përcaktuara në pikën 3, janë rrethanat që merren parasysh në vlerësimin e këtyre gjetjeve apo informacioneve të grumbulluara.

Ndërsa paragrafi 4 ka rrethanat lehtësuese që merren parasysh në lidhje me këtë informacion të grumbulluar.

Në qoftë se një person, siç e përmendët edhe ju, do të ishte në një vend të përbashkët ku ka persona të përfshirë në krimin e organizuar, atëherë ky informacion do të merrej parasysh në lidhje me vlerësimin e figurës së këtij njeriu.

Po të shikojmë edhe pikën 4 të nenit, do të vërejmë se rrethanat lehtësuese përcaktojnë nëse ky kontakt është i rrallë apo i shpeshtë, apo marrëdhënia e tij me këtë person është e afërt ose jo e afërt. Në bazë të këtyre vlerësimeve bëhet edhe vlerësimi i figurës. Prandaj janë vënë dy pika të këtij neni, ku jemi munduar të bëhet një balancim të këtij informacioni të grumbulluar, dhe ky informacion i marrë i kalon komisionit. Më pas këto informacione i vlerëson komisioni, nëse duhen marrë parasysh apo jo. Pras, në qoftë se dikush fotografon praninë e një personi me një person tjetër, por nuk jep ose nuk sqaron rrethanat në të cilat ndodhet apo rrethanat lehtësuese, atëherë ky informacion nuk mund të merret parasysh.

Në qoftë se në ndonjë nga vendet e NATO-s do të kishte një informacion të tillë sensitiv, atëherë kjo do të ishte mënyra dhe procedura se si vlerësohet ky informacion sensitiv. Pra, bëhet një balancim midis informacionit dhe rrethanave lehtësuese, që mund ta shoqërojnë atë.

Faleminderit, zoti Smybert!

Zoti Mediu.

Fatmir Mediu – ...të këtij neni, për të shmangur maksimalisht të gjitha influencat dhe referencat që sjell zoti Smibert, që kanë të bëjnë më tepër me njerëz që kanë informacionin e klasifikuar, në vende-vende anëtare të NATO-s, që patjetër duhet të jenë shumë strikt. Por dua të sjell ndër mend se ne jemi shoqëri e vogël dhe kemi histori të hidhur të biografive. Shumë njerëz

kanë vuajtur nga fakti se xhaxhai ka qenë dikur partizan apo ku di unë, ballist, dhe nuk e ka fituar të drejtën e tij themelore. Unë po ju marr një rast të thjeshtë, për të bërë një lloj analize. Një gjyqtar i ndershëm apo prokuror, që klasifikohet në të gjithë elementët e vet, djali i xhaxhait të tij, që është kushëri i afërt, mund të jetë dënua për trafik droge. Padyshim raportet familjare që po flasim, siç i përmendi kolegu, që janë batiate apo festa, nuk është as në autoritetin e përzgjedhjes, sipas rregullit tonë, për të qenë ose për të mos qenë pjesë. Ajo çfarë më shqetëson është që, në qoftë se ne do ta s’kualifikojmë pa të drejtë, atëherë i ngelet barra e provës për të provuar të drejtën e tij, pasi e kemi s’kualifikuar, gjë që do të jetë shumë e vështirë për ta fituar atë të drejtë që e ka humbur tashmë për shkak të vlerësimit.

Pra, situata të tilla në Shqipëri ka me qindra. Përgjegjësia, të paktën, është personale, nuk është kolektive e as familjare. Këtu është shqetësimi im, se cili do të jetë elementi i zgjidhjes.

Unë si Fatmir Mediu mbaj përgjegjësi për atë çka jam unë, si sillem unë në raport me ligjin, korrektesën time në raport me ligjin, jo për fotografinë ku mund të kem dalë me djalin e xhaxhait, i cili është kriminel, e që ka qëlluar të jetë në një eveniment me mua apo me dikë tjetër. Po supozoj gjithmonë.

Pra, ku e shmangim subjektivizmin në këtë lloj vlerësimi? Si e ndajmë realisht, objektivisht, që ky gjyqtar apo prokuror, i cili ka marrë pjesë qëllimisht dhe është pjesë e këtyre marrëdhënieve, nga një njeri që është aty në mënyrë rastësore apo edhe për shkak të rrethanave familjare, në raporte të tilla, të cilat e bëjnë atë të pakualifikueshëm?

Fatmir Xhafaj – Në rregull. Faleminderit, zoti Mediu!

Zoti Bylykbashi, po.

Oerd Bylykbashi – Besoj se shqetësimi po del i qartë këtu, nga pyetjet e kolegëve. Ajo që shihet qartë në këtë dispozitë është potenciali i jashtëzakonshëm për t’u abuzuar. Ne nuk e dimë fare se kush do të jetë ai që do të vijë nesër për ta aplikuar këtë ligj. Nuk është fare çudi që në këtë Shqipëri kaq të vogël edhe numerikisht, ku të gjithë kemi opinione politike, do të përdorim llastikun e këtyre lloj dispozitave, për të abuzuar me këtë, ndërkohë qëllimi është qartësisht pozitiv. Është e papranueshme që një gjyqtar apo një prokuror të jetë në kontakte që kanë një lloj konsistence të qartë me botën kriminale. Të tillë mund të ketë, jam i sigurt se ka, jo mund, por kështu siç është shkruar, potenciali i abuzimit dhe i shkeljes së të drejtave të njeriut është i jashtëzakonshëm.

E përsëris, në mungesë të standardit ndërkombëtar, praktikës së mirë ndërkombëtare për këtë lloj ligji e procesi, e vetmja gjë që do të na shpëtojë është zbatimi i parimeve të shtetit të së drejtës, pavarësisht drejtësisë, dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Askujt nuk do t'i mohohet e drejta, që të ngjisë shkallët duke kërkuar drejtësi deri në Gjykatën e Strasburgut, edhe sikur të ketë qartazi marrëdhënie të papërshtatshme, por nuk është ndonjë çudi që Gjykata e Strasburgut të na e gjejë dispozitën në shkelje. megjithatë, qëllimin e mirë ta mbrojmë me saktësi. Ky është shqetësimi që po shprehin të gjithë anëtarët.

Jam i sigurt se, nëse ky proces do të zhvillohej në një vend jo thjesht me demokraci të konsoliduar, por me shtet të konsoliduar, siç janë Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar apo shtete të tjera, ku jo numri i banorëve është dhjetëra milionë, por numri i profesionistëve është me miliona, sigurisht që do të ishte shumë i thjeshtë, po kaq sa jemi ne, është absolutisht e mundur që të gjendesh në ato situata, ku dikush merr pjesë në një aktivitet, pa lidhje me bosin mafioz, që është çudi e madhe pse është jashtë burgut dhe të gjithë e dinë se është bos mafioz, dhe personi mund të mos ketë fare të dhëna për këtë dhe në fund dikush për këtë rast thotë: Po, ti ke lidhje të papërshtatshme. Ndërsa për dikë tjetër që na intereson politikisht, themi: jo, qëndro aty se nuk e kishe lidhjen e papërshtatshme. Ky është meraku.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Majko!

Pandeli Majko – Unë i mirëkuptoj të gjitha shqetësimet e kolegëve të opozitës, por dëshiroj të them një gjë eksplicite në vazhdim të asaj që ekspertët ndërkombëtarë thanë. Ndershmëria nuk është një akt administrativ, por është një histori subjektive, që ka të bëjë me aftësinë dhe marrëdhënie të caktuara njerëzore. Kështu që unë mendoj se ky nen duhet të jetë kështu siç është, t'i thërrasë mendjes kushdo që do të futet në këtë proces dhe të japë llogari për çdo marrëdhënie, qoftë edhe rastësore me krimin e organizuar. Në një kohë kur në Shqipëri ne kemi raste që gjykatës të caktuar kanë protektorë të kriminit të organizuar, ka edhe prokurorë që, në mes të Tiranës, ulen me njerëz të cilët janë në kërkim, as të lidhur me krimin e organizuar, po janë në kërkim, kështu që ta njohim situatën kështu siç është dhe mendoj se neni duhet të rrijë kështu siç është.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam një pyetje për paragrafin 5 në raport me paragrafin 6. Në paragrafin 5 thuhet se rrethanat që merren parasysh në konstatimin nëse formulari i deklaramit është i plotë dhe i besueshëm, janë dy:

E para, subjekti i vlerësimit nuk rendit në listë një kontakt që është konstatuar nga prova të besueshme.

E dyta, subjekti i rivlerësimit nuk rendit në listë një kontakt, i cili përforcohet ose konsiderohet i besueshëm nga informacionet e shërbimeve të fshehta dhe të besueshme.

Pyetje ime është se pse te rrethanat lehtësuese, pra te paragrafi 6, nuk është parashikuar i njëjti rregullim si te paragrafi 4, germa “a”, pra do të konsiderohet rrethanë lehtësuese që subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të besueshme, parashtron se nuk ishte në dijeni të faktit se personi me të cilin ai ka kontaktuar ka qenë i përfshirë në krim të organizuar.

E dyta, një subjekt nuk mund të dijë apriori se çfarë informacionesh kanë shërbimet e fshehta. Ndoshta shërbimet e fshehta kanë dijeni që personi A është i lidhur me krimin e organizuar, por personi që bën deklaratën nuk është në dijeni dhe ndoshta si rrethanë lehtësuese te paragrafi 4 do të duhej të përsëritej po ajo që është përmendur në paragrafin 4, pra që subjekti i rivlerësimit kur plotëson formularin e deklaramit nuk ka qenë në dijeni, e parashtron këtë në mënyrë të besueshme, që personi që ka kontaktuar ka qenë i lidhur me krimin e organizuar.

Fatmir Xhafaj – A ka një koment për pyetjen e zonjës Hysi?

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Sa herë që bëjmë vlerësime të tilla të figurës, organi që bën vlerësimin, që ka marrë informacionin nuk pyet personin që vlerësohet se a ka qenë ti në dijeni se personi të cilin ke takuar në atë event është i lidhur me krimin e organizuar, sepse gjithmonë përgjigja do të jetë që jo, nuk kam qenë në dijeni se personi është i lidhur apo jo, prandaj këtë informacion e vlerësojnë ose cilësinë e këtij informacioni e vlerësojnë organet e rivlerësimit.

Në fakt, personi që bën vlerësimin e këtij informacioni thjesht shkruan që personi nuk ka qenë në dijeni se personi që ka takuar ka qenë i lidhur ose është i lidhur me krimin e organizuar dhe personi që bën vlerësimin i kalon një paneli dhe është paneli ai që vendos nëse ky informacion duhet marrë parasysh apo jo.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Gjithsesi, ka një shqetësim për të mos pasur abuzim dhe unë mendoj që të pika 3, pika “b” që u ngrit këtë nga zoti Vasili dhe nga zoti Muçmata, ka pasur një komunikim dhe ndoshta

duhet vënë fjala “jorastësor”, “komunikim i përhershëm” është ideja. Sepse pika “d”: subjekti i rivlerësimit merr pjesë apo është i pranishëm, s’ka nevojë këto aktivitete ose raste të tjera, mund të thuhet “në takime” se ato takime janë të gjitha, se edhe po që aktivitet, takim është. E mbyllim me “takim”, pra që dihen. Dakord? Ju lutem mbajini shënim që të ndryshohen këto!

Pra, jemi dakord me këto ndryshime.

Oerd Bylykbashi – Për këtë ne jeni kundër, sepse besojmë se duhet riformuluar më shumë. Kërkon garanci më të mëdha.

Fatmir Xhafaj – Duhet riformuluar, mendoni ju? Gjithsesi neni 34 miratohet...

Oerd Bylykbashi – Po gjithsesi është interesante se kur e propozoni ju, zoti kryetar, ekspertët e mbyllin si histori, ndërsa kur e propozojmë ne është shkelje e vijave të kuqe dhe infra të kuqe.

Fatmir Xhafaj – Neni 35, procedura për kontrollin e figurës, kjo ditët, me 30 ditë, me 60 ditë mos është e përealizueshme? Në përfundim të afatit 60-ditor, DSIK-ja mund t’i kërkojë komisionit të zgjatet 30 ditë. Po në 90 ditë, 800 certifikata janë, janë pak ditë. Shikojeni njëherë, gjithsesi mbajeni shënim dhe shikojeni me qetësi.

Pra, neni 35 dakord me sugjerimin e bërë mbi bazën e opinionit të opozitës.

Oerd Bylykbashi – Ne jemi kundër.

Fatmir Xhafaj – Neni 36, objekti i vlerësimit të aftësisë profesionale, mbetet siç është.

Neni 37, fillimi i procedurës për vlerësimin e aftësive profesionale, mbetet siç është.

Neni 38, burimet për rivlerësimet e aftësisë profesionale, mbetet siç është.

Neni 39, procedurat për vlerësimin e aftësisë profesionale, është ndryshuar mbi bazën e opinionit të paraqitur nga opozita. Dakord.

Oerd Bylykbashi – Ne jemi kundër, sepse nuk është reflektuar pozicioni që kemi shprehur.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Neni 39, miratohet me ndryshimet e bëra nga ekspertët, mbi bazën e opinionit të opozitës. Opozita është kundër.

Neni 40, raporti i vlerësimit, mbetet siç është.

Neni 41, mbetet siç është.

Neni 42, njoftimi, mbetet siç është.

Neni 43, mbetet siç është.

Neni 44, bashkëpunim gjatë procesit të hetimit, mbetet siç është.

Neni 45, mjetet për kërkimin e provës, ka ndryshime të paraqitura nga ekspertët mbi bazën e reflektimit të opinionit të opozitës.

Oerd Bylykbashi – Ne jemi kundër, sepse nuk reflekton opinionin tonë.

Fatmir Xhafaj – Dakord, miratohet me ndryshimin.

Neni 46, aksesit në informacion, gjithashtu ka ndryshime të germa “a” e pikës 2 dhe të vetë pika 7.

Miratohet me këto ndryshime.

Neni 47, mbetet siç është.

Neni 48, barra e provës, mbetet siç është.

Neni 49, mbetet siç është.

Neni 50, bashkëpunëtor i drejtësisë, mbetet siç është.

Neni 51, seanca dëgjimore, ka ndryshime mbi bazën e vërejtjes që është bërë mbi bazën e opinionit të opozitës, miratohet me ndryshim të pika 7.

Neni 52, dorëheqja, mbetet siç është.

Neni 53, mbetet siç është.

Neni 54, masat disiplinore, mbetet siç është.

Neni 55, konfirmimi në detyrë, mbetet siç është.

Neni 56, mbetet siç është.

Neni 57, mbetet siç është.

Neni 58, të drejtat e subjekteve të rivlerësimit pas dhënies së vendimit të komisionit, mbetet siç është.

Neni 59, paraqitja e ankimit, mbetet siç është.

Neni 60, njoftimi i ankimit, mbetet siç është.

Neni 61, procesi gjyqësor, mbetet siç është.

Neni 62, vendimi i kolegjit të apelimit, mbetet siç është.

Neni 63, rivendosja në afate e së drejtës për ankim, mbetet siç është.

Neni 64, marrëdhëniet kalimtare midis institucioneve, ka ndryshime të paraqitura nga ekspertët të pika 1, 2 dhe 3 të këtij neni, bazuar edhe në sugjerimet e bëra nga kolegjet e opozitës.

Dakord është opozita për nenin 64? Dakord, nuk ka kundërshtim.

Neni 65, aktet nënligjore, 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Dakord. Neni 65 me ndryshimin e paraqitur.

Neni 66, mbarimi i institucioneve të vlerësimit. Dakord.

Neni 67, hyrja në fuqi. Kjo kërkon një mirëkuptim...

Oerd Bylykbashi – Kjo është shumë e thjeshtë për ta thënë. Ne jemi kundër për një gjë që është fare teknike dhe kushtetuese, ligji ose hyn në fuqi 15 ditë nga botimi në Fletoren Zyrtare, ose hyn në një datë tjetër të përcaktuar më vonë, ose hyn menjëherë. Por nuk ka midis menjëherë dhe botimit në Fletoren Zyrtare.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Rregullojeni këtë!

Kemi shtojcën 1, ka disa ndryshime. Dakord? Janë reflektuar opinionet e opozitës.

Shtojca 2 ka ndryshime me reflektimin për deklarinimin e pasurisë me opinionin e opozitës.

Dakord.

Shtojca 3 ka gjithashtu disa ndryshime. Ka të pjesa 5, të dhëna për sigurinë, apo e kam gabim? Kanë shumë të drejtë se i kam lexuar me vëmendje, të jeni të sigurt për këtë gjë.

Miratohet me ndryshimet e propozuara nga opozita.

Shtojca 4 ka ndryshime gjithashtu.

Dakord.

Para votimit në tërësi, zoti Bylykbashi ka kërkuar fjalën.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar,

Siç e thashë në fillim të kësaj mbledhjeje do të kishte qenë me vlerë procedurale, e kërkon Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë, që një ligj i cili diskutohet dhe miratohet duhet së pari të ketë një bazë kushtetuese dhe së dyti të bëhet kjo. Çdo miratim dhe diskutim përpara hyrjes në fuqi nuk ka vlerë, porsa i përket procedurës, mund të ketë vlerë porsa i përket punës, e padiskutueshme, por do të kishte qenë e rregullt, sipas Rregullores që të hapej procesi me votim në parim dhe më pas nen për nen, gjë që nuk do të na kishte kushtuar asgjë. Nuk e bëtë, duke e cenuar këtë pjesë të Rregullores, por, pavarësisht kësaj, në emër të opozitës, dua të shpreh, para se të bëhet votimi në tërësi, dua të rikonfirmoj edhe një herë se opozita është pro në parim të këtij ligji. Vërejtjet tona i kemi shprehur nen për nen, kështu që do të kishte qenë shumë më mirë të ishte ndryshe. E para.

E dyta, jemi përpara një procesi ku u përmbyll një ligj, që është shumë i rëndësishëm, por me një standard procesi absolutisht të papranueshëm dhe të pandodhur ndonjëherë në parlamentin shqiptar. Përveçse dakordësia e dhjetorit 2014 ka qenë që për të gjitha ligjet e

rëndësishme, përfshi edhe ato me shumicë të cilësuar, duhet të kërkohet konsensus i opozitës, por ky konsensus nuk u kërkua kurrë, nuk u kërkua as në fazën e miratimit të Kushtetutës, aq më pak tani. Besoj që në këtë koncept, në kërkesën për konsensus nga maxhoranca, një gur themelor do të kishte qenë që ekspertët të ishin ulur, të kishin punuar me frymë mirëbesimi, konstruktive dhe të na kishin sjellë një punë tjetër. Unë jam i sigurt që puna do të kishte qenë krejt ndryshe, nëse ekspertët do të kishin dashur të punonin edhe me ekspertët e opozitës, me të gjysmës së komisionit.

Kjo që është bërë deri më sot ka një sjellë një dokument i cili ka qartazi kundërshti dhe mosdakordësi në substancën e neneve të rëndësishme, nga ana e opozitës. Ne mendojmë që jo vetëm opinionin ynë nuk është reflektuar fare, por ne gjithashtu konsiderojmë se mosreflektimi i opinionit të opozitës në qartazi në pah jo vetëm cilësinë e dobët shpeshherë të projektligjit, por edhe probleme qoftë edhe të karakterit parimor, që mund të çojnë nesër në goditjen e ligjit më lart.

Sigurisht që nuk është ky komision, nuk është parlamenti me 140 deputetë që do të ndajë kushtetutshmërinë apo jo të këtij ligji, gjithashtu përputhjen apo jo me standardet ndërkombëtare. Ka edhe më lart se sa kaq, sigurisht është Komisioni i Venecias, mund të jetë edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut. Askush, edhe në Bruksel, nuk e merr dot përsipër këtë për të thënë: është apo nuk është e mundur që kjo të ndodhë.

E për rrjedhojë, vendosmëria për të mos pranuar kontributin konstruktiv të opozitës, me amendamente konkrete, me opinion konkret jo vetëm që mund të çojë në probleme, siç ndodhi me draftin e shtatorit të Kushtetutës dhe të janarit të 2016-ës, që u rrëzuan, por është qartazi një vullnet negativ për të pranuar konsensus me opozitën dhe qartazi është grusht drejtpërdrejt ndaj konsensusit. Vërtet ne nuk kemi numra në parlament për të ndryshuar gjë nga ky ligj, por në këtë komision është ndërtuar qartazi me paritet, me qëllimin e vetëm që ne palët të biem dakord. Nuk e deshët konsensusin për asnjë sekondë, e çuat punën edhe në nivelin e ekspertizës, që të funksiononte në këtë formë, që është një goditje e drejtpërdrejtë jo vetëm për konsensusin, por edhe për efikasitetin dhe zbatimin e shpejtë të reformës në drejtësi.

Jeni ju që me këtë qëndrim të njëanshëm, aspak përfshirës dhe aspak konsensual, keni frenuar zbatimin e hapit të parë të rëndësishëm të reformës në drejtësi, ndoshta përfshirë edhe hyrjen në fuqi të këtyre dispozitave apo zbatimin e tyre. Uroj që në ligje të tjera nxitimi të mos u nxjerrë sytë atyre ligjeve. Ky ligj, kështu siç e keni ju në plan ka probleme të rënda dhe do të

kalojë kështu siç e keni vendosur, edhe pse na duhet shumë që të kemi një ligj të mirë vetingu. Për rrjedhojë duhet të mbani ju përgjegjësinë për të gjithë barrën e dështimit dhe abuzimin me procesin e vetingut, i cili nesër në vend që të na pastrojë gjyqësorin, thjesht do të na krijojë probleme më tepër, ndërkohë të përzgjedhur në mënyrë selektive, personale apo politike, gjyqtarë dhe prokurorë të korruptuar të vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë, sepse i shërbejnë partisë.

Fatmir Xhafaj – Fjalën e ka relatori, përpara se ta mbyllim diskutimin.

Pandeli Majko – Së pari, pa asnjë cinizëm, dëshiroj të falënderoj opozitën, për mënyrën se si ajo e filloi procesin. Pra, në vlerësimet e saj, pas miratimit të dispozitave kushtetuese, solli një varg vlerësimesh, për të cilat, ashtu siç u diskutua edhe mbledhjen e fundit të komisionit, ne kërkuam nga EURALIUS-i dhe nga OPDAT-i që të shpreheshin lidhur me to.

Sigurisht, unë jam i bindur për një gjë: qoftë ne të maxhorancës, do të më lejojnë kolegët e maxhorancës të shprehem në emër të tyre, qoftë ju të opozitës, nuk besoj se kishim pritshmërinë që në do të kishim një histori perfekte. Për më tepër, po diskutojmë për një akt të paprecedentë, për një situatë e cila vjen nga situata e krimit të organizuar dhe e korrupsionit në Shqipëri, që ka prekur, sigurisht, edhe gjyqësorin. Ajo që dua të them është se ne diskutuam sot bazuar mbi të gjitha sugjerimet e opozitës, që u mirëpranuan qoftë nga misioni EURALIUS që foli, po citoj zotin Rajner, në emër të Komisionit Europian, po ashtu edhe nga OPDAT-i. Sigurisht që mbetet një proces i cili kërkon një përgjegjësi politike. Dhe nëse do të flasim për këtë, ne që ditën e parë, që në krye të herës, nuk i jemi shmangur kësaj sfide, duke pasur parasysh edhe rrisqet që ka kjo sfida.

Ajo që dëshiroj të them është se ajo që nuk arrita të kuptoj sot nga opozita është fakti se sot përfaqësuesi i saj, zoti Bylykbashi, përmendi edhe instanca ku ata mund të ankohen, duke përfshirë edhe Gjykatën e Strasburgut.

Dëshiroj të nënvizoj edhe një fakt: sot në asnjë rast, mund të hapni edhe procesverbalin, nga asnjë përfaqësues dhe koleg i opozitës nuk na është thënë se në këtë nen apo në atë nen po shkelet ndonjë dispozitë kushtetuese qofshin nga këto që sapo janë ndryshuar. Në asnjë nen nuk keni thënë që po shkelni Kushtetutën përfshirë edhe dispozitat e reja kushtetuese.

Ana tjetër e problemit është që kemi qenë ne që ju kemi lexuar dispozitat kushtetuese, kur kanë qenë oferta teknike nga përfaqësuesi juaj i ekspertizës së Partisë Demokratike, apo i opozitës, në nene të caktuara. Unë mendoj se procesi ka qenë gjithëpërfshirës, ka qenë

jashtëzakonisht i qetë edhe nga pikëpamja e asaj që ne jemi duke bërë. Me lejoni ta them edhe një herë, pavarësisht se mund të duket si përsëritje. Ky është një proces që shteti shqiptar po e bën në bashkëpunim me Bashkimin Europian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky bashkëpunim, me këta dy faktorë strategjikë ndërkombëtarë dhe miq të Shqipërisë për herë të parë është i shkruar në aneksin kushtetues të saj. Kështu që opinioni ynë apo koncepti ynë për t'iu qëndruar vërejtjeve të EURALIUS-it dhe OPDAT-it nuk është një koncept formal apo një dëshirë për ta nxjerrë opozitën si antieuropiane apo antiamerikane, por është një vijë qëndrimi që nga i fillimi i këtij diskutimi dhe deri më sot që flasim. Megjithatë, unë dëshiroj të nënvizoj edhe habinë që në nene ku opozita nuk kishte asnjë vërejtje qoftë edhe teknike, nuk mori përsipër të votonte nënin përkatës. Gjithsesi unë mendoj që përfshirja e vërejtjeve të opozitës sot në material e bën atë më të plotë më të detajuar. Kjo është arsyeja që pa asnjë ndjenjë cinizmi falënderova këtë bashkëpunim me opozitën. Sigurisht ne do të donim politikisht edhe ndryshime të natyrave të tjera, por mendoj se në këtë kornizë ligjore, që kemi ngritur me ligjin për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë, pa dyshim që kemi hedhur një hap tjetër të rëndësishëm pas ndryshimeve kushtetuese. Prandaj i ftoj të gjithë kolegët, pa asnjë dallim politik, për ta votuar dhe t'ia kalojmë atë seancës plenare. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Tani kemi votimin në tërësi, që të mos bëjmë...

Oerd Bylykbashi – Proceduralisht, opozita nuk merr pjesë në votim.

Fatmir Xhafaj - Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenime nuk ka. Opozita nuk merr pjesë në votim.

Oerd Bylykbashi – Nuk marrim pjesë në votim.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit! Për mbledhjen e ardhshme do t'ju njoftojmë këto ditë.

MBLEDHJA MBYLLET

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë